TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave "Inxhinieri Software"**

**120 ECTS**

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

1. Esmeralda Kadëna, PhD. (Kryetare)
2. MSc./Dr. (proc.) Xhezmije Palushi (Anëtare)
3. MSc. Mirlinda Kadriaj (Anëtare)
4. Flavia Rira (Studente)

Shtator 2025

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

### Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave në Inxhinieri Softuerike" (MSh-IS) me 120 kredite ECTS, është miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 9-1, datë 16.11.2022[1] dhe ka nisur zbatimin në vitin akademik 2023–2024 pas Urdhërit të MAS nr. 457, dt.14.08.2023[2] për hapjen e tij në kuadër të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit pranë Tirana Business University College. Programi është projektuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, VKM nr. 41/2018, VKM nr. 531/2018 për Kodin e Cilësisë, dhe me dokumentet strategjike të institucionit, përfshirë Strategjinë e Zhvillimit të TBU 2024–2029.

Ky program synon të përgatisë specialistë të avancuar në zhvillimin dhe arkitekturën e softuerit, sistemet cloud-native, inteligjencën artificiale dhe sigurinë informatike. Struktura përfshin lëndë bazë, të karakterizuara, ndërdisiplinore dhe praktike, si dhe praktikë profesionale (12 ECTS) dhe tezë diplome (18 ECTS). Kurrikula është ndërtuar mbi standardet evropiane dhe e përditësuar me literaturë bashkëkohore dhe kërkesa të tregut të punës.

Programi mbështetet nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, i ngritur në përputhje me vendimin për strukturën organizative të TBU (SA nr. 51, datë 11.09.2023), dhe i përbërë nga staf akademik me gradë dhe tituj shkencorë, me eksperiencë kërkimore dhe ndërkombëtare. Aktivitetet zhvillohen në mjedise moderne dhe në platforma digjitale mësimore.

Janë krijuar marrëveshje bashkëpunimi me rreth 50 kompani TIK dhe institucione publike, të dokumentuara në raportet e zyrës së çështjeve studentore. Programi përfshin komponentë të ndërkombëtarizimit përmes bashkëpunimeve me universitete europiane dhe pjesëmarrjes në rrjete kërkimore.

Programi është kodifikuar sipas Udhëzimit nr. 31, datë 15.11.2022[3], dhe ka marrë kodin unik 72MS0613S[4], në përputhje me fushën e detajuar 0613 të Klasifikimit Kombëtar të Programeve të Studimit. Ky raport paraqet të dhënat e plota për vlerësimin e brendshëm në funksion të akreditimit institucional dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[1] 2.1.2.Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
[2] 71. Urdher MAS nr. 457, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Inxhinieri Softwere
[3] 67.3.Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf
[4] 67.5.Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për "Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

### Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Procesi i vlerësimit të brendshëm për programin "Master i Shkencave në Inxhinieri Softuerike" është realizuar në periudhën janar–maj 2025, në përputhje me formatin e hartuar nga ASCAL dhe udhëzimet për vlerësimin e programeve të ciklit të dytë. Procesi është koordinuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) i ngritur me urdhër të Rektorit dhe përbëhet nga 4 anetare (3 staf akademik dhe nje student).[5]

Etapat e ndjekura kanë qenë:

- Përgatitja e planit të punës dhe shpërndarja e përgjegjësive;
- Grumbullimi i dokumentacionit evidencues, përfshirë: vendimet e senatit, kurrikulën, CV-të e stafit, marrëveshjet me industrinë, raportet e vetëvlerësimit të stafit, analizat e feedback-ut nga studentët;
- Analiza e përmbushjes së 6 fushave të vlerësimit sipas standardeve të ASCAL, me vlerësim të argumentuar për çdo kriter dhe përmbledhje të pikat e forta dhe të dobëta;
- Përgatitja dhe finalizimi i Dosjes së Vetëvlerësimit, e cila përfshin: mendimin e drejtuesit të njësisë, raportin e GVB dhe evidencat mbështetëse të organizuara sipas AMS.

Gjatë procesit janë zhvilluar intervista me stafin, fokus grupe me studentët dhe u realizua konsultimi me Zyra të ndryshme institucionale (Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Karrierës, Zyra e Cilësisë, etj.). Janë përdorur mjete vlerësimi si: formularë vetëvlerësimi, monitorim i syllabuseve, analiza e ngarkesës mësimore dhe vlerësimi i bashkëpunimeve institucionale.

Procesi u mbikëqyr nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në përputhje me Kërkesat e Ligjit 80/2015 dhe VKM nr. 531/2018, dhe shërben si bazë për akreditimin dhe planifikimin e zhvillimit të programit në fazat e mëtejshme. Raporti është dorëzuar në formë elektronike dhe fizike, sipas afatit të përcaktuar.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

[5] 68. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit MShIS

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Software"

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1<br>**Instituconi i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.<br>Programi MSh-IS është projektuar në përputhje me objektivat zhvillimore të Shqipërisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe transformimit digjital. Ai synon edukimin e specialistëve të nivelit të lartë në zhvillimin e softuerit dhe sistemet e avancuara, duke përmbushur kërkesat strategjike të tregut vendas dhe rajonal, pa cënuar vlerat akademike e kulturore të trashëguara.<br>Në dokumentin Plani Strategjik për programin MSh-IS[6], theksohet qartësisht përfshirja e moduleve që trajtojnë edhe etikën profesionale, sigurinë dhe ndikimin social të teknologjisë. Programi përmbush kërkesat e Ligjit nr. 80/2015[7] dhe VKM nr. 531/2018 për Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë[8], ku ruajtja e vlerave kulturore dhe shoqërore të vendit është element thelbësor në projektimin e programeve. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Misioni i TBU (i përfshirë në Statutin e institucionit[9]) është të përgatisë profesionistë të aftë në fusha prioritare të zhvillimit ekonomik, veçanërisht në teknologjinë e informacionit, duke integruar teorinë me praktikën dhe duke theksuar bashkëpunimin me industrinë dhe kërkimin e aplikuar. Programi Master Shkencor "Inxhinieri Software" (MSh-IS) është i ndërlidhur ngushtë me fushën e veprimtarisë së institucionit, siç vërtetohet në Vendimet e Senatit për hapjen e FTI[10] dhe programit[11], duke përmbushur objektivat akademike dhe profesionalë që burojnë nga ky mision. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit[12] dhe Rregullores së Institucionit [13]dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.<br>Dokumentet themelore të institucionit si Strategjia e Zhvillimit të TBU 2024–2029[14] dhe Rregullorja e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit[15], te Departamentit te Inxhinierise Software[16] dhe e programit të studimit Master |

[6] 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IS
[7] 61.Ligj_80-2015_22.07.2015: "LIGJ Nr. 80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË. Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave"
[8] 66. VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"
[9] 2.Statuti TBU
[10] 2.1.2. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022 per hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[11] 2.1.2 Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
[12] 2.Statuti TBU
[13] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[14] 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029
[15] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[16] 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | Shkencor ne "Inxhinieri Software"[17] [18], përcaktojnë qartë drejtimet strategjike, përfshirë zgjerimin e programeve në teknologji, digjitalizim dhe kërkim shkencor.<br>Programi MSh-IS pasqyron këtë strategji duke përfshirë lende të thelluara në AI, data mining, web technology, game design, menaxhim sistemesh informacioni, cloud computing, analiza e të dhënave, siç dëshmohet në kurrikulën[19] [20] dhe planin mësimor[21] [22]. Për më tepër, janë hartuar dokumente të veçanta për zhvillimin e stafit akademik[23] dhe kërkimin shkencor në këtë program[24] [25]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi është ndërtuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit dhe Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, duke pasur si prioritet zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike – elementë të reflektuar në strukturën e lëndëve dhe në qasjen interdisiplinare të programit. Gjithashtu, prirjet globale të zhvillimit të softuerit, inteligjencës artificiale, DevOps, dhe cloud-native software janë integruar në përmbajtjen lëndore. Kjo përputhje është gjithashtu e dokumentuar përmes raporteve të studimeve të tregut të punës[26], bashkëpunimeve ndërkombëtare[27] dhe politikave të zhvillimit të kurrikulës[28] që marrin në konsideratë raportet dhe dokumentet e BE-së dhe OECD. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Tirana Business University College, përmes Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI), ka ndërtuar dhe konsoliduar kapacitete akademike dhe infrastrukturore për të ofruar programe të avancuara në fushën e teknologjisë së informacionit. Këto kapacitete janë veçanërisht të fokusuara në Inxhinierinë Softuerike, një ndër drejtimet më prioritare të zhvillimit aktual teknologjik dhe ekonomik.<br>Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, si njësi bazë përgjegjëse për programin, përbëhet nga staf akademik me formim dhe përvojë në fushën përkatëse. Nga CV-te[29] e stafit akademik te angazhuar ne programin e MSh IS, rezulton se programi mbështetet nga pedagogë me tituj akademik "Profesor", "Profesor i asocuar", si dhe me gradë shkencore "Doktor". Gjithashtu ne CV-te e tyre rezulton se nje pjese e mire e stafit kane kryer specializime brenda dhe jashtë vendit, si në Hungari, Itali e France. Ngarkesa mësimore për periudhen 2023–2025[30] konfirmon vazhdimësinë dhe përkushtimin e këtij stafi në zbatimin e plotë të kurrikulës së programit. |

[17] 9. Rregullore e programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[18] 9.1. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (anglisht)
[19] 16.1. Kurrikula e programit MSH "Inxhinieri Software" (shqip)
[20] 16.2. Kurrikula e programit MSH "Inxhinieri Software" (anglisht)
[21] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[22] 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)
[23] 37.1. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik
[24] 42.1.2. Formular i raportimit te punes kerkimore shkencore
[25] 42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit MShIS (Aneks Tabela 19)
[26] 19. Studimi i tregut të punës
[27] Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)
[28] 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
[29] 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
[30] Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4)

| | |
|---|---|
| | Gjithashtu, TBU ka siguruar ambiente laboratorike dhe didaktike moderne, të pajisura me infrastrukturë që mbështet zhvillimin e praktikave të programimit dhe zhvillimit softuerik. Raporti mbi mjediset e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit (FTI-së)[31] dhe dokumentacioni për platformat online[32] tregojnë se studentët e këtij programi kanë akses në mjetet bashkëkohore të mësimdhënies dhe të zhvillimit profesional. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, si njësi kryesore akademike, ka profil të qartë në fushën e teknologjisë dhe informatikës. Hapja e këtij fakulteti është formalizuar me vendimin e Senatit Akademik Nr. 9, datë 28.09.2022[33] ndërsa programi i studimit në Inxhinieri Softuerike është aprovuar me vendimin pasues Nr. 9-1, dt. 16.11.2022[34].<br><br>Në përputhje me Klasifikimin Kombëtar të Programeve të Studimit (VKM Nr. 310, dt. 11.05.2022)[35] dhe me Udhëzimin Nr. 31, dt. 15.11.2022 mbi Kodifikimin e Programeve të Studimit[36], Programi Master Shkencor në "Inxhinieri Software" 120 ECTS ne gjuhen shqipe identifikohet si: *Master i shkencave, jo më pak se 120 ECTS (72MS).* Ky program është i pozicionuar brenda **fushës së gjerë** *06: Teknologji Informacioni dhe Komunikimi (TIK);* **fushës së ngushtë 061:** *Teknologji informacioni dhe komunikimi (TIK)* dhe në fushën e detajuar: *0613 Zhvillim dhe analizë software dhe aplikacionesh.* Përputhshmëria e programit me fushën e fakultetit është gjithashtu e konfirmuar nga shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024[37] ku njihet kodi i programit dhe lidhja e tij me profilin e institucionit. Konkretisht me Kodin: **72MS0613S** |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Departamenti i Inxhinierisë Softuerike është njësi bazë akademike, e themeluar për të mbështetur kërkimin dhe mësimdhënien në fushën e inxhinierisë softuerike dhe sistemeve të informimit. Në Rregulloren e Departamentit te Inxhinierise Software (DIS)[38] si dhe në Planin vjetor të DIS[39] përcaktohet qartë fokusimi në zhvillimin e lendeve të bazuara në zhvillimin e softuerit, analizën dhe arkitekturën e sistemeve, si dhe teknologjitë e bazuara në cloud, AI dhe siguri informatike.<br><br>Raporti analitik mbi përmbushjen e objektivave formuese të programit[40] demonstron përputhjen e fushës së programit me veprimtarinë kërkimore dhe akademike të departamentit. Edhe pse programi MSh-IS përfshin elementë ndërdisiplinorë si menaxhimi i projekteve IT, ligjshmëria e të dhënave apo etika profesionale, baza akademike dhe kompetenca thelbësore mbështeten dhe garantohen plotësisht nga Departamenti i Inxhinierisë Softuerike. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Ky kriter nuk aplikohet për rastin konkret, pasi programi i ofruar është "Master Shkencor" dhe është në përputhje të drejtpërdrejtë me profilin dhe drejtimin e njësisë përgjegjëse dhe si i tillë nuk kërkon garantim nga institucione të jashtme. |

[31] 43.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[32] 48. Të dhëna të plota për platformat on-line-Struktura e teknologjisë së informacionit, Biblioteka, Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)
[33] 2.1.1. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022 per hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[34] 2.1.2 Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
[35] 67.1.VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz
[36] 67.3.Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf
[37] 67.5. Shkresa e MAS Nr. 738122, dt. 30.12.2024 për Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University
[38] 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
[39] 53.1. Plani vjetor i DIS 2023-2024
[40] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | TBU ka zhvilluar një sërë aktivitete trajnimi dhe ndërveprimi me industrinë në kuadër të këtij programi, të mbështetura nga:<br><br>• Panairi i Punës 2024 [41] dhe bashkëpunimet me kompani të profilit TIK[42] [43]<br>• Politikat për zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve është formalizuar ofrimi i trajnimeve të fokusuara në teknologjitë e reja AI dhe përgatitjen për certifikime në fusha me rendesi [44].<br>• Lista e marrëveshjeve me institucione dhe kompani [45]<br>• Raportet mbi përfitimet nga marrëveshjet [46] dhe marredhenieve te bashkepunimit[47] te TBU ne kuaderte zhvillimit te praktikave thekson se përmes rreth 53 subjektesh bashkëpunuese, studentëve të programit MSh-IS u është mundësuar kontakti per zhvillimin e praktikës në pozicione reale pune, përfshirë edhe praktikë në vendin e punës për studentët e punësuar.<br><br>Gjithashtu, ofrohen trajnime për përdorimin e teknologjive mësimore dhe sistemeve LMS për studentët [48] [49]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Tirana Business University College ka ndërtuar një mekanizëm funksional institucional për bashkëpunimin ndërmjet njësive akademike dhe administrative, i cili shërben si themel për planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin efektiv të programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike (MSh-IS). Kjo marrëdhënie e brendshme bashkëpunimi bazohet në ndarjen e qartë të detyrave, rolet e përcaktuara dhe përdorimin e mjeteve analitike për vlerësimin e performancës institucionale.<br><br>*1. Hartimi dhe aprovimi i programit si proces bashkëpunues ndër-njësish*<br><br>Programi është hartuar përmes një procesi të integruar ndërmjet Departamentit të Inxhinierisë Softuerike (njësia bazë) dhe Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (njësia kryesore), në konsultim me strukturat e brendshme të institucionit dhe duke reflektuar strategjitë përkatëse. Ky bashkëpunim |

[41] 14.2. Ftese per panair
[42] 14.3. Raport-master FTI: *"Raport mbi aktivitetet e organizuara nga zyra per studentet e ciklit master ne fakultetin e teknologjise se informacionit"*
[43] 14.4. Raport-master FTI2: *"Raport mbi aktivitetet e organizuara ne bashkepunim me bizneset per studentet e ciklit master ne fakultetin e teknologjise se informacionit"*
[44] 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët
[45] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)
[46] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[47] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[48] 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
[49] 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS

| | |
|---|---|
| | formalizohet dhe drejtohet nga vendimi i ngritjes së Grupit të Vlerësimit të Brendshëm (GVB) për akreditimin e programit[50] ku përfshihen përfaqësues nga departamenti, fakulteti dhe njesia e cilësisë.<br><br>*2. Rregulloret institucionale që përcaktojnë detyrat dhe kompetencat*<br><br>Funksionimi i brendshëm institucional është i bazuar në Statutin e TBU[51] dhe më tej operacionalizohet përmes rregulloreve të Kolegjit Universitar TBU[52], Fakultetit[53], dhe Departamentit të Inxhinierisë Softuerike[54].<br><br>Këto dokumente përcaktojnë në mënyrë të detajuar:<br>• përgjegjësitë e strukturave akademike në propozimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve;<br>• rolin e koordinatorit të programit dhe pedagogëve përgjegjës për praktika, monitorim cilësie dhe këshillim akademik;<br>• format e bashkëpunimit ndërmjet njësive për integrimin e përmbajtjeve, koordinimin orarëve dhe ndarjen e ngarkesës.<br><br>*3. Analiza e performancës përmes mjeteve të vetëvlerësimit dhe monitorimit*<br><br>• Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik[55] dhe formatet e vlerësimit nga eprori-kolegu[56] përdoren për të analizuar vazhdimisht kontributin e secilit anëtar të stafit akademik në zbatimin cilësor të programit.<br>• Formati i monitorimit të syllabuseve[57] mundëson vlerësimin sistematik të përputhshmërisë së përmbajtjes me objektivat formues të programit.<br>• Raporti i analizës së objektivave formuese[58], i përgatitur nga departamenti, është një dokument kyç që përmbledh vlerësimet mbi realizimin e qëllimeve akademike të programit dhe sugjerimet për përmirësim.<br><br>*4. Ndarja e funksioneve administrative mbështetëse për programin*<br><br>• Zyra e Çështjeve Studentore koordinon veprimtaritë studentore dhe bashkëpunimet me industrinë [59];<br>• Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procesin e rekrutimit të stafit sipas politikave të përcaktuara në praktikat e rekrutimit dhe dokumentacionet standarde të stafit[60] [61] [62] [63]. |

[50] 68. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit MSH_IS
[51] 2.Statuti TBU
[52] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[53] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[54] 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
[55] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[56] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[57] 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[58] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[59] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
[60] 13.1. Shembull njoftim për vend vacant për staf akademik në website
[61] 13.2. Politika e BNJ në TBU
[62] 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAKPAE)
[63] 13.4. Praktika e rekrutimit të stafit

| | |
|---|---|
| | • Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) [64] [65] [66] [67] përgatit raporte vjetore të performancës institucionale dhe rekomandon përmirësime për programet.<br><br>5. *Evidencë e bashkëpunimit funksional ndërmjet njësive: një qasje integruese*<br><br>Ndarja funksionale nuk është vetëm formale, por realizohet në praktikë përmes bashkëpunimit konkret të strukturave në zhvillimin e praktikave profesionale, leksioneve të hapura [68] [69], mentorimit të diplomave dhe integrimit të feedback-ut nga tregu i punës. Kjo evidentohet në raportin e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit[70] ku bashkëpunimi i departamentit me ZÇS dhe aktorët e tregut vlerësohet në mënyrë të strukturuar për të përmirësuar përmbajtjen e programit. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | TBU i jep rëndësi të veçantë bashkëpunimit me aktorë të jashtëm për të garantuar që studentët të zhvillohen jo vetëm në aspektin akademik, por edhe në atë praktik, etik dhe profesional. Kjo realizohet përmes:<br><br>• Marrëdhënieve të bashkëpunimit me universitete të huaja dhe organizata ndërkombëtare, të dokumentuara në Aneksin mbi bashkëpunimet kombëtare e ndërkombëtare të FTI[71]. Këto bashkëpunime përfshijnë aktivitete të përbashkëta, shkëmbime stafi, lektorë të ftuar dhe pjesëmarrje në projekte të përbashkëta të kërkimit.<br>• Zyra e Çështjeve Studentore bashkëpunon me biznese për të organizuar aktivitete të drejtuara për studentët e programit, si panairi i punës[72], ditët informuese[73] dhe vizitat apo takimet inspiruese me liderë të industrisë dhe ekspertë ndërkombëtarë[74], duke e afruar mjedisin akademik me tregun e punës.<br><br>Ky nivel bashkëpunimi rrit ndjeshëm vlerën formuese të programit, duke e shndërruar atë në një hapësirë reale për përgatitjen për tregun global. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe | Praktika profesionale është një komponent kyç i programit MSh-IS dhe është e integruar në strukturën e kurrikulës si aktivitet formues, duke kërkuar domosdoshmërisht bashkëpunim të qëndrueshëm me kompani dhe institucione publike e private.<br><br>• TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kompani në fushën e TIK[75] [76] [77].<br>• Mbikëqyrja akademike e praktikës sigurohet përmes vendimeve për përcaktimin e pedagogëve udhëheqës të praktikës[78] dhe ndjekin nga afër përmbushjen e objektivave të praktikës për secilin student.<br>• Përveç praktikës, janë ndërmarrë hapa për përfshirjen e studentëve master në kërkime të stafit akademik (por perfshirja ende e pa |

[64] 35.1.1. Rregullore NJSBC
[65] 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
[66] 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
[67] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[68] 14.3. Raport-master FTI
[69] 14.4. Raport-master FTI2
[70] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[71] Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)
[72] 14.2. Ftese per panair
[73] 14.5. Ditët informuese në TBU
[74] 14.3. Raport-master FTI
[75] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)
[76] 36.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt
[77] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh-IS
[78] 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI

| | |
|---|---|
| mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | finalizuar), përmes projekteve të fituara pranë AKKSHI dhe bashkëpunimeve të tjera[79]. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Njësia bazë dhe ajo kryesore që mbulojnë programin kanë ndërtuar një praktikë të rregullt të vlerësimit të efektivitetit të bashkëpunimeve institucionale, përmes dokumenteve analitike që tregojnë si janë shfrytëzuar këto marrëveshje për të përmirësuar eksperiencën studentore dhe mësimdhënien.<br><br>• Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit[80] përmbledh qartësisht realizim e ketyre bashkepunimeve.<br>• Raportet e fokus grupeve me studentët[81] dhe planet vjetore të departamentit [82] reflektojnë të dhëna reale për ndikimin e bashkëpunimeve në përmbushjen e objektivave formuese si dhe për përmirësimin e përgatitjes profesionale.<br><br>Përmes kësaj qasjeje të bazuar në analizë, matje dhe dokumentim, institucioni demonstron angazhim të vërtetë në menaxhimin e bashkëpunimeve si pjesë përbërëse e cilësisë së programit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1** |
|---|
| **Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** |

[79] 33. Projektet e fituara nga TBU-Projekte ku eshte perfshire FTI
[80] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[81] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[82] 53.1. Plani vjetor i DIS 2023-2024

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike (MSh-IS) në TBU College është konceptuar dhe organizuar në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, ai respekton parashikimet e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"[83], si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit"[84].<br>Struktura e programit është ndërtuar në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe përfshin qartë të gjitha veprimtaritë formuese ne total 120 ECTS: lëndë bazë (5-10%: 6 ECTS), lëndët karakterizuese (50-60%: 66 ECTS), lëndë Ndërdisiplinore/Integruese (12-20%: 18 ECTS), lëndë plotesuese/Praktike dhe zhvillim karriere (10%: 12 ECTS) si dhe detyrimin përmbyllës (tezë diplome 10-15%: 18 ECTS).<br>Programi i shpërndarë në 120 kredite ECTS të strukturuara në dy vite akademike, zhvillohet përkatësisht në katër semestra, siç pasqyrohet në dokumentet zyrtare të kurrikulës[85] dhe planit mësimor të programit [86] [87]. Këto elementë janë të integruara sipas praktikave më të mira evropiane dhe sipas standardeve të përcaktuara në udhëzimet kombëtare për hartimin e programeve të ciklit të dytë të studimeve. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në lami të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi MSh-IS synon të zhvillojë profile të avancuara profesionale dhe akademike në fushën e inxhinierisë së softuerit. Objektivat formuese të programit janë të orientuara drejt përgatitjes së specialistëve të aftë për të kuptuar në mënyrë kritike teoritë, modelet, dhe paradigmën teknologjike të zhvillimit të softuerit, duke përfshirë njohuritë për arkitektura softuerike, dizajnin e sistemeve komplekse, infrastrukturat cloud-native, AI dhe inteligjencën e aplikuar.<br>Përmes këtij programi, studentët pajisen me kompetenca për të analizuar, projektuar dhe implementuar zgjidhje në mjedise me pasiguri të lartë dhe përballë kërkesave që ndryshojnë me shpejtësi, duke u bërë kontribuues të rëndësishëm në sektorin e industrisë TIK dhe kërkimit aplikativ. Të gjitha këto synime janë të integruara në strukturën e kurrikulës[88] [89], planin mësimor[90] [91] dhe syllabuset përkatëse[92]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës | Programi parashikon në mënyrë të qartë organizimin e praktikës profesionale dhe detyrimit përmbyllës të tezës së diplomës si pjesë integrale e planit të studimeve. Praktika profesionale, me një ngarkesë prej 12 ECTS, zhvillohet në |

[83] 61. Ligj_80-2015_22.07.2015: "LIGJ Nr.80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.

[84] 65. VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar

[85] 16.1. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (shqip)

[86] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)

[87] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"

[88] 16.1. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (shqip)

[89] 16.2. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (anglisht)

[90] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)

[91] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"

[92] Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)

| | |
|---|---|
| profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | bashkëpunim me kompani dhe institucione të sektorit TIK[93] [94]. Procesi i mbikëqyret nga pedagogë të caktuar dhe përfshin raportim të dokumentuar të progresit të studentëve [95].<br>Teza e diplomës zë një peshë të rëndësishme prej 18 ECTS, dhe udhëzohet përmes dokumenteve specifike të hartuara nga departamenti si "Formati i tezës"[96] dhe Udhëzim për përgatitjen e diplomës[97], duke përfshirë temat e propozuara, rregullat e strukturimit, mënyrën e dorëzimit dhe mbrojtjes. Kjo siguron përputhje me kërkesat e VKM nr. 41/2018[98] për komponentët e programeve të studimit të ciklit të dytë. |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | Nuk aplikohet. Programi Master në Inxhinieri Softuerike nuk është i orientuar drejt formimit të mësuesve dhe nuk përbën program në fushën e Mësuesisë. Për këtë arsye, kriteret që lidhen me formimin pedagogjik dhe organizimin e specifik të këtyre programeve nuk janë të zbatueshme. |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi. Programi Master në Inxhinieri Softuerike nuk është i orientuar drejt formimit të mësuesve dhe nuk përbën program në fushën e Mësuesisë. Për këtë arsye, kriteret që lidhen me formimin pedagogjik dhe organizimin e specifik të këtyre programeve nuk janë të zbatueshme. |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e organizimit të studimeve në këtë program, si dhe mënyra e pranimit dhe financimit të studentëve, realizohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 80/2015[99]. Procedurat për aplikimin dhe pranimin janë të dokumentuara në rregulloren përkatëse të programit[100] [101], e cila përfshin kriteret e pranimit, mënyrat e vlerësimit dhe dokumentacionin e nevojshëm.<br>Financimi i studimeve dhe politika e tarifave është e rregulluar në përputhje me aktet e brendshme të institucionit dhe dokumentacionin zyrtar mbi tarifat dhe bursat[102] [103] [104] [105] [106] që përfshin gjithashtu dhe skema të mbështetjes me kontrata dhurimi nga fondacione të partnerëve institucionalë (si Mane |

[93] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)
[94] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[95] 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
[96] 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar
[97] 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[98] 65. VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementet e programeve të studimit e ndryshuar
[99] 61. Ligj_80-2015_22.07.2015: "LIGJ Nr.80/2015 PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN SHKENCOR NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.
[100] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)
[101] 9.1. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (anglisht)
[102] 60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25
[103] 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025
[104] 60.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite
[105] 60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23
[106] 60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| | Foundation). Kjo siguron akses dhe barazi për studentët me performancë të lartë ose nevoja të veçanta ekonomike. |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi MSh-IS është në përputhje me programet e ngjashme në vend dhe jashtë tij. Krahasimi është bërë nëpërmjet analizave të përmbajtjes kurrikulare dhe strukturës së moduleve, duke u siguruar që së paku 70% e përmbajtjes të përputhet me programet homologe në universitete evropiane dhe rajonale. Kjo qasje është mbështetur nga bashkëpunimet me institucione të tjera, marrëveshjet ndërkombëtare të mobilitetit dhe përpjekjet për ndërkombëtarizim të dokumentuara në marrëveshjet e bashkëpunimit [107] dhe në planifikimin strategjik të programit [108] [109]. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi është i koduar sipas klasifikimit të miratuar nga MAS dhe përputhet me VKM Nr. 310, datë 11.05.2022[110] dhe udhëzimin nr. 31, datë 15.11.2022 për kodifikimin e programeve të studimit. Kodi i programit është konfirmuar nga Ministria e Arsimit përmes shkresës zyrtare përkatëse ku njihet kodi i programit dhe lidhja e tij me profilin e institucionit. Konkretisht me Kodin: 72MS0613S [111].<br>Për më tepër, edhe kodifikimi i lëndëve individuale është kryer në përputhje me këto udhëzime dhe është i dokumentuar në silabuset e programit[112] duke siguruar standardizim të përmbajtjes dhe gjurmueshmëri në sistemet e raportimit akademik. |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Aktualisht programi MSh-IS nuk është një program i përbashkët midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën | Njësia përgjegjëse për programin MSh-IS është Departamenti i Inxhinierisë Softuerike (DIS), në përbërje të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI), si njësi bazë dhe kryesore akademike. Kjo njësi është ngritur dhe funksionon në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë..." dhe Statutin e Kolegjit Universitar TBU[113], si dhe është miratuar me Vendim të |

[107] Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)
[108] 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IS
[109] 16.1. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (shqip)
[110] 67.1.VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz
[111] 67.5. Shkresa e MAS Nr. 738122, dt. 30.12.2024 për Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University
[112] Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht).
[113] 2. Statuti TBU

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Senatit Akademik Nr. 9-1, datë 16.11.2022 për hapjen e programeve të ciklit të dytë në fushën e Teknologjisë së Informacionit[114]. <br>DIS përmbush të gjitha kërkesat mbi organizimin e strukturës akademike, rekrutimin dhe kualifikimin e stafit akademik, si dhe detyrimet lidhur me cilësinë, vlerësimin dhe përgatitjen për akreditim. Kjo dokumentohet përmes CV-ve të stafit akademik[115], rregullores së departamentit[116], planit vjetor të departamentit[117], si dhe të dhënave tabelore për personelin e angazhuar në program[118] [119] [120]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Njësia bazë dhe kryesore DIS/FTI ka angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ për mbështetjen e proceseve praktike, laboratorike dhe administrative të programit. Këtu përfshihet mbështetja në zhvillimin e praktikave profesionale, koordinimi me Zyrën e Çështjeve Studentore për lidhjet me tregun e punës[121], administrimi i platformave mësimore online[122] [123] [124] [125], si dhe menaxhimi i dosjeve dhe dokumentacionit të studentëve. <br>Po ashtu, Zyra e Burimeve Njerëzore ka strukturuar formatet e rekrutimit të stafit ndihmës dhe tekniko-administrativ [126] [127], dhe politika për përfshirjen e tyre në realizimin e komponentëve praktikë është e integruar në dokumentacionin institucional. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Për programin Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike është caktuar një koordinator programi në përputhje me udhëzimet përkatëse të rregulloreve akademike [128] [129]. Koordinatori është përgjegjës për ndjekjen e zhvillimit të programit në aspektin akademik dhe organizativ, për mbikëqyrjen e përmbushjes së objektivave formuese, bashkëpunimin me pedagogët për mbajtjen e syllabus-eve dhe për mbështetjen e studentëve gjatë praktikës profesionale. <br>Roli i tij formalizohet përmes vendimit përkatës institucional[130] dhe zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me strukturat e departamentit dhe fakultetit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi II.3**
**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.**

---

114 2.1.2 Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
115 CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
116 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
117 53.1. Plani vjetor i DIS 2023-2024
118 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2)
119 Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MSh-IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 6,12,7,8)
120 Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4)
121 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
122 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit
123 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
124 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
125 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS
126 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAKPAE)
127 13.4. Praktika e rekrutimit të stafit
128 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
129 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)
130 38. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MShIS

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Departamenti i Inxhinierisë Softuerike (njësia bazë përgjegjëse) disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacioni është i dokumentuar në format zyrtar në gjuhën shqipe dhe angleze[131] [132] [133] [134] [135] dhe është në dispozicion për studentët dhe stafin përmes platformës LMS, zyrës së informacionit akademik, dhe dokumentacionit të printuar në dosjet e programit. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi MSh-IS përmban planin mësimor të detajuar sipas strukturës semestrale, me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për çdo lëndë, ndarjen e krediteve sipas ECTS, dhe orët teorike/praktike brenda e jashtë auditorit. Ky plan mësimor është pjesë e dokumenteve të detyrueshme [136] [137] [138] dhe përmban informacion të plotë mbi përbërjen e komponentëve formues, duke përfshirë praktikën profesionale dhe temën e diplomës. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Të gjitha informacionet për kriteret e pranimit, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve janë të përfshira në rregulloren e programit[139], rregulloren e institucionit[140] dhe në udhëzimet përkatëse të miratuara nga MAS. Procedurat janë të dokumentuara dhe të afishuara për studentët përmes platformës së brendshme dhe zyrave të informacionit të fakultetit. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi përmban syllabus të plotë për çdo lëndë të ofruar[141] ku përfshihet përmbajtja teorike, temat e seminareve dhe orëve praktike apo laboratorike. Çdo syllabus është përgatitur sipas formatit të miratuar me VKM nr. 41/2018 dhe pasqyron ndarjen e ngarkesës brenda dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit dhe kompetencat që zhvillon lënda. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Përmbajtja e programit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Çdo fillim viti akademik realizohet analizë përmbledhëse mbi ecurinë e programit dhe propozohen ndryshime në kurrikulë apo syllabus nga departamenti përgjegjës [142] [143]. Ndryshimet aprovohen në nivel fakulteti dhe dokumentacioni arkivohet në dy gjuhë – shqip dhe anglisht – siç kërkohet nga praktikat e transparencës dhe ndërkombëtarizimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|

[131] 16.1. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (shqip)
[132] 16.2. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (anglisht)
[133] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[134] 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)
[135] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[136] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[137] 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)
[138] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[139] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)
[140] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[141] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[142] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[143] 53.1. Plani vjetor i DIS 2023-2024

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.4<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi MSh-IS është projektuar në mënyrë që emërtimi i tij, përmbajtja akademike, shpërndarja e lëndëve dhe përfshirja e praktikave profesionale të jenë në funksion të përgatitjes së studentëve për punësim dhe/ose studime të mëtejshme në cikle më të larta. Struktura përfshin lëndë të avancuara në inxhinieri softuerike, menaxhim të projekteve, siguri informatike dhe inteligjencë artificiale, që janë fushat më të kërkuara në tregun e punës. Ky format i kurrikulës pasqyron objektivat formues dhe mbështet përmbushjen e rezultateve të pritshme të të nxënit[144] [145] [146] [147] [148]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Programi është i strukturuar në dy vite akademike dhe katër semestra, me shpërndarje të barabartë të ngarkesës mësimore dhe me balancim të lëndëve teorike dhe praktike. Çdo lëndë është e vlerësuar me kredite ECTS dhe me orë mësimore teorike, praktike dhe vetë-studimi jashtë auditorit, siç dokumentohet në planin mësimor [149] [150] [151] dhe syllabusët përkatës[152]. Kjo strukturë mundëson arritjen e kompetencave kërkimore, analitike dhe zbatimore në përputhje me standardet e Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Programi MSh-IS është ndërtuar në përputhje me profilet ndërkombëtare të ngjashme në universitetet europiane. Raporti ndërmjet përmbajtjes teorike dhe praktikës është 50% teori dhe 50% praktikë, i cili konsiderohet optimal për formimin profesional të studentëve të ciklit të dytë shkencor. Struktura e programit është harmonizuar me praktikat më të mira ndërkombëtare në përgatitjen e inxhinierëve të softuerit. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Veprimtaritë formuese janë të ndara në mënyrë të qartë në përbërës teorikë, praktikë profesionale dhe komponentë kërkimorë. Plani mesimor sipas veprimtarive formuese[153] përfshin qartë të gjitha veprimtaritë formuese ne total 120 ECTS: lëndë bazë (5-10%: 6 ECTS), lëndët karakterizuese (50-60%: 66 ECTS), lëndë Ndërdisiplinore/Integruese (12-20%: 18 ECTS), lëndë plotesuese/Praktike dhe zhvillim karriere (10%: 12 ECTS) si dhe detyrimin përmbyllës (tezë diplome 10-15%: 18 ECTS). Kjo ndarje siguron përgatitjen e studentëve për mobilitet akademik, transferim studimesh brenda dhe jashtë vendit |

[144] 16.1. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (shqip)
[145] 16.2. Kurrikula e programit MSH Inxhinieri Software (anglisht)
[146] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[147] 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)
[148] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[149] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)
[150] 16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)
[151] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[152] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[153] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | dhe për një kalim të suksesshëm në tregun e punës. Për më tepër, komponenti i praktikës profesionale (12 ECTS) u mundëson studentëve të përjetojnë mjedisin real të punës dhe të integrojnë njohuritë e marra në situata konkrete. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Syllabuset për çdo lëndë përditësohen çdo vit akademik, duke reflektuar zhvillimet e fundit teknologjike, literaturën më të re dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Përdorimi i literaturës bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit siguron përgatitjen bashkëkohore të studentëve. Kjo është e dokumentuar në syllabusët e lendeve[154], si dhe në raportet periodike të analizës së departamentit mbi përmbajtjen e kurrikulës[155] [156]. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e programit është ndërtuar në mënyrë që të garantojë zhvillimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave që kërkohen për një Master Shkencor ne Inxhinieri Software. Lëndët e specializuara, përvoja e praktikës dhe kërkimi përmes tezës finale janë të integruara për të ofruar një formim të plotë dhe të thelluar në fushën e inxhinierisë softuerike[157] [158] [159]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi siguron bazën e duhur për vazhdim të mëtejshëm akademik në ciklin e tretë (doktoratë) dhe/ose për integrim të menjëhershëm në tregun e punës. Praktikat profesionale, leksionet nga ekspertë të fushës, dhe bashkëpunimet me kompani TIK[160] [161] [162] [163] [164] kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e mundësive të punësimit për studentët pas diplomimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e | Për hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike (MSh-IS), Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike kanë ndërmarrë një sërë konsultimesh me aktorë të jashtëm, përfshirë institucione partnere, kompani të sektorit TIK, alumni dhe përfaqësues të tregut të punës. Këto konsultime janë formalizuar përmes Bordit të Tregut të Punës[165], takimeve periodike dhe përpunimit të feedback-ut nga përfaqësues të industrisë gjatë aktiviteteve akademike si leksionet e hapura, panelet e diskutimit dhe praktikat profesionale. |

[154] Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[155] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[156] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[157] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[158] 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[159] Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[160] 14.3. Raport-master FTI
[161] 14.4. Raport-master FTI2
[162] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)
[163] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[164] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[165] 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP - 28.05.2024

| | |
|---|---|
| institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Këto kontribute janë reflektuar konkretisht në përshtatjen e përmbajtjes së lëndëve me kërkesat e reja të tregut[166] [167], si dhe orientimin e praktikës në institucione që ofrojnë mjedise reale pune për studentët[168]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Institucioni nxit dhe përfshin studentët aktivisht në procesin e përmirësimit të programit përmes strukturave të përfaqësimit studentor dhe mekanizmave të institucionalizuar të feedback-ut. Studenti përfaqësues në Këshillin e Departamentit dhe Senatin Studentor[169] [170] kontribuon me sugjerime për përmbajtjen dhe organizimin e studimeve. Për më tepër, realizohen fokus grupe të rregullta[171], ku studentët ofrojnë vlerësime të detajuara për përmbajtjen e lëndëve, metodologjinë e mësimdhënies, si dhe eksperiencën në praktikën profesionale.<br>Studentët e diplomuar do te kontaktohen (sepse ende nuk kemi te diplomuar) nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Shoqata Alumni për të gjurmuar suksesin e tyre në tregun e punës dhe për të mbledhur sugjerime mbi përmirësimet që mund të bëhen në kurrikulë dhe në përgatitjen e brezave të ardhshëm. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Përditësimi dhe përshtatja e përmbajtjes së programit bëhet në bashkëpunim të ngushtë me rrjete profesionistësh dhe institucione të specializuara kombëtare e ndërkombëtare. Këto përfshijnë bashkëpunime me kompani softuerike vendase dhe të huaja, partneritete të dokumentuara për praktikën dhe kërkimin[172] [173] [174] [175] si dhe pjesëmarrjen në rrjete kërkimore dhe projekte të përbashkëta[176] [177].<br>Përmes këtyre kanaleve, departamenti merr informacion në kohë reale mbi zhvillimet e fundit në teknologji dhe e reflekton atë në përmbajtjen e syllabusëve dhe strukturën e kurrikulës. Ky bashkëpunim strategjik ndihmon që programi të qëndrojë në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushë dhe të përgatisë profesionistë konkurrues në tregun global të punës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike është ndërtuar mbi objektiva të qarta formuese dhe kërkimore, në përputhje me qëllimet madhore të institucionit dhe me strategjinë e tij të zhvillimit akademik dhe shkencor[178] [179]. Objektivat përfshijnë zhvillimin e aftësive analitike, konceptuale dhe zgjidhjes së problemeve komplekse në fushën e inxhinierisë softuerike, si dhe nxitjen e |

[166] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[167] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[168] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[169] 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU
[170] 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
[171] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[172] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi ( Aneks Tabela 5)
[173] 36.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt
[174] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[175] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[176] 33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku jane perfshire pedagoget e DIS/Projekte te fituara tek AKKSHI
[177] 45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)
[178] 3.2. Stratregjia e Kërkimit Shkencor 24-29
[179] 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IS

| | |
|---|---|
| | kërkimit të aplikuar dhe ndërdisiplinor në fusha si inteligjenca artificiale, siguria informatike dhe sistemet e shpërndara. Këto prioritete janë të integruara në strukturën e programit, veçanërisht përmes komponentëve kërkimorë si tema e diplomës dhe përfshirja e studentëve në projekte konkrete[180]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | Departamenti i Inxhinierisë Softuerike, si njësi bazë, ka krijuar një ambient të hapur dhe mbështetës për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe veprimtarive akademike. Liria akademike dhe autonomia kërkimore e stafit respektohen dhe promovohen përmes planeve individuale të kërkimit, pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përmes strukturave institucionale si Qendra për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike – QKSEJ[181] [182] [183]. Bashkërendimi midis mësimdhënies dhe kërkimit realizohet përmes integrimit të përmbajtjeve kërkimore në syllabus, inkurajimit për mentorim akademik në temën e diplomës dhe përfshirjes së studentëve në aktivitetet kërkimore të stafit. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Programi nxit angazhimin e studentëve në kërkim shkencor dhe projekte të avancuara që lidhen me fushën e tyre të studimit. Studentët inkurajohen të përfshihen në projektet e pedagogëve[184], si dhe të marrin pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga TBU[185] ose partnerët e tij. Për më tepër, teza e diplomës u jep mundësi të aplikojnë njohuritë në një projekt konkret kërkimor ose zhvillimor të mbështetur me mentorim të specializuar. |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Përfshirja në projekte kërkimore dhe zhvillimi i kapaciteteve shkencore përbën një objektiv të qartë për periudhën e ardhshme. Kjo synohet të realizohet nëpërmjet aplikimeve për grante kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përmes aktivizimit të bashkëpunimeve me institucione partnere dhe rrjete profesionale[186] [187] [188]. Plani strategjik i zhvillimit të programit dhe politikave të institucionit parashikon mbështetje financiare për zhvillimin e kërkimit, mobilitetin akademik dhe organizimin e veprimtarive shkencore, që do të operacionalizohen në fazën e radhës të zhvillimit të departamentit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të | Departamenti i Inxhinierisë Softuerike si njësi përgjegjëse mbështet vazhdimisht krijimin dhe zhvillimin e grupeve lëndore dhe promovon nisma të reja kërkimore në bashkëpunim me struktura të tjera të TBU apo partnerë të jashtëm. Megjithëse jemi në fazën fillestare të konsolidimit të programit, janë identifikuar fusha prioritare për kërkim (si siguria kibernetike, aplikacionet AI, dhe zhvillimi i |

[180] 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[181] 42. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike - QKSEJ
[182] 42.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore -shkencore për personelin akademik
[183] 42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit MShIS (Aneks Tabela 19)
[184] 33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku jane perfshire pedagoget e DIS/Projekte te fituara tek AKKSHI
[185] 58.1. Brochure Scientific Conference TBU
[186] 4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IS
[187] 33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku jane perfshire pedagoget e DIS/Projekte te fituara tek AKKSHI
[188] 45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| programit të studimit në kërkim shkencor. | softuerëve të qëndrueshëm) dhe ka nisur puna për krijimin e partneriteteve me institucione që operojnë në të njëjtat fusha[189 190 191]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | DIS është angazhuar për të zhvilluar kapacitetet kërkimore të stafit dhe për të përfshirë studentët në aktivitete studimore me karakter aplikativ. Edhe pse angazhimi në projekte të jashtme kërkimore është në proces planifikimi, vetë struktura e programit e favorizon këtë orientim përmes tezave të avancuara dhe lidhjes së tyre me çështje të vërteta nga industria. Gjithashtu, stafi akademik është inkurajuar të ndjekë zhvillime të reja shkencore dhe të kontribuojë me studime në konferenca ose botime institucionale[192 193 194]. |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | Programi parashikon organizimin dhe pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit në aktivitete akademike dhe kërkimore. TBU ka organizuar konferenca shkencore të hapura dhe simpoziume ku stafi i departamentit është ftuar të kontribuojë me prezantime dhe diskutime tematike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe softuerit[195 196]. Këto aktivitete ndihmojnë në rritjen e profilit të programit dhe në krijimin e një kulture të vazhdueshme kërkimi. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. Përmbajtja e lëndëve, mënyra e vlerësimit dhe komponentët praktikë janë në përputhje me standardet evropiane të formimit master, duke përfshirë aftësi analitike, kodim të avancuar, dizajnim arkitekturash softuerike dhe menaxhim të sistemeve te informacionit [197 198]. Studentët janë të përgatitur të ndjekin karrierë në kompani teknologjike të nivelit të lartë brenda dhe jashtë vendit. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Departamenti ndjek rregullisht rekomandimet e shoqatave dhe rrjeteve profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit. Për shembull, struktura e programit është përshtatur sipas direktivave dhe nevojave të nxjerra nga forume si IEEE, ACM dhe bashkëpunëtorë lokalë si ICTSmedia dhe Albanian ICT Academy. Kjo siguron që kompetencat që fiton studenti janë të aplikueshme dhe të certifikueshme edhe nëse kërkohet licencim profesional në të ardhmen. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Programi nuk klasifikohet si "profesion i rregulluar" në kuptimin juridik të ligjit për arsimin e lartë, por është projektuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të përshkruara në dokumente si Directiva 2005/36/EC për njohjen profesionale dhe kornizat EQF dhe NQF. Kjo përputhje ndihmon në mobilitetin ndërkombëtar të studentëve, si dhe në lehtësimin e njohjes së diplomave në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

189 3.2. Stratregjia e Kërkimit Shkencor 24-29
190 33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku jane perfshire pedagoget e DIS/Projekte te fituara tek AKKSHI
191 45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)
192 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
193 42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit MShIS (Aneks Tabela 19)
194 58.2. Program of TBU Conference
195 58.1. Brochure Scientific Conference TBU
196 58.2. Program of TBU Conference
197 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
198 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Instituconi i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Sipas rregullores përkatëse të TBU-së dhe të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit[199] [200] [201], si dhe në rregulloren specifike të programit të studimit MSH në Inxhinieri Software[202] [203], janë përcaktuar qartësisht format e mësimdhënies dhe mësimnxënies që zbatohen në këtë program. Këto përfshijnë **leksione, seminare, punë laboratorike, ese/detyra kursi, projekte, praktika profesionale dhe orë të hapura.** Në mënyrë më të detajuar, këto veprimtari janë të pasqyruara në **planin mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese**[204], si dhe në **syllabuset e lëndëve të programit**[205], të cilat janë hartuar sipas formatit të miratuar nga VKM nr. 41/2018[206]. Syllabuset përçdo lëndë përshkruajnë objektivat, rezultatet e të nxënit, metodat e mësimdhënies dhe mënyrat e vlerësimit.<br><br>Programi Master Shkencor në Inxhinieri Software është një program i ciklit të dytë, me **kohëzgjatje dy vite akademike dhe 120 kredite ECTS**[207] [208]. Studimet realizohen në **formë të rregullt me kohë të plotë**, dhe parashikojnë një **ngarkesë totale prej 3,000 orësh**, ku 1175 **orë janë mësim në auditor** dhe |

[199] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU,
[200] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit,
[201] 7 Rregullore e Departamentit te Inxhinierise Software
[202] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (shqip),
[203] 9.1. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (anglisht)
[204] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[205] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[206] 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
[207] 16.1. Kurrikula e programit MSh "Inxhinieri Software" (shqip),
[208] 16.2. Kurrikula e programit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)

| | |
|---|---|
| | 1825 orë janë **studim individual dhe punë e pavarur**[209]. **Leksionet dhe seminaret zhvillohen gjatë 15 javëve të semestrit**, ndërsa në **javën e 14-të**, studentët dorëzojnë detyrat e kursit/esetë për vlerësim, sipas përcaktimeve në syllabuse dhe kalendarin akademik[210 211]. **Punët laboratorike** realizohen në ambiente të pajisura me teknologji të avancuar dhe softuer profesional të fushës së inxhinierisë softuerike, të detajuara në dokumentet mbi infrastrukturën dhe platformat teknologjike[212 213 214 215]. **Praktikat profesionale** përbëjnë një pjesë të rëndësishme të programit dhe organizohen në bashkëpunim me institucione dhe kompani partnere, të cilat kanë marrëveshje të formalizuara me TBU[216 217], dhe mbështeten nga **pedagogë udhëheqës të caktuar për secilin vit akademik**[218]. **Vlerësimi i dijeve është i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit**, duke kombinuar format e testimit, projektet, pjesëmarrjen dhe detyrat individuale, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë dhe përmirësojnë mangësitë para vlerësimit final[219 220]. Në funksion të lidhjes së ngushtë të programit me tregun e punës, Departamenti i Inxhinierisë Software ka organizuar **leksione të hapura me profesionistë të fushës së teknologjisë së informacionit**, në bashkëpunim me **Bordin e Tregut të Punës të FTI** dhe Zyrën e Çështjeve Studentore[221 222 223]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Përmes një qasjeje të fleksibël dhe të orientuar drejt studentit, stafi akademik i angazhuar në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software zbaton metoda të ndryshme mësimdhënieje që marrin parasysh stilin dhe ritmin e të nxënit të secilit student. Lëndët strukturohen në mënyrë që të mundësojnë jo vetëm transmetimin e njohurive, por edhe nxitjen e përfshirjes aktive dhe ndërtimin e aftësive analitike. Në zhvillimin e seancave mësimore përdoren mjete të ndryshme didaktike dhe teknologjike – si **projektorët, platformat LMS, kompjuterët dhe softuerët profesionalë** – që lehtësojnë ndërveprimin, qasjen në materialet mësimore dhe zhvillimin e aftësive teknike. Gjithashtu, **metodat aktive të mësimdhënies** si analiza e rasteve, diskutimet në grupe, prezantimet dhe detyrat praktike janë të integruara në përmbajtjen e syllabus-eve të lëndëve[224]. Për më tepër, përmes bashkëpunimit me përfaqësues të industrisë dhe organizimit të **leksioneve të hapura me profesionistë të fushës**, studentëve u ofrohet një përvojë mësimore e pasur dhe dinamike, që tejkalon format tradicionale dhe përgatit ata për realitetin profesional[225]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Stafi akademik i angazhuar në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software përkrahet vazhdimisht nga institucioni në zhvillimin dhe përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Qasja e TBU-së për mësimdhënie cilësore dhe të orientuar drejt studentit, pasqyrohet në nisma të vazhdueshme për trajnimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të stafit akademik. Në kuadër të zhvillimit profesional, TBU organizon rregullisht **trajnime mbi metodologjitë e mësimdhënies**, përdorimin e teknologjive të reja dhe platformave digjitale të të nxënit, si dhe vlerësimin efektiv të rezultateve të të |

209 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
210 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
211 12.1. Kalendari akademik 2023-2024, 12.2. Kalendari akademik 2024-2025
212 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16),
213 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit,
214 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS,
215 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)
216 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS,
217 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
218 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
219 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
220 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
221 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP,
222 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI,
223 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI.
224 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
225 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI

| | |
|---|---|
| | nxënit[226]. Këto trajnime adresojnë si nevojat e pedagogëve me përvojë, ashtu edhe të **pedagogëve të jashtëm**, për të garantuar që të gjithë anëtarët e stafit të jenë të njohur me **specifikat institucionale dhe metodikat bashkëkohore të mësimdhënies**. Për më tepër, TBU inkurajon pjesëmarrjen e stafit në **mobilitete akademike dhe programe shkëmbimi me universitete partnere**, duke u mundësuar atyre të marrin kontakt të drejtpërdrejtë me përvoja ndërkombëtare dhe praktika të suksesshme pedagogjike[227] [228]. Gjithashtu, përmes strukturave të brendshme si **Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë** dhe **Komisionet për Cilësinë në fakultet**, mbikëqyret dhe mbështetet zhvillimi i kompetencave të stafit në përputhje me **rezultatet e pritshme të të nxënit**, nëpërmjet monitorimit të syllabus-eve dhe vlerësimeve periodike[229]. Kjo qasje sistematike dhe e qëndrueshme përbën një garanci për ofrimin e mësimdhënies në standarde të larta cilësie dhe në përputhje me objektivat e programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Përzgjedhja dhe përfshirja e personelit akademik në programin MSh në Inxhinieri Software realizohet në përputhje me **rregulloret e brendshme të TBU-së** për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit[230] [231]. Procesi i përzgjedhjes zhvillohet mbi bazën e **kritereve të publikuara**, të cilat përfshijnë eksperiencën universitare, kualifikimet akademike dhe përvojën profesionale në fushën e teknologjisë dhe inxhinierisë softuerike. Përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierisë Software është i përfshirë drejtpërdrejt në këtë proces, ashtu si edhe në **vlerësimin periodik të performancës** së stafit[232] [233]. **Kompetenca e stafit akademik** pasqyrohet në strukturën dhe përmbajtjen e syllabus-eve për secilën lëndë[234], ku **seksioni "Metoda pedagogjike e përdorur në seminarin e radhës"** përshkruan qartë teknikat e përdorura në përputhje me objektivat e të nxënit dhe nevojat e studentëve. Këto metoda përfshijnë **diskutime të udhëhequra nga pedagogu, analizë të rasteve studimore, prezantime në grup**, si dhe **përdorim të mjeteve teknologjike dhe materiale audiovizuale** për të nxitur ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve në orët e leksioneve dhe seminareve[235] [236]. Mësimdhënia zhvillohet në një formë që ndërthur **aspektin teorik me aplikimin praktik**, duke e vendosur studentin në qendër të procesit dhe duke i nxitur ata për të menduar në mënyrë **kritike, krijuese dhe të pavarur**. Përdorimi i **artikujve shkencorë, literaturës së avancuar dhe detyrave që kërkojnë zgjidhje konkrete problemesh** është pjesë e vazhdueshme e strategjisë së programit për të rritur cilësinë e të nxënit[237] [238]. Në funksion të **kultivimit të bashkëpunimit mes studentëve**, shumë prej detyrave të kursit zhvillohen në formën e **prezantimeve në grup**, duke vlerësuar aftësitë e komunikimit, organizimit dhe punës në ekip. Kjo ndihmon në zhvillimin e **autonomisë personale dhe përgjegjësisë kolektive** te studentët, si dhe në forcimin e **marrëdhënieve të ndërsjella respektuese** mes tyre dhe pedagogëve[239] [240]. |

[226] 37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët
[227] 45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20),
[228] 46.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve.
[229] 39 Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[230] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit,
[231] 13.4. Praktika e rekrutimit te stafit.
[232] 35.11. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu,
[233] 35.12. Praktike e vlerësimit total të performances të pedagogut
[234] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[235] 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit,
[236] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
[237] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[238] 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
[239] 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI,
[240] 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, përfshirja e studentëve në vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies është një praktikë e institucionalizuar dhe e vazhdueshme. Studentët ftohen të shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet **pyetësorëve të strukturuar për vlerësimin e lëndës dhe pedagogut**, të cilët administrohen në mënyrë periodike nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë[241]. Mendimet e mbledhura analizohen dhe raportohen në dokumente të posaçme, si **Raporti i Fokus Grupeve**[242], ku identifikohen pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave të mësimdhënies nga stafi akademik, i cili reflekton mbi to gjatë planifikimit të lëndëve për semestrin pasardhës. Kështu, përmes pjesëmarrjes aktive të studentëve dhe vëmendjes së vazhdueshme të njësisë përgjegjëse, sigurohet jo vetëm një **mësimdhënie dinamike dhe bashkëkohore**, por edhe një **proces i hapur dhe transparent për përmirësim të vazhdueshëm cilësor** në përputhje me pritshmëritë e studentëve dhe standardet akademike të programit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Tirana Business University ka ngritur dhe funksionalizuar struktura të mirëpërcaktuara për garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në procesin e mësimdhënies. Në nivel institucional, **Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)** është një njësi e përhershme dhe e pavarur që mbikëqyr dhe vlerëson cilësinë e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Kjo njësi funksionon në bashkëpunim të ngushtë me **Komisionet e Cilësisë** pranë njësive kryesore, siç është rasti i **Komisionit të Cilësisë pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (KC FTI)**[243] [244] [245][246]. **Plani i punës vjetor i NJSBC dhe KC FTI** përfshin monitorimin sistematik të mësimdhënies në nivel departamenti dhe programi studimi, dhe hartimin e rekomandimeve për përmirësime të nevojshme[247] [248]. Njësitë përgjegjëse koordinojnë me Departamentin e Inxhinierisë Software në funksion të analizës së arritjeve të objektivave të formimit të programit[249], si dhe monitorojnë periodikisht syllabus-et për çdo lëndë[250], duke reflektuar çdo ndryshim të nevojshëm në përputhje me praktikat më të mira bashkëkohore. Institucioni mbështet gjithashtu **zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies**, nëpërmjet nxitjes së **eksperimentimit pedagogjik**, përdorimit të teknologjive digjitale dhe materialeve të avancuara për leksione interaktive[251] [252]. Këto mjete ndihmojnë në thjeshtësimin e përçimit të dijes dhe e bëjnë mësimdhënien më efikase dhe të përshtatur me nevojat e studentëve. Për të përforcuar kapacitetet e stafit akademik, organizohen **trajnimet e vazhdueshme** në lidhje me përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies, qasjet ndaj të nxënit me në qendër studentin, dhe integrimin e risive pedagogjike në lëndët e ofruara[253]. Gjithashtu, janë të dokumentuara praktikat e **vlerësimit të performancës së stafit akademik** nga eprorët dhe kolegët[254], si dhe vlerësimi nga studentët përmes **fokus-grupeve** dhe |

[241] 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[242] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[243] 35.1.1. Rregullore e NJSBC,
[244] 35.1.2. Politika per Sigurimin e Cilesise
[245] 35.1.3.Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise
[246] 35.4. Plani pune i KSC FTI 24-25
[247] 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025,
[248] 35.6. Raporti vjetor i KSC FTI 23-24
[249] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[250] 39 Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[251] 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit
[252] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
[253] 37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët,
[254] 35.11. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pyetësorëve të strukturuar[255] [256]. Në kuadër të aktiviteteve për cilësinë, organizohen gjithashtu **leksione të hapura me ekspertë të industrisë dhe profesionistë të fushës**, të cilat ndihmojnë në ndërlidhjen e përmbajtjes akademike me praktikën profesionale dhe në përditësimin e metodave mësimore me tendencat më të fundit të tregut[257]. Përmes bashkëpunimit institucional, mekanizmave të brendshëm të monitorimit dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë të stafit akademik, TBU garanton një qasje të integruar dhe dinamike për **rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies** në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Format dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive të studentëve në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software janë të përcaktuara qartë në kuadër të Rregullores së programit të studimit[258] dhe të Rregullores së Kolegjit Universitar TBU[259]. Në këto dokumente theksohen format e vlerësimit të përvetësimit të dijes gjatë kursit, të cilat përfshijnë: aktivizimin në orët mësimore, detyrat e kursit, projektet, testet e ndërmjetme dhe provimet përfundimtare. Studentët njihen me këto forma që në fillim të çdo lënde, përmes syllabusit, i cili paraqet në mënyrë të detajuar metodologjinë e vlerësimit dhe përbërjen e notës përfundimtare[260]. Seksione të veçanta në syllabus-in standard[261] përshkruajnë qartë komponentët e vlerësimit, si dhe peshën specifike të secilës formë testimi, duke siguruar transparencë dhe barazi në procesin e vlerësimit. Këto elemente janë të aksesueshme nga të gjithë studentët dhe përforcojnë një qasje të qartë, të standardizuar dhe të strukturuar të vlerësimit të dijes, në përputhje me objektivat e programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, studentët njihen që në orën e parë të çdo lënde me strukturën e lëndës, metodologjinë e vlerësimit dhe komponentët e notës përfundimtare, përmes syllabusit të miratuar të lëndës. Ky dokument prezantohet nga pedagogu në mënyrë të qartë dhe transparente, duke përfshirë: format e kontrollit të dijeve, afatet e dorëzimit të detyrave dhe mënyrën e llogaritjes së vlerësimit përfundimtar. Syllabuset janë të ndërtuara sipas formatit zyrtar të miratuar nga institucioni dhe në përputhje me VKM nr. 41/2018, duke përfshirë seksione specifike për metodat e vlerësimit dhe rezultatet e të nxënit[262] [263]. Përveç prezantimit në auditor, syllabus-et publikohen edhe në platformën LMS, ku studentët kanë akses të vazhdueshëm në informacionin përkatës, si dhe njoftimet për zhvillimin e lëndës dhe rezultatet e vlerësimeve. Kjo siguron komunikim të qartë, vazhdueshmëri dhe |

[255] 35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët,
[256] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[257] 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI
[258] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
[259] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
[260] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[261] 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
[262] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
[263] 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018

| | |
|---|---|
| | transparencë në procesin e vlerësimit, duke forcuar lidhjen ndërmjet studentëve dhe titullarit të lëndës. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Procesi i vlerësimit në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software është i strukturuar në mënyrë të tillë që të mundësojë një vlerësim të gjithanshëm dhe të vazhdueshëm të njohurive dhe kompetencave të fituara nga studentët. Gjatë gjithë semestrit, studentët përfshihen në provime të ndërmjetme, detyra kursi, ese, projekte praktike dhe raste studimore, të cilat shërbejnë si forma të ndryshme vlerësimi dhe testimi të përvetësimit të lëndës. Këto forma janë të dokumentuara në syllabusin e çdo lënde, ku përcaktohen qartë detyrimet që studenti duhet të përmbushë, peshat përkatëse në vlerësimin total dhe afatet për realizimin e tyre. Në këtë mënyrë, studentët kanë mundësinë të angazhohen në mënyrë progresive gjatë gjithë semestrit, duke përmirësuar performancën dhe duke përvetësuar më mirë përmbajtjen mësimore[264] [265]. Për më tepër, programi përfshin në përfundim të studimeve edhe Provimin e Përgjithshëm Final me shkrim, i cili shërben si një formë përmbledhëse e testimit të kompetencave të fituara gjatë gjithë ciklit të studimit dhe është i rregulluar në dokumentet përkatëse të programit[266]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, mënyra dhe format e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara qartë në **Rregulloren e Programit të Studimit**[267] dhe në **syllabuset përkatëse të lëndëve**[268], të cilat njihen nga studentët që në fillim të semestrit. Procesi i vlerësimit përfshin **provime të ndërmjetme, detyra kursi, projekte, pjesëmarrje aktive në seminare** dhe **provimin përfundimtar**, duke u shpërndarë gjatë gjithë vitit akademik dhe duke reflektuar progresin dhe përvetësimin e kompetencave nga ana e studentit. Provimet përfundimtare dhe ato të ndërmjetme zhvillohen në përputhje me **Kalendarin Akademik zyrtar** të TBU-së[269] [270], ku janë të përcaktuara javët specifike për zhvillimin e tyre. Secili pedagog informon studentët në mënyrë të qartë për përbërjen e vlerësimit final dhe afatet përkatëse të çdo komponenti të tij në seancën e parë të lëndës, në përputhje me përmbajtjen e syllabusit. Procesi i vlerësimit në TBU respekton parimin e **sekretimit të identitetit të studentit,** përmes numrave të sekretimit që garantojnë vlerësim të paanshëm dhe të drejtë. Po ashtu, studentët që nuk respektojnë normën e pranisë së kërkuar në auditor humbasin të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar dhe janë të detyruar ta ndjekin sërish lëndën me pagesë shtesë, sipas përcaktimeve të kontratës akademike të nënshkruar me institucionin[271]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe | TBU, në kuadër të zhvillimit të programeve të ciklit të dytë, përfshirë Masterin Shkencor në Inxhinieri Software, ka përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit format dhe mënyrat e vlerësimit, duke përfshirë gjithashtu edhe |

264 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
265 9. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (shqip)
266 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar.
267 9. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (shqip)
268 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht),
269 12.1. Kalendari akademik 2023-2024,
270 12.2. Kalendari akademik 2024-2025
271 9. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (shqip)

| | |
|---|---|
| vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | përdorimin e platformave elektronike për shpërndarjen dhe komunikimin e vlerësimeve[272]. Komunikimi i vazhdueshëm i pikëve të fituara gjatë semestrit bëhet në mënyrë të strukturuar, si në auditor ashtu edhe përmes platformës LMS, e cila siguron që çdo student të ketë akses individual në rezultatet e tij dhe të ndjekë progresin personal në mënyrë transparente[273]. Këto sisteme mbështesin vlerësimin e drejtë dhe të monitorueshëm, duke reduktuar mundësinë për ndërhyrje apo abuzime në procesin e notimit. Studentët informohen rregullisht për rezultatet ndërmjetëse, afatet e dorëzimeve dhe mënyrën e përllogaritjes së notës përfundimtare, çka rrit ndjeshëm besueshmërinë dhe transparencën e procesit të vlerësimit. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, procesi i vlerësimit përfundimtar i studentëve është i ndërtuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me përmbajtjen e syllabusit të lëndës dhe bazën rregullative të institucionit. Që në orën e parë të mësimit, pedagogu prezanton për studentët syllabusin zyrtar, ku saktësohen në mënyrë të qartë komponentët e vlerësimit, përqindjet që i atribuohen secilit element, si dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre[274]. Syllabuset janë të harmonizuara me formën zyrtare të miratuar nga TBU, në përputhje me VKM nr. 41/2018, dhe janë të publikuara për çdo lëndë në platformën LMS të institucionit, ku studentët kanë akses të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit[275]. Kjo praktikë garanton transparencë të plotë dhe e bën të mundur që studentët të jenë të informuar paraprakisht për mënyrën se si do të vlerësohen, për të gjitha lëndët e programit. Gjithashtu, gjatë gjithë procesit të mësimdhënies, rezultatet e pjesëve përbërëse të vlerësimit komunikohen në mënyrë periodike, dhe diskutohen me studentët për të siguruar qartësi dhe barazi në përllogaritjen e notës përfundimtare. Kjo qasje përforcon besimin e studentëve në drejtësinë dhe objektivitetin e vlerësimit akademik. |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, procesi i vlerësimit i jep rëndësi jo vetëm rezultatit përfundimtar, por edhe komunikimit dhe reflektimit mbi përmbajtjen e vlerësuar, duke u dhënë studentëve mundësi të qarta për përmirësim. Pedagogët, pas vlerësimit të provimeve apo detyrave të kursit, diskutojnë individualisht me studentët për përgjigjet e dhëna, duke evidentuar pikat e forta dhe mangësitë që janë hasur në trajtimin e çështjeve të lëndës. Kjo praktikë është e përfshirë si pjesë e qasjes së mësimdhënies së orientuar drejt studentit, dhe është e sanksionuar në mënyrë të tërthortë në syllabuset e lëndëve, të cilat parashikojnë edhe komponentin e feedback-ut dhe rezultatet e të nxënit që duhen arritur[276]. Në këtë mënyrë, feedback-u që jepet nga pedagogët nuk ka vetëm funksion informues për notën, por shërben si udhëzues konkret për përmirësimin e performancës akademike dhe vlerësimin e aftësive kritike dhe analitike të studentit, duke ndihmuar në ndërtimin e një procesi të vazhdueshëm dhe reflektues të të nxënit. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, TBU ka ndërmarrë një sërë masash për të parandaluar dhe minimizuar çdo formë të pasinqeritetit akademik, si plagjiatura apo kopjimi gjatë provimeve. Zbatimi i politikave të qarta të integritetit akademik është i përcaktuar në Rregulloren e programit të studimit, ku theksohet se çdo rast i identifikuar i plagjiaturës apo mashtrimit në detyra dhe provime përbën shkelje disiplinore[277]. Gjatë zhvillimit të provimeve, personeli akademik ndjek një protokoll të rreptë për identifikimin e studentëve, ndalimin e përdorimit të pajisjeve elektronike dhe monitorimin e rreptë të sallës. Gjithashtu, pedagogët hartojnë teza të reja për çdo sezon provimi, shpesh në variantet të ndryshme, për të shmangur kopjimin dhe për të garantuar vlerësim të drejtë dhe individual. Detyrat e kursit dhe projektet |

[272] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
[273] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
[274] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[275] 22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018
[276] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[277] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)

| | |
|---|---|
| | kërkohen të jenë origjinale dhe të pa-mbështetura në burime të paautorizuara, duke i inkurajuar studentët për punë të pavarur dhe mendim kritik. Ky qëndrim promovon një kulturë të ndershmërisë akademike, në përputhje me standardet evropiane të cilësisë në arsimin e lartë. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | TBU garanton që procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve të programit Master Shkencor në Inxhinieri Software të zhvillohet mbi bazën e meritës, transparencës dhe afateve të përcaktuara në rregullore. Vlerësimi i studentëve organizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë semestrit dhe kulmon me provimin përfundimtar, që zhvillohet në përputhje me afatet e caktuara në Kalendarin Akademik (dok. 12.1, 12.2). Sipas Rregullores së Programit të Studimit (dok. 9), rezultatet e vlerësimeve afatshkurtra dhe provimeve përfundimtare bëhen të ditura në kohë dhe në mënyrë të individualizuar për çdo student, duke respektuar afatet zyrtare të komunikimit të rezultateve. Pedagogët paraqesin në mënyrë të detajuar përbërësit e vlerësimit dhe shpërndarjen e pikëve, si në auditor, ashtu edhe në platformën LMS. Gjithashtu, çdo student ka të drejtën të kërkojë sqarim mbi rezultatin e vlerësimit apo të ankimojë atë brenda afatit prej 3 ditësh, në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloret përkatëse. Kjo praktikë e standardizuar forcon besimin në objektivitetin dhe paanshmërinë e procesit të vlerësimit dhe mbështet filozofinë institucionale të drejtësisë akademike. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | TBU garanton të drejtën e çdo studenti të programit Master Shkencor në Inxhinieri Software për të parë, kuptuar dhe kontestuar rezultatin e vlerësimit, në përputhje të plotë me Rregulloren e programit të studimit[278]. Kjo rregullore përcakton qartë procedurat që ndjek institucioni në rast se një student ngre ankesë mbi vlerësimin, duke përfshirë afatin për paraqitjen e ankesës (brenda 3 ditëve nga shpallja e notës), mënyrën e shqyrtimit nga pedagogët dhe organet përkatëse, si dhe afatin për dhënien e përgjigjes zyrtare. Ky proces garanton respektimin e parimit të transparencës dhe të drejtës për ankimim, duke i dhënë mundësi çdo studenti që të marrë një shqyrtim të drejtë dhe të dokumentuar të pretendimeve të tij, në përputhje me normat institucionale dhe parimet e arsimit të lartë. |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | TBU, përmes strukturave të përcaktuara në Rregulloren e programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software, siguron që çdo ankim lidhur me vlerësimin akademik të trajtohet sipas një procedure të qartë, transparente dhe të dokumentuar[279]. Fillimisht, studenti dorëzon kërkesën e ankesës pranë sekretarisë mësimore. Kjo kërkesë shqyrtohet nga pedagogu përkatës, i cili jep një qëndrim të arsyetuar me shkrim për rastin. Nëse studenti nuk është ende i kënaqur me përgjigjen, çështja i kalon Departamentit të Inxhinierisë Software, që kërkon ndërhyrjen e një komisioni të posaçëm për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i ngritur ad hoc për rastin, analizon provimin apo komponentin e kontestuar, vlerëson bazueshmërinë e ankesës dhe merr një vendim përfundimtar që është i detyrueshëm për të gjitha palët. I gjithë dokumentacioni që lidhet me procedurën – kërkesa, përgjigjet, vendimi i komisionit – arkivohet në sekretarinë e fakultetit dhe i përcillet drejtuesit të njësisë përkatëse, në përputhje me rregulloren institucionale dhe parimet e transparencës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi III.4**

[278] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
[279] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)

| **Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSh-IS) është konceptuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, duke pasur për qëllim thellimin e njohurive shkencore dhe zhvillimin e kompetencave të avancuara profesionale në fushën e inxhinierisë së softuerit. Struktura e kurrikulës është hartuar për të ofruar një përgatitje të qëndrueshme dhe të specializuar, që mbulon aspektet teorike, kërkimore dhe praktike të disiplinës. Nëpërmjet një plani mësimor të ndarë sipas veprimtarive formuese[280] dhe syllabuseve të përditësuara të lëndëve[281], programi ofron module që synojnë jo vetëm përvetësimin e njohurive bazë dhe të avancuara, por gjithashtu zhvillimin e mendimit kritik, kapacitetit analitik dhe zbatimin praktik të dijes në zgjidhjen e problemeve të fushës. Lëndët janë të shoqëruara me detyra projektesh, punë laboratorike dhe angazhime në kërkim shkencor, duke mundësuar kështu formimin e një profili të plotë profesional dhe shkencor të studentit. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Software është projektuar për të garantuar zhvillimin e aftësive të avancuara teknologjike në përputhje me zhvillimet më të fundit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe nevojat e tregut të punës. Përmes moduleve që përfshijnë punë laboratorike, projekte praktike dhe detyra në grup, studentët stimulojnë komunikimin profesional, ndërveprimin në mjedise ekipore dhe qasjen ndërdisiplinore. Programi i vendos theksin në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe punës në grup, si edhe në prezantimin e rezultateve të punës së tyre në mënyrë të qartë dhe efektive, përfshirë në gjuhën angleze, siç kërkohet edhe në detyrat e caktuara në syllabuset dygjuhëshe[282]. Për më tepër, prezantimet, projektet dhe detyrat e kursit synojnë të forcojnë kompetencat e buta (soft skills) si: bashkëpunimi, menaxhimi i kohës dhe ndërveprimi konstruktiv – thelbësore për profilet e ardhshme profesionale. Kjo qasje garanton që diplomantët e MSh-IS të jenë të pajisur jo vetëm me njohuri të avancuara teknike, por edhe me aftësi të zgjeruara sociale dhe të komunikimit, të përshtatshme për të funksionuar me sukses në mjedise ndërdisiplinore dhe ndërkulturore. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, kompetencat dhe rezultatet e të nxënit të parashikuara për secilën lëndë përshkruhen qartë në syllabuset përkatëse[283], në përputhje me strukturën e miratuar të programit të studimit[284]. Personeli akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme progresin e studentëve në përvetësimin e njohurive dhe aftësive të parashikuara, përmes detyrave të kursit, testeve të ndërmjetme, prezantimeve dhe pjesëmarrjes në diskutime. Në përfundim të lëndës, vëmendje e veçantë i kushtohet përmbylljes së moduleve me përgatitje konkrete për detyrat finale apo për fazat përgatitore të punimit të diplomës. Studentët udhëzohen të identifikojnë dhe zbatojnë në mënyrë kritike njohuritë e fituara, duke i aplikuar ato në kontekste praktike ose kërkimore, nën kujdesin dhe mbështetjen e pedagogut udhëheqës të lëndës. Kjo mbështetje e |

[280] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"
[281] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[282] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[283] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[284] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"

| | |
|---|---|
| | vazhdueshme ndihmon studentët në formësimin e një profili profesional dhe shkencor të qëndrueshëm. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSh-IS) ofron një qasje të bazuar në kompetenca, ku përmes moduleve të strukturuara teorike dhe praktike, synohet që studentët të përvetësojnë njohuri të thelluara dhe të aftësohen në zbatimin e tyre në mjedise laboratorike, nëpërmjet praktikave profesionale dhe angazhimeve kërkimore. Metodologjia e ndërtimit të syllabuseve[285] orienton mësimdhënien drejt nxitjes së mendimit kritik dhe krijimit të zgjidhjeve për problemet komplekse të fushës së softuerit, duke promovuar diskutimin në grup, analizën e rasteve studimore dhe detyrat praktike. Mësimi zhvillohet në laboratorët e IT-së, të pajisur me softuer profesional[286], ku studentët zhvillojnë njohuritë teknike të fituara gjatë leksioneve dhe seminareve. Nëpërmjet praktikave mësimore të organizuara në bashkëpunim me kompani të fushës[287] [288], studentët angazhohen në projekte reale të zhvillimit të softuerit, duke u ekspozuar ndaj teknologjive dhe metodologjive të përdorura në treg. Këto bashkëpunime krijojnë mundësi konkrete për mobilitet dhe përfshirje të drejtpërdrejtë të studentëve në aktivitete profesionale, si dhe lehtësojnë kalimin nga akademia në punësim aktiv. Gjithashtu, nën mbështetjen e stafit akademik, studentët orientohen për të zhvilluar tema kërkimore dhe punime inovative që kulmojnë me projektin e diplomës, duke pasur qasje ndërdisiplinore dhe aplikative, në përputhje me objektivat e programit dhe nevojat e tregut të punës. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Software përfshin në mënyrë aktive organizimin dhe zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve me karakter shkencor e teknologjik, ku përfshihet personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë. Këto aktivitete kanë për qëllim ekspozimin e studentëve ndaj zhvillimeve të fundit në shkencën kompjuterike dhe softuerike, si dhe përfshirjen e tyre në diskutime interaktive që i ndihmojnë të kuptojnë prirjet moderne në industri. Përmes Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Departamentit të Inxhinierisë Software, janë realizuar leksione të hapura dhe aktivitete informuese me pjesëmarrjen e pedagogëve të brendshëm dhe të ftuar nga tregu i punës, të cilët ndajnë praktika të avancuara dhe përvoja konkrete në fushën e teknologjisë së informacionit[289] [290]. Këto sesione kontribuojnë në zgjerimin e horizontit akademik dhe profesional të studentëve dhe lidhen ngushtë me objektivat kërkimore dhe inovative të programit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Programi Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSh-IS) në TBU promovon dhe mbështet në mënyrë të qëndrueshme nismat kërkimore dhe inovative të studentëve, duke ofruar hapësira akademike dhe mbështetje institucionale për zhvillimin e ideve të reja në fushën e teknologjisë së informacionit. Përmes Qendrës për Kërkime dhe Studime Ekonomike e Juridike (QKSEJ)[291] dhe Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2024–2029, studenti inkurajohet të jetë pjesë aktive në procese kërkimore dhe studimore, duke kontribuar me projekte që kanë impakt praktik dhe shkencor në fushën e software-it dhe inxhinierisë së |

285 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
286 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
287 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS,
288 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
289 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI,
290 14.5. Ditët informuese në TBU
291 42. Rregullore e Qendrës për Kërkime e studime ekonomike dhe juridike-QKSEJ

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | sistemeve[292] . Gjithashtu, janë ngritur mekanizma të qartë për të identifikuar dhe monitoruar punën kërkimore-shkencore të studentëve në programin MSh-IS, përmes përdorimit të formulareve të raportimit të punës kërkimore-shkencore dhe përfshirjes së tyre në aktivitete të promovuara nga njësia përgjegjëse[293] . Aktivizimi i studentëve në veprimtari të organizuara nga njësia në tri vitet e fundit është i dokumentuar dhe i matshëm, duke demonstruar angazhim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit dhe inovacionit[294]. Mbështetja financiare realizohet edhe përmes Fondacionit Mane, nëpërmjet bursave të akorduara për studentët e dalluar, si dhe në bashkëpunim me Balfin Group, që përmes projekteve të përbashkëta dhe rrjeteve të industrisë, ndihmojnë në zhvillimin e ideve që kanë potencial praktik e tregu[295] . | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Institucioni ka hartuar dhe miratuar një procedurë të posaçme për përgatitjen dhe mbrojtjen e diplomës për studentët e programit të ciklit të dytë MSH në Inxhinieri Software, e cila bëhet publike në fillim të semestrit të fundit. Kjo procedurë synon të garantojë realizimin e një procesi të qartë, të strukturuar dhe transparent të diplomimit, duke udhëzuar studentët për të gjitha aspektet që lidhen me përgatitjen akademike dhe formale të punimit përfundimtar.[296] Diplomimi për programin MSH-IS zhvillohet nëpërmjet përgatitjes dhe mbrojtjes publike të një punimi diplome, e cila pasqyron përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe zotërimin e kompetencave kërkimore e profesionale nga studenti. Procedura, përmbajtja dhe kriteret për vlerësimin e këtij punimi janë të specifikuara në Rregulloren e Programit të Studimit dhe Udhëzimin për përgatitjen e temës së diplomës[297]. Në fillim të semestrit, çdo student njoftohet për këtë procedurë përmes platformës LMS dhe në komunikim të drejtpërdrejtë me koordinatorin e programit dhe udhëheqësin akademik të punimit të diplomës. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSH-IS), strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë fazës së përgatitjes së diplomës, duke vënë në dispozicion udhëzime të qarta, materiale mbështetëse, si dhe formate të standardizuara për hartimin dhe dorëzimin e punimit përfundimtar. Ky proces mbështetet nga |

[292] 3.2. Strategjia e Kerkimit Shkencor 24-29
[293] 42.1.2. Formular i raportimit te punes kerkimore shkencore
[294] 42.4. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit (Aneks Tabela 22)
[295] 60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23, 60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25
[296] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
[297] 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

| | |
|---|---|
| | Udhëzimi për përgatitjen e temës së diplomës, i cili është dokument zyrtar dhe i publikuar për studentët që në fillim të semestrit të fundit[298]. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Për programin e studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software, detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Punimi i diplomes konceptohet si një projekt kërkimor-shkencor, që reflekton njohuritë e grumbulluara nga studentët gjatë gjithë ciklit të dytë të studimeve. Kjo formë synon të testojë aftësitë analitike, shkencore dhe profesionale të studentit, përmes një procesi që kombinon thellimin teorik me zbatime praktike të dijes. Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se ai përfaqëson përmbylljen akademike të studentit dhe ka në fokus përdorimin e metodologjive bashkëkohore të analizës dhe zgjidhjes së problemeve në fushën e inxhinierisë software[299]. Komisioni i posaçëm i ngritur për administrimin e mbrojtjes se diplomes merr në shqyrtim njohuritë e fituara nga studentët përgjatë gjithë programit dhe se si ato jane pasqyuar ne projektin/punimin final. Për realizimin e kësaj detyre përmbyllëse, studenti udhëhiqet nga një pedagog i brendshëm ose i jashtëm i programit, i përzgjedhur me vendim të departamentit përkatës. Komisioni i vlerësimit merr parasysh jo vetëm përmbajtjen tekniko-shkencore të tezës, por edhe aftësinë e studentit për të argumentuar qasjen e ndjekur, për të analizuar burimet dhe për të propozuar zgjidhje alternative. Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës specifikon qartë mënyrën e përzgjedhjes së temës, kërkesat për strukturën e tezës, si dhe kriteret e vlerësimit që do të përdorë komisioni përkatës[300]. |
| Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Procesi i diplomimit për studentët e programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software zhvillohet në përputhje me "Udhëzimin për përgatitjen e temës së diplomës", ku parashikohen qartë fazat përgatitore dhe roli i personelit akademik gjatë gjithë këtij procesi. Studentët, përpara se të fillojnë punimin përfundimtar, paraqesin një temë të propozuar, e cila shqyrtohet nga Departamenti i Inxhinierisë Software, i cili siguron që temat të jenë në përputhje me objektivat e programit të studimit dhe fushën e specializimit të stafit akademik[301]. Pas miratimit të temës, studentit i caktohet një udhëheqës akademik, i cili ka përgjegjësinë për ta asistuar në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit, nga përcaktimi i objektivave të kërkimit, mbledhja e të dhënave, përpunimi i rezultateve, e deri te finalizimi dhe redaktimi i punimit përfundimtar. Përzgjedhja e udhëheqësit bëhet në bazë të fushës së ekspertizës së stafit akademik, të evidentuar në CV-të përkatëse[302]. Për të garantuar cilësinë akademike dhe shkencore të tezës, udhëheqësi angazhohet në një vlerësim të vazhdueshëm të punës së studentit, duke raportuar periodikisht në Departament mbi ecurinë e punës dhe përputhshmërinë me standardet. Vetëm pas përfundimit të këtyre fazave, dhe pasi ka konfirmuar përmbajtjen shkencore, respektimin e standardeve të citimit dhe shmangien e plagjiaturës, udhëheqësi jep miratimin për mbrojtje[303]. Udhëheqësi ka gjithashtu detyrimin të plotësojë Formularin e Vlerësimit Individual, në të cilin përshkruan me objektivitet performancën e studentit gjatë gjithë përgatitjes së tezës. Ky |

[298] 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[299] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
[300] 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[301] 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[302] 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit
[303] 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | dokument depozitohet si pjesë e dosjes së diplomimit të studentit dhe shërben si referencë për komisionin e vlerësimit gjatë mbrojtjes publike të tezës[304]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, TBU asiston studentët e programit MSh-IS në çdo hap të përgatitjes së punimit të diplomës, përfshirë kryerjen e matjeve, analizave dhe testeve që lidhen ngushtë me tematikën e studimit të tyre. Kjo asistencë sigurohet nëpërmjet qasjes së studentëve në mjedise të përshtatshme si laboratorët e teknologjisë së informacionit të pajisur me software profesional të fushës së inxhinierisë software. Studentët mund të përdorin këto ambiente për testimin dhe përpunimin e të dhënave të nevojshme për punimin e tyre përfundimtar.[305] Gjithashtu, sipas "Udhëzimit për përgatitjen e temës së diplomës", pedagogu udhëheqës udhëzon studentin për çështje metodologjike si: struktura e punimit, mënyrat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, përdorimi i mjeteve sasiore apo cilësore në analizë, si dhe interpretimi i rezultateve. Këto seanca metodologjike janë pjesë përbërëse e procesit të mbështetjes akademike për realizimin me cilësi të lartë të detyrimeve përmbyllëse[306]. Në rastet kur temat e diplomës kërkojnë bashkëpunim me institucione të jashtme për kryerjen e matjeve praktike ose grumbullimin e të dhënave, TBU mobilizon marrëveshjet ekzistuese të bashkëpunimit për të siguruar akses në mjedise jashtë institucionit. Kjo realizohet nëpërmjet strukturave të zyrës së çështjeve studentore dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara nga TBU me aktorë të ndryshëm të tregut të punës[307]. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të detyrimeve përmbyllëse të programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software, studentët vlerësohen me notë sipas sistemit të vlerësimit në fuqi në TBU. Në rastet kur studenti mbron një temë diplome, komisioni i vlerësimit, i përbërë nga udhëheqësi, oponenti dhe anëtarët e tjerë, realizon një vlerësim të pavarur për secilin komponent të punimit. Secili anëtar jep pikët përkatëse, të cilat më pas mblidhen dhe përpjesëtohen për të dalë në një rezultat të vetëm, i cili konvertohet në notën përfundimtare sipas sistemit të miratuar të vlerësimit të TBU-së[308]. Kur udhëheqësi dhe/ose oponenti i temës janë njëkohësisht pjesë e komisionit, pikët e tyre llogariten vetëm një herë, për të shmangur konfliktin e interesit dhe për të siguruar vlerësim objektiv dhe të paanshëm. Pas përllogaritjes së pikëve dhe konvertimit në notë, rezultati përfundimtar regjistrohet në procesverbalin përkatës të mbrojtjes dhe publikohet menjëherë pas përfundimit të seancës së diplomimit[309]. E gjithë procedura e vlerësimit është e detajuar në dokumentacionin zyrtar të institucionit dhe i komunikohet studentëve që në fillim të procesit të diplomimit, për të siguruar transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë kandidatët.[310] |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e | Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, TBU pajis studentin me diplomën dhe suplementin përkatës, të cilët janë hartuar në përputhje me standardet evropiane të ECTS |

304 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
305 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
306 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
307 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh-IS
308 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
309 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar
310 11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

| | |
|---|---|
| diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | dhe të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Forma e diplomës dhe suplementit është e standardizuar dhe përmban të gjitha të dhënat mbi programin e ndjekur, përfshirë emërtimet e lëndëve, kreditet përkatëse dhe notat e fituara gjatë dy viteve akademike.[311] Diploma dhe suplementi janë dokumente zyrtare të lëshuara nga institucioni dhe përbëjnë dëshminë formale të përfundimit të studimeve në nivelin Master Shkencor. Studentëve u jepet kopja fizike e diplomës dhe suplementit menjëherë pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe miratimit për diplomim.[312] Përveç diplomës dhe suplementit, TBU mundëson, me kërkesë të studentit, pajisjen edhe me një kopje zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, e cila përfshin planin mësimor dhe syllabuset përkatëse të lëndëve, të përshkruara në mënyrë të shkurtuar sipas formatit të miratuar në institucion.[313] Gjithashtu, të gjitha të dhënat që lidhen me ecurinë akademike dhe lëndët e ndjekura janë të dokumentuara edhe në sistemin e menaxhimit të informacionit të studentit (LMS), ku studentët kanë akses për të parë progresin dhe rezultatet e tyre në çdo kohë[314]. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Institucioni siguron ruajtjen e dokumentacionit të studentëve të programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software në përputhje me ligjin për arkivat dhe rregullat e brendshme të institucionit. Gjatë regjistrimit fillestar dhe përgjatë gjithë ciklit të studimeve, studentët dorëzojnë dokumentacionin përkatës në sekretarinë mësimore, e cila kujdeset për administrimin dhe ruajtjen e dosjeve personale të çdo studenti. Këto dokumente përfshijnë: formularin e regjistrimit, kontratën e studentit me institucionin, kopje të dokumenteve të identifikimit dhe diplomave paraprake, si dhe çdo dokument shtesë të nevojshëm për procesin akademik.[315] Pas përfundimit të studimeve, ose në rastet e transferimit apo çregjistrimit të studentit, dosjet fizike transferohen në Zyrën e Arkivës së TBU-së, duke u arkivuar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Dokumentacioni arkivohet duke përfshirë edhe fotokopje të diplomës dhe suplementit, si dhe formularë të tjerë që lidhen me përfundimin e ciklit të studimeve.[316] TBU mban dhe përditëson gjithashtu një sërë regjistrash zyrtarë, si: regjistri i amzës, regjistri i rezultateve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomave të lëshuara. Këto regjistra janë të aksesueshëm për studentët me kërkesë zyrtare dhe ruhen për një kohëzgjatje të përcaktuar në rregulloret e institucionit, në përputhje me kuadrin ligjor. Sekretaria Mësimore u ofron studentëve të gjitha shërbimet administrative dhe informuese gjatë gjithë ciklit të studimeve. Studentët mund të kërkojnë: vërtetime si student, listë notash, konfirmim diplomimi, kopje të programeve të ndjekura, syllabuse të shkurtra, apo çdo informacion tjetër zyrtar. Këto të dhëna janë të arkivuara në format fizik dhe elektronik, dhe janë të aksesueshme me kërkesë pranë sekretarisë apo zyrës së arkivit të institucionit.[317] |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

311 17.1. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit_për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software"
312 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software" (shqip)
313 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
314 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
315 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
316 56. Rregullore e Arkivës
317 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore

| Standardi III.6<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Për realizimin me cilësi të praktikave profesionale dhe laboratorike, institucioni garanton mjedise të dedikuara brenda strukturës së tij, si dhe bashkëpunime me institucione e biznese të fushës për zhvillimin e praktikave jashtë institucionit. Në dispozicion të zhvillimit të praktikës laboratorike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit ofron laboratorë të specializuar në fushën e inxhinierisë së softuerit dhe teknologjisë së informacionit, të pajisur me kompjuterë bashkëkohorë dhe me akses në software profesional, në funksion të zhvillimit të detyrave praktike dhe punëve të integruara me teorinë[318]. Gjithashtu, për zhvillimin e praktikës profesionale, janë të nënshkruara marrëveshje bashkëpunimi me institucione e kompani të sektorit privat dhe publik, të cilat ofrojnë mjedise pritëse për studentët e këtij programi. Këto marrëveshje mundësojnë një aplikim real të njohurive të marra gjatë studimeve, dhe janë të përcaktuara qartë në dokumentet përkatëse të institucionit[319] [320]. Përveç infrastrukturës fizike, TBU ka integruar platforma bashkëkohore dixhitale si Moodle, Office 365 dhe SharePoint, duke krijuar kështu një mjedis të integruar të mësimdhënies dhe të mësimnxënies që mbështet edhe zhvillimin e praktikave digjitale apo simulimeve online, sidomos në fushën e softuerit[321] [322] [323] |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Studentëve të programit Master Shkencor në Inxhinieri Software u mundësohet zhvillimi i praktikës profesionale në institucione dhe kompani partnere me të cilat TBU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Këto marrëveshje janë orientuar drejt fushës së teknologjisë së informacionit dhe softuerit, duke synuar integrimin e studentëve në ambiente profesionale që përdorin teknologjitë më të fundit dhe standardet bashkëkohore të zhvillimit softuerik. Në këto institucione, studentët përfshihen në projekte reale, njihen me praktika të mira të industrisë dhe aplikojnë njohuritë e marra gjatë studimeve, duke forcuar aftësitë e tyre profesionale dhe teknike në mënyrë të drejtpërdrejtë[324] [325].<br><br>Për lehtësimin dhe ndjekjen e praktikave profesionale dhe mundësive për stazhe, mbështetje të vazhdueshme ofrohet nga Zyra e Çështjeve Studentore dhe Departamenti i Inxhinierisë Software. Këto struktura i asistojnë studentët në identifikimin e institucioneve pritëse, koordinimin me partnerët dhe ndjekjen e zhvillimit të praktikës. Gjithashtu, Zyra e Çështjeve Studentore shpërndan informacion për mundësi punësimi, praktika jashtë vendit dhe specializime të mëtejshme, duke u siguruar që studentët të përfitojnë |

[318] 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB)
[319] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS,)
[320] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)
[321] 44. Strategjia e Zhvillimit te IT,
[322] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS,
[323] 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS.
[324] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS,
[325] 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

| | |
|---|---|
| | maksimalisht nga përvoja e tyre praktike në funksion të zhvillimit të kompetencave profesionale[326 327]. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Praktika profesionale është një komponent i detyrueshëm i programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software, dhe është e përfshirë si një veprimtari formuese me një ngarkesë prej 12 kreditesh ECTS, e cila korrespondon me 300 orë pune të studentit. Kjo praktikë realizohet përgjatë vitit të dytë akademik dhe synon t'i japë studentëve mundësinë për të përfshirë njohuritë teorike të marra gjatë programit në një mjedis profesional konkret, të lidhur me industrinë e softuerit[328]. Për zhvillimin dhe menaxhimin e kësaj praktike, institucioni ka hartuar një rregullore dhe një set dokumentesh mbështetëse për monitorimin dhe vlerësimin e saj. Studenti, përpara nisjes së praktikës, dorëzon pranë Departamentit të Inxhinierisë Software formularin e aplikimit për praktikë, i cili duhet të miratohet nga pedagogu përgjegjës dhe nga Zyra e Çështjeve Studentore. Pas përfundimit të praktikës, studenti përgatit një raport përmbledhës sipas formatit zyrtar, ndërsa mbikëqyrësi në institucionin pritës plotëson formularin e vlerësimit të performancës së studentit[329 330]. Dosja e praktikës së studentit, e përbërë nga aplikimi, miratimi, raporti dhe vlerësimi nga trajneri, i dorëzohet komisionit vlerësues të ngritur nga Departamenti. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë të stafit akademik me titull shkencor dhe kryesohet nga përgjegjësi i departamentit. Vlerësimi përfundimtar i praktikës i jepet studentit në formë pikësh, të cilat konvertohen në notë përfundimtare sipas sistemit të vlerësimit në fuqi. Vlerësimi dokumentohet dhe ruhet në dosjen individuale të studentit në përputhje me procedurat e brendshme të institucionit[331 332]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

# IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

326 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI,
327 14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI
328 16.5. Plani mësimor i programit te studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip).doc
329 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse,
330 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
331 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit,
332 14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Personeli akademik, efektiv dhe me kohë të pjesshme, i angazhuar në programin e studimit MSH-IS, përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", si dhe në Statutin dhe Rregulloret e brendshme të TBU-së. Stafi përfshin pedagogë të brendshëm dhe të jashtëm me tituj shkencorë dhe akademikë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe lëndët/modulet përkatëse që ata mbulojnë[333] [334]. Ngarkesa mësimore, detyrat dhe përfshirja në veprimtaritë akademike janë të planifikuara dhe të dokumentuara përmes formularëve përkatës nga Departamenti i Inxhinierisë Software, i cili kujdeset për përshtatjen e kapaciteteve mësimore me objektivat e programit. Grada minimale për stafin akademik të përfshirë në mësimdhënie është "Master i Shkencave", ndërsa orët janë të mbuluara nga pedagogë me titull "Doktor" ose më lart në përputhje me gradën shkencore apo titullin akademik. CV-të e stafit të përfshirë, si edhe shpalljet për vendet vakante të punës në këtë program, pasqyrojnë përputhshmërinë ndërmjet diplomimit të stafit dhe kërkesave të modulit përkatës[335] [336]. Ngarkesa në auditor e çdo pedagogu, për vitet akademike 2023–2024 dhe 2024–2025, është dokumentuar në mënyrë të qartë dhe e përputhur me kërkesat ligjore, për të garantuar shpërndarje të drejtë dhe efikase të orëve të mësimdhënies. Këto të dhëna janë në përputhje me normat e miratuara nga Senati Akademik dhe ndihmojnë në garantimin e cilësisë së procesit mësimor për studentët e programit[337] [338] |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSH-IS) mbulon mbi 70% të ngarkesës. Ngarkesa është planifikuar në mënyrë të qartë nga Departamenti i Inxhinierisë Software dhe është dokumentuar përmes tabelave përkatëse, të cilat tregojnë shpërndarjen e ngarkesës mësimore në auditor për vitet akademike 2023–2025. Pjesa më e madhe e ngarkesës është mbuluar nga staf me tituj shkencorë "Doktor." dhe me përvojë në mësimdhënie universitare, duke garantuar cilësinë dhe stabilitetin e procesit akademik në këtë program[339]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSH-IS) garanton qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar gjatë gjithë periudhës së akreditimit. Pjesa më e madhe e stafit efektiv është e punësuar prej vitesh në TBU, duke kontribuar në ndërtimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe bashkëpunues për studentët dhe kolegët, si dhe në mbajtjen e cilësisë së mësimdhënies në program[340]. Kontratat individuale të punës për personelin akademik administrohen nga Zyra e |

[333] 2 Statuti i TBU,

[334] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit

[335] 7.1. Formulari i planifikimit të ngarkesës të stafit akademik në auditor nga departamenti,

[336] 23. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

[337] 28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4),

[338] 13.4. Praktika e rekrutimit te stafit

[339] 28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4)

[340] 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE)



TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| | Burimeve Njerëzore (ZBNJ), e cila ndjek të gjitha procedurat për përfshirjen e stafit në skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore[341]. Pagesat dhe detyrimet financiare zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi. |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik të angazhuar në programin Master Shkencor në Inxhinieri Software (MSH-IS). Marrëdhëniet e punës në TBU bazohen në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL", Statutin e TBU dhe në Rregulloren për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit[342]. Procesi i rekrutimit realizohet sipas kritereve të shpallura në njoftimet për vendet vakante, të cilat publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në rrjetet sociale zyrtare të TBU. Njoftimet përmbajnë kërkesat e përgjithshme dhe specifike për pozicionin akademik, përfshirë fushën e kualifikimit dhe përputhjen me përmbajtjen e moduleve të programit të studimit[343]. Dosjet e aplikantëve vlerësohen nga një Komision i ngritur posaçërisht, i cili kryen një vlerësim të dokumentacionit dhe intervistë me kandidatët. Përzgjedhja e kandidatit final bëhet mbi bazën e një sistemi pikëzimi që garanton transparencë dhe objektivitet në përputhje me kriteret përkatëse të programit të studimit. Vendimi përfundimtar për emërim zyrtarizohet me urdhër nga Rektori i TBU[344]. Në të njëjtën kohë, publikohet edhe Urdhri i Emërimit. E gjithë kjo procedurë është plotësisht transparente, duke garantuar përzgjedhjen më të përshtatshme për çdo pozicion akademik. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Ne TBU nuk ka staf ndihmes akademik te punesuar per te mirembajtur laboratoret apo per te dhene ndihme gjate oreve qe realziohen senacat praktike .Institucioni ka siguruar dhe garantuar angazhimin e personelit akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike të programit të studimit MSH-IS. Stafi Akademik i Fakultetit te Teknoogjise se Informacionit kontribuon në zhvillimin e sesioneve praktike në mjediset laboratorike, të pajisura me teknologji bashkëkohore për programim, testim softuerësh, menaxhim të të dhënave dhe simulime të proceseve softuerike[345]. TBU siguron mjedise moderne të pajisura me aparatura dhe platforma softuerike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Laboratorët janë të pajisur me kompjuterë, licenca softuerësh profesionalë, dhe ofrojnë akses në platformat online si Office 365, Moodle LMS dhe SharePoint për organizimin dhe dokumentimin e procesit akademik[346]. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, | Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", Statutit të TBU-së dhe Rregullores për Punësimin, Largimin dhe Vlerësimin e Personelit, dokumentacioni i personelit akademik të angazhuar në programin e studimit MSH-IS administrohet në mënyrë të strukturuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Kjo zyrë është përgjegjëse për organizimin, mbledhjen dhe përditësimin vjetor të të dhënave të personelit akademik dhe ndihmës akademik në nivel institucional[347]. Dosjet individuale |

[341] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit
[342] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit
[343] 13.1. Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website
[344] 13.2. Politika e BNJ ne TBU, 13.4. Praktika e rekrutimit te stafit
[345] 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[346] 44. Strategjia e Zhvillimit te IT
[347] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | të stafit përmbajnë informacion të plotë mbi kontratat, dokumentacionin personal, kualifikimet, aktivitetet mësimore dhe kërkimore, si dhe vlerësimet periodike të performancës, në përputhje me udhëzimet përkatëse të ZBNJ. Këto dosje administrohen sipas formatit të përcaktuar dhe ruhen në përputhje me standardet e dokumentacionit institucional[348]. Për programin e studimit MSH-IS, janë të dokumentuara ngarkesat mësimore për çdo vit akademik, të ndara sipas lëndëve dhe semestrave, për çdo anëtar të stafit akademik që mbulon lëndët e programit. Këto të dhëna janë të pasqyruara në tabelat përmbledhëse të ngarkesës mësimore dhe organizimin e stafit në auditor, për periudhën 2023-2025[349]. Gjithashtu, Zyra e Burimeve Njerëzore mban dhe përditëson listën e personelit ndihmës akademik të angazhuar në mbështetje të mësimdhënies, laboratorëve dhe praktikave mësimore, duke siguruar funksionimin efektiv të procesit akademik të programit[350]. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | TBU, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të arsimit të lartë dhe me kompani partnere nga fusha e teknologjisë së informacionit dhe industrive të lidhura, siguron për programin MSH-IS staf akademik dhe profesionistë të fushës për mbikëqyrjen e praktikës profesionale dhe punimeve të diplomës. Këta përfshijnë pedagogë me përvojë në sektorin akademik dhe atë industrial, të cilët udhëheqin dhe orientojnë studentët gjatë zhvillimit të praktikës dhe detyrimeve të tjera profesionale[351]. Në përputhje me strukturën dhe numrin e studentëve të përfshirë në praktikat profesionale, Departamenti i Inxhinierisë Software përcakton çdo vit numrin e pedagogëve mbikëqyrës, duke garantuar që secili student të ketë një udhëheqës të dedikuar. Personeli i caktuar për mbikëqyrje është gjithashtu pjesë e komisioneve për mbrojtjen e praktikës profesionale apo punimit të diplomës[352]. Për më tepër, stafi akademik i përfshirë në këto aktivitete përzgjedhet në përputhje me profilin e tyre profesional dhe kualifikimin akademik, për të garantuar që përmbajtja dhe cilësia e praktikës të jetë në linjë me objektivat formues të programit MSH-IS. Kjo mbështetet në strukturat e përcaktuara nga Departamenti i Inxhinierisë Software dhe Zyra e Çështjeve Studentore[353] [354]. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Personeli mbikëqyrës në institucionet pritëse me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi, angazhohet aktivisht në mbikëqyrjen e studentëve të programit MSH-IS gjatë zhvillimit të praktikës profesionale. Ky personel është i përzgjedhur në përputhje me natyrën e fushës së teknologjisë së informacionit dhe ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve për raportin final të praktikës si dhe në përgatitjen për procesin e vlerësimit. Personeli mbikëqyrës përfshihet gjithashtu në procesin e vlerësimit final të praktikës, duke kontribuar me mendimin profesional dhe duke firmosur formularët përkatës të vlerësimit të studentit[355] [356]. Praktika profesionale për studentët e programit Master Shkencor në Inxhinieri Software ka një ngarkesë totale prej 300 orësh (ekuivalente me 12 kredite ECTS), e ndarë në aktivitete praktike në ambientet e TBU-së dhe në institucionet bashkëpunëtore. Nga këto, 8 orë zhvillohen në |

[348] 13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE)
[349] 28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4)
[350] 25. 22. CV e stafit ndihmës akademik
[351] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS
[352] 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI
[353] 7 Rregullore e Departamentit te Inxhinierise Software,
[354] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
[355] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS,
[356] 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | auditor me asistencën e stafit akademik të brendshëm, ndërsa pjesa tjetër realizohet në mjediset e praktikës së jashtme. TBU garanton përmbushjen e të gjitha kushteve teknike dhe organizative për realizimin me sukses të praktikës, në përputhje me planifikimin vjetor dhe dokumentacionin zyrtar[357] [358]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | TBU, përmes Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit (FTI), garanton funksionalitetin dhe disponueshmërinë e mjediseve të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe formimin praktik në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit MSH-IS. Institucioni ka në dispozicion laboratorë të specializuar për teknologji informacioni dhe inxhinieri software, të pajisur me kompjuterë modernë, lidhje të qëndrueshme interneti, licenca softuerike dhe mjete ndihmëse që u mundësojnë studentëve të zhvillojnë kompetencat e tyre praktike dhe teknike, sipas kërkesave të moduleve përkatëse[359]. Përveç ambienteve të brendshme, TBU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të sektorit të IT-së që mundësojnë aksesin në mjedise të jashtme për realizimin e praktikave profesionale dhe projekteve kërkimore të lidhura me kurset. Këto bashkëpunime janë të dokumentuara dhe të strukturuara, duke siguruar përmbushjen cilësore të objektivave të formimit praktik[360]. Mjediset mësimore, si auditorët dhe sallat e seminareve, janë të pajisura me projektorë, akses interneti Wi-Fi dhe mjete të tjera multimediale që e bëjnë procesin e mësimdhënies më interaktiv dhe efektiv[361]. Gjithashtu, për të garantuar funksionimin optimal të laboratorëve dhe platformave dixhitale[362], është hartuar dhe zbatuar një Strategji për Zhvillimin e IT, e cila fokusohet në përditësimin e pajisjeve, aplikacioneve dhe sistemeve mbështetëse të mësimdhënies, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e përvojës akademike për studentët e programit[363]. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të | Institucioni siguron pajisje, teknologji, infrastrukturë ndihmëse në përputhje me përmbajtjen e programit të studimit dhe veprimtaritë e moduleve përkatëse. TBU ka ndërtuar një infrastrukturë të dedikuar për zhvillimin cilësor të programeve në fushën e teknologjisë së informacionit, përfshirë edhe programin Master Shkencor në Inxhinieri Software. Brenda mjediseve të TBU-së janë në funksion dy laboratorë kompjuterikë: laboratorët janë të pajisur me 30 kompjuterë HP me procesor Intel Core i5 dhe 60 kompjuterë Fujitsu me |

357 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse,

358 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI

359 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)

360 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS

361 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)

362 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit

363 44. Strategjia e Zhvillimit te IT

| | |
|---|---|
| metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | procesor Intel Core i3, të cilët përdoren për mësim praktik dhe projekte studentore në kuadër të moduleve teknike të programit. Pajisjet janë të përditësuara dhe të afta të mbështesin softuerët dhe mjetet që përdoren në inxhinieri software. Sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjuterë individualë për lektorët dhe projektorë të standardeve bashkëkohore, duke mbështetur zhvillimin interaktiv të leksioneve dhe prezantimeve. Konkretisht, janë 10 salla të pajisura me kompjuterë HP dhe projektorë ACER X1226AH DLP, të cilët mundësojnë ndërveprim efektiv gjatë procesit të mësimdhënies. Përveç kësaj, për stafin akademik janë në dispozicion 20 kompjuterë HP me performancë të mirë dhe 5 kompjuterë HP EliteDesk me specifika të avancuara, që i ndihmojnë ata të përgatisin materialet mësimore, të administrojnë detyra dhe të mbajnë komunikim të vazhdueshëm me studentët nëpërmjet sistemeve si LMS[364]. Përveç mjeteve fizike, TBU siguron edhe përdorimin e platformave teknologjike mbështetëse si Moodle (LMS), Office 365 dhe SharePoint për menaxhimin e informacionit dhe burimeve mësimore, duke e bërë më efikase përgatitjen, shpërndarjen dhe komunikimin e materialeve akademike[365]. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Për programin Master Shkencor në Inxhinieri Software, TBU ka vënë në dispozicion dy laboratorë kompjuterikë të pajisur me teknologji moderne dhe në përputhje me nevojat e moduleve të fushës. Laboratori i parë është i pajisur me 30 kompjuterë HP me procesor Intel Core i5 6100 CPU @3.7 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 10 Pro 64-bit. Laboratori i dytë ka 60 kompjuterë Fujitsu me procesor Intel Core i3-9100 CPU @3.6 GHz, 8 GB RAM dhe sistem operativ Windows 11 Pro 64-bit, si dhe 2 projektorë të lidhur paralel Epson EB-W42. Këto mjete garantojnë performancë të lartë dhe stabilitet për kryerjen e detyrave praktike dhe përdorimin e softuerëve të avancuar që aplikohen në këtë program studimi. Laboratorët e Informatikës kanë kapacitete të mjaftueshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave në auditor për studentët e programit MSH-IS. Këto laboratorë janë në funksion të moduleve që përfshijnë zhvillimin e softuerit, testimin, arkitekturën e sistemeve dhe inxhinierinë e kërkesave[366]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Siç përmendet në Kriterin 1 & 2, më sipër, TBU ofron për studentët 2 laboratorë të Informatikës të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop. Në to janë instaluar edhe Programe/Softe aplikative. Në këto laboratorë zhvillojnë mësim studentët që ndjekin programet e studimit Bachelor dhe Master në Informatikë Ekonomike, Inxhinieri Softwerike si dhe Inxhinieri Kompjuterike.[367] |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e | Studentët e programit të studimit MSH-IS janë të angazhuar në realizimin e praktikave profesionale si një komponent thelbësor i formimit të tyre. Nga 300 orë pune të parashikuara për praktikën profesionale, një pjesë e konsiderueshme zhvillohet në mjediset e TBU-së të përshtatura për praktika në auditor, përfshirë laboratorët kompjuterikë të pajisur me teknologji bashkëkohore dhe softuerë të specializuar. Përveç këtyre mjediseve të brendshme, praktikës i kushtohet rëndësi edhe në partneritet me institucionet dhe kompanitë e jashtme. TBU ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimi me organizata dhe kompani që operojnë në sektorin e teknologjisë së informacionit, duke mundësuar zhvillimin e praktikave në ambjente reale pune. Ky bashkëpunim është formalizuar përmes |

[364] 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[365] 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela ...)
[366] 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)
[367] 43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)

| | |
|---|---|
| programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | marrëveshjeve specifike që sigurojnë cilësinë e praktikës dhe mbështetjen nga profesionistë të fushës[368]. Zyra e Çështjeve Studentore dhe Departamenti i Inxhinierisë Softuerike koordinojnë shpërndarjen e studentëve në institucionet pritëse, bazuar në profilin akademik dhe tematikën e praktikës. Studentët pajisen me udhëzime dhe mbështetje për përgatitjen e raporteve të praktikës dhe përmbushjen e detyrimeve përkatëse sipas formatit të miratuar institucional[369]. Ndër partnerët që ofrojnë mundësi praktike për studentët e MSH-IS janë kompani të njohura nga industria e softuerit dhe IT-së, si edhe njësi zhvillimi pranë Balfin Group. Studentët përfitojnë nga këto partneritete jo vetëm për zhvillim të praktikës profesionale, por edhe për integrim të mundshëm në tregun e punës[370]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Programi i studimit Master Shkencor në Inxhinieri Software është i pajisur me literaturë të mjaftueshme bazë dhe ndihmëse, të përzgjedhur në përputhje me përmbajtjen e syllabus-eve dhe objektivat formues të lëndëve që përbëjnë programin. Literatura është e aksesueshme si në formë fizike në bibliotekën e institucionit, ashtu edhe në format digjital përmes platformës LMS të TBU-së. Këto burime lejojnë studentët të përvetësojnë në mënyrë të pavarur njohuritë e nevojshme për përmbushjen e objektivave të formimit profesional dhe kërkimor[371]. Biblioteka e TBU-së ka një fond fizik titujsh që mbulojnë fushat e teknologjisë së informacionit, programimit, inteligjencës artificiale, bazave të të dhënave, inxhinierisë së softuerit, si dhe tema të avancuara kërkimore. Gjithashtu, për programin MSH-IS është përgatitur një Inventar i veçantë i literaturës bazë në fushën përkatëse, i cili përditësohet rregullisht për të përmbushur nevojat akademike të studentëve të ciklit të dytë[372]. Përveç literaturës ekzistuese, institucioni është i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për pasurimin e fondit bibliografik përmes procedurave të qarta të miratimit dhe blerjes së literaturës së re, në funksion të zhvillimeve bashkëkohore dhe objektivave të kurrikulës së programit[373]. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Njësia përgjegjëse për programin e studimit MSH-IS, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bibliotekës dhe drejtuesit e departamentit të Inxhinierisë Softuerike, harton dhe zbaton një planvjetor për përditësimin e literaturës në funksion të zhvillimeve bashkëkohore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe softuerit. Ky proces mbështetet në konsultime me pedagogët që mbulojnë lëndët bazë dhe zgjedhore të programit.[374] Për çdo vit akademik, departamenti i |

[368] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS
[369] 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
[370] 36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[371] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)
[372] 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS
[373] 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU
[374] 7 Rregullore e Departamentit te Inxhinierise Software

| | |
|---|---|
| | dërgon Drejtorisë së Bibliotekës kërkesa për blerjen e titujve të rinj, të përzgjedhur nga syllabuset dhe referencat më të fundit të fushës. Ky proces dokumentohet përmes një procedure të miratuar që garanton përzgjedhjen e literaturës më bashkëkohore për studentët dhe stafin akademik[375]. TBU gjithashtu mbështet përditësimin e fondit të bibliotekës me fonde të dedikuara nga buxheti institucional, në bashkëpunim me strukturat akademike dhe administrative përkatëse. Literatura e re përfshin tekste me vlerë didaktike dhe kërkimore në fushat e programimit, sistemeve të informacionit, inteligjencës artificiale, metodologjisë shkencore dhe inxhinierisë së softuerit[376]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Për realizimin e programit të studimit MSH-IS funksionon Biblioteka e TBU-së, e cila luan një rol të rëndësishëm në shërbim të formimit profesional të studentëve dhe të mbështetjes akademike. Studentët e programit kanë akses të plotë në literaturën e bibliotekës fizike dhe digjitale në mënyrë të barabartë dhe të organizuar sipas fushave të studimit[377]. Të gjitha tekstet mësimore dhe leksionet e shkruara të përdorura në programet e studimit, përfshirë MSH-IS, ruhen dhe administrohen nga biblioteka dhe janë të aksesueshme për të gjithë studentët. Biblioteka mbështet përdoruesit përmes orareve të hapura dhe stafit të kualifikuar[378]. Për më tepër, TBU garanton akses të barabartë për studentët e MSH-IS në përmbajtjet mësimore të strukturës digjitale LMS, ku çdo pedagog ngarkon prezantimet në ppt, materialet shtesë, skriptet, leksionet dhe ushtrimet përkatëse për çdo modul që mbulon. Kjo strukturë shërben si një mbështetje komplementare e bibliotekës klasike[379]. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e TBU-së është një njësi e rëndësishme institucionale që mbështet procesin e mësimdhënies dhe formimit profesional për të gjitha programet e studimit, përfshirë edhe programin MSH-IS. Ajo ndodhet në katin e parë të institucionit dhe shtrihet në një hapësirë të përshtatshme për studentët, duke ofruar lehtësi për aksesin dhe përdorimin e materialeve bibliotekare në ambient komod dhe funksional[380]. Literatura fizike dhe digjitale e vendosur në bibliotekë përfshin tekste mësimore bazë dhe ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përcaktuara në syllabus-et përkatëse të lëndëve të programit MSH-IS. Në këtë bibliotekë gjenden gjithashtu revista shkencore, fjalorë dhe burime të tjera të përshtatura për fushën e teknologjisë së informacionit dhe softuerit[381]. Materialet e bibliotekës përditësohen rregullisht sipas kërkesave të pedagogeve dhe rekomandimeve të strukturave përkatëse akademike. Kjo pasurohet me libra të rinj, skripta, manuale praktike dhe botime bashkëkohore për të garantuar një përputhje të plotë me objektivat formues të programit[382]. Përveç aksesit fizik, studentët e MSH-IS kanë mundësi të shfrytëzojnë gjithashtu bibliotekën online dhe platformat LMS ku ngarkohen materialet digjitale për secilën lëndë, si: prezantime, detyra, leksione dhe udhëzime metodologjike. Në këtë mënyrë, studentëve u garantohet një mbështetje e gjithanshme bibliotekare në përputhje me nevojat e programit[383]. |

375 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU
376 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS
377 47. Rregullore e bibliotekës
378 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS
379 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS, 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
380 47. Rregullore e bibliotekës
381 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS
382 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU
383 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS



TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Institucioni garanton mbështetje akademike për studentët e programit Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike përmes ofrimit të aksesit në biblioteka dhe burime online me përmbajtje shkencore. Deri në dhjetor 2022, studentët kanë pasur mundësi të përdorin platformën EBSCO, një ndër bibliotekat elektronike më të njohura ndërkombëtarisht, për artikuj shkencorë, revista dhe materiale kërkimore nga disiplina të ndryshme. Aktualisht, TBU është në proces të shqyrtimit të abonimit në bazën Scopus Research për vitin akademik 2024–2025, me synimin për të forcuar mbështetjen në fushën e kërkimit shkencor dhe për të lehtësuar aksesin në literaturë cilësore e të përditësuar. Këto përpjekje reflektojnë angazhimin institucional për të garantuar kushte të barabarta për të gjithë studentët në procesin akademik dhe kërkimor[384]. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka e TBU-së është e vendosur në katin e parë të godinës dhe përfshin një sallë studimi të pajisur me kompjuterë të lidhur me internet pa pagesë (free Wi-Fi), të cilët janë në dispozicion të studentëve gjatë gjithë orarit të funksionimit të institucionit. Studentët e programit MSH-IS e shfrytëzojnë këtë hapësirë për të aksesuar materiale digjitale dhe për të kryer punë kërkimore apo detyra mësimore në kushte komode dhe me infrastrukturë të përshtatshme[385]. |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Shërbimi i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit, përfshirë programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, me 3 profile. Ky shërbim ofrohet në pesë ditë të javës. Orari i bibliotekës për ditët e Hënë - E Premte është 9.00-20.00. Gjatë sezonit të provimeve shërbimi i bibliotekës është me orar të zgjatur. Me qëllim organizimin dhe mirëfunksionimin e bibliotekës TBU ka edhe një rregullore për këtë qëllim të miratuar nga Senati Akademik i tij.[386] |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit MSH-IS ndjekin dhe raportojnë rregullisht për cilësinë dhe përditësimin e fondit fizik dhe atij online. Monitorimi përfshin titujt kryesorë në shërbim të programit, shkallën e shfrytëzimit nga studentët dhe personeli akademik, si dhe përdorimin e sallave të leximit. Pasurimi i literaturës bëhet çdo vit mbi bazën e kërkesave nga pedagogët e lëndëve dhe në përputhje me objektivat formues të programit. Literatura përfshin autorë bashkëkohorë ndërkombëtarë dhe tekste referuese të fushës së teknologjisë së informacionit dhe inxhinierisë softuerike[387] [388] [389][390]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[384] 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)
[385] 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS
[386] 47.Rregullore e Biblotekes
[387] 47. Rregullore e bibliotekës,
[388] 47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS,
[389] 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)
[390] 47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Institucioni i arsimit të lartë TBU ka ngritur një sistem të konsoliduar të menaxhimit për të administruar të gjitha të dhënat që lidhen me studentët e programit MSH-IS, duke nisur që nga momenti i regjistrimit, ndjekja e ecurisë akademike dhe deri në diplomim. Ky sistem mbështetet nga një strukturë organizative e qartë dhe funksionale që vepron në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Të gjitha hallkat e këtij procesi janë të ligjëruara dhe të standardizuara përmes rregulloresh, urdhrash dhe udhëzimesh administrative[391]. Sistemi Pitagora, i zhvilluar nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), është integruar në TBU për të mundësuar menaxhimin e centralizuar të të dhënave akademike dhe administrative për studentët e MSH-IS. Ky sistem mbulon funksione të tilla si: regjistrimi i studentëve, planifikimi dhe administrimi i provimeve, lëshimi i diplomave dhe transkripteve, menaxhimi i pagesave dhe faturave financiare, si dhe prodhimi i raporteve analitike. Nëpërmjet këtij sistemi, TBU siguron automatizim, transparencë dhe efikasitet të lartë në ofrimin e shërbimeve akademike dhe financiare për studentët e këtij programi[392]. Përveç Pitagora-s, TBU përdor gjithashtu platformën SharePoint për menaxhimin e dokumenteve dhe komunikimin e brendshëm të stafit akademik dhe administrativ. Studentët dhe stafi i përfshirë në MSH-IS kanë qasje në informacionin përkatës përmes adresave elektronike institucionale dhe portaleve të dedikuara, duke garantuar një rrjedhë të vazhdueshme informacioni të sigurt dhe të dokumentuar[393]. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Për menaxhimin dhe administrimin e informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të angazhuar në programin MSH-IS, TBU përdor platformën Microsoft SharePoint. Kjo platformë, e integruar me Office 365, mundëson ruajtjen, ndarjen dhe menaxhimin e dokumenteve në mënyrë të sigurt dhe të organizuar. SharePoint përdoret për qasje të centralizuar në dokumentacionin institucional si: rregulloret, udhëzimet, politikat, raportet vjetore dhe të dhëna të tjera të lidhura me veprimtarinë e personelit të angazhuar në program. Aksesin në këtë platformë e kanë të gjithë përdoruesit përkatës përmes llogarive zyrtare institucionale, të strukturuara sipas njësive dhe funksioneve përkatëse[394]. Përveç SharePoint, informacioni mbi aktivitetin mësimor dhe ndërveprimin me studentët administrohet edhe nëpërmjet sistemit TBU LMS. Ky sistem përfshin të gjitha të dhënat që lidhen me përgatitjen e materialeve mësimore, komunikimin me studentët, detyrat, provimet, dhe rezultatet përkatëse. LMS shërben gjithashtu si një mjet për gjurmimin e angazhimit të stafit akademik në procesin mësimor dhe dokumentimin e përmbushjes së detyrimeve të tyre[395]. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të | Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit në TBU siguron akses të dedikuar dhe informacion të plotë për çdo hap të procesit mësimor në programin Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike. Studentët dhe personeli akademik kanë mundësi të ruajnë, ndajnë dhe bashkëpunojnë në dokumente në mënyrë të |

[391] 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore

[392] 48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)

[393] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS

[394] 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit

[395] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS, 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS

| | |
|---|---|
| gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | sigurt përmes platformës SharePoint. Kjo platformë ofron një qendër të centralizuar për dokumentacionin institucional, duke përfshirë manuale, politika të brendshme, rregullore, procedura, udhëzues akademikë dhe materiale mësimore që lidhen direkt me programin[396]. Gjithashtu, përmes sistemit TBU LMS, studentët kanë akses të dedikuar mbi informacionin për çdo lëndë të programit ku janë të rregjistruar. Kjo përfshin përmbajtjen mësimore, materialet e leksioneve, detyrat, si dhe mjetet për komunikim me pedagogët dhe bashkëmoshatarët[397]. Për më tepër, të gjithë pedagogët dhe stafi administrativ i TBU zotërojnë dhe menaxhojnë një adresë elektronike zyrtare të unifikuar me domain-in institucional, e cila shërben si kanal zyrtar dhe i strukturuar komunikimi. Kjo ndihmon në mbajtjen e një rrjeti efektiv informacioni dhe bashkëpunimi brenda institucionit. Së fundmi, sistemi i menaxhimit akademik dhe administrativ Pitagora, i zhvilluar nga RASH, siguron një administrim të centralizuar dhe transparent të të dhënave të studentëve dhe stafit, nga regjistrimi në program e deri te diplomimi. Ky sistem mbështet proceset administrative dhe akademike në përputhje me standardet më të larta bashkëkohore[398]. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme TBU LMS, por gjithashtu edhe nëpërmjet emailit. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët e programit të studimit dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve akademike.[399]<br>Për njohjen dhe aftësimin në përdorimin e platformës TBU LMS, vijnë në ndihmë guidat përkatëse të hartuara nga Zyra e IT-së: guidë për pedagogun dhe guidë për studentët si dhe trajnimet e realizuara.[400] [401] [402]<br>Pra, e gjithë kjo platformë shërben si nje mjet komunikimi i brendshëm efikas mes pedagogëve.[403] |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve në TBU, analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive TBU LMS, për lëndët dhe grupet e veta. Me Pitagora, TBUdo të ketë një sistem të centralizuar, të sigurt dhe të lehtë për menaxhim, duke modernizuar administrimin akademik dhe financiar në përputhje me standardet më të larta.[404] |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Faqja zyrtare e TBU: http://tbu.edu.al është dy gjuhëshe, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Në të mund të gjenden informacione për kolegjin, programet e studimit, kurrikulën e studimit për çdo program, personelin akademik dhe joakademik, aktivitete dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, dokumentet kryesore dhe materiale të rëndësishme gjenden në web në gjuhën angleze si: Statuti, Rregullore e Përgjithshme e TBU, Raporti Vjetor të Institucionit, e shumë materiale të tjera për ngjarje dhe evente të ndryshme të Institucionit. Informacioni i përgjithshëm bazik i TBU përcillet nëpërmjet të gjitha kanaleve të informimit dhe social media si: Web, Instagram, Linkedin. |

[396] 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit
[397] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
[398] 44. Strategjia e Zhvillimit te IT
[399] 51.4. Udhëzues për Përdorimin e Sistemeve IT në TBU, fq. 2-3
[400] 51.1. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS;
[401] 51.2. Guidë për studentët për përdorimin e LMS;
[402] 51.3. Trajnime mbi sistemin LMS;
[403] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
[404] 44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | TBU, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH", si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ka ndërtuar një strukturë të konsoliduar për të garantuar mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e programit të studimit Master Shkencor në Inxhinieri Softuerike (MSH-IS). Mbështetja financiare mbulon të gjitha komponentët: nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, deri te mbështetja për studentët dhe funksionimi administrativ i programit. Çdo vit, TBU përgatit Pasqyrat Financiare Vjetore, të cilat përfshijnë: Pasqyrën e Bilancit, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyrën e Ndryshimeve të Kapitalit dhe Pasqyrën e Fluksit të Parave. Këto pasqyra pasqyrojnë të ardhurat nga tarifat e studentëve, projektet, trajnime dhe shërbime të tjera, si dhe ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive si kosto e punës, qirave, kërkimit shkencor, mirëmbajtjes, etj[405]. Përveç raportimit të përvitshëm, TBU ka hartuar dhe miratuar planin buxhetor afatmesëm për periudhën 2024–2027, i cili garanton qëndrueshmërinë e financimit për programin MSH-IS dhe mbështet realizimin e objektivave të tij akademike dhe kërkimore në afatmesëm[406]. Gjithashtu, informacionet mbi të ardhurat dhe burimet financiare të tjera të siguruara nga institucionit janë pasqyruar në dokumentin përkatës të të dhënave mbi të ardhurat dhe financimet e ndryshme, ku evidentohet mbështetja për programet e studimit dhe zhvillimin e tyre institucional[407]. |

[405] 50.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023
[406] 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
[407] 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | TBU për çdo vit harton Planin Buxhetor Vjetor dhe afatmesëm (3-vjeçar). Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në nivel institucioni dhe sipas njësive kryesore dhe bazë, bëhet mbështetur në kërkesat e LAL nr. 80/2015, Kreu XI. Shpenzimet në buxhet, strukturohen sipas kërkesave dhe parashikimeve të LAL, duke i detajuar përveç në nivel institucioni edhe sipas njësive kryesore dhe njësive bazë të tyre. Shpenzimet e buxhetit të TBU parashikohen të ndara, për një proces mësimor cilësor, për trajtimin ekonomik të stafit, duke mos harruar këtu edhe zbatimin e politikës së institucionit, i cili bën çdo vit përmirësimet e nevojshme të nivelit te pagave për punonjësit e stafit që përmirësojnë nivelin e kualifikimit shkencor, që kanë shënuar arritje në performancën e tyre, ose për shkak të vjetërsisë në punë në TBU për zgjidhjen e nevojave për kryerjen e praktikave mësimore e profesionale të studentëve.[408] |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në TBU, është ngritur dhe funksionon një Sistem Kontrolli i Brendshëm, mbështetur në një sistem dokumentacioni sipas kërkesave të L-AL 80/2015, akteve në zbatim të tij, të Ligjit "Për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar" dhe standardeve kontabël të zbatueshme në zbatim të tij. TBU me persona të specializuar kryen herë pas here Auditime të brendshme, për sektorë dhe problematika me risk.[409] [410] Raportet e auditimit për pjesën e pasqyrave financiare për vitet fiskale 2021,2022 janë kryer nga auditi i pavarur Kreston Albania, ndërsa për vitin 2023 jane kryer nga auditi i pavarur Nexia Albania.[411] |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | TBU siguron transparencë dhe vlerësim të qartë të realizimit të buxhetit të miratuar për vitin paraardhës, duke përfshirë edhe njësinë bazë përgjegjëse për programin MSH-IS. Çdo vit akademik, në një mbledhje të përbashkët të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit, prezantohet përmbledhja e Pasqyrave Financiare Vjetore, e shoqëruar me raportin e auditimit të pavarur. Në këtë takim marrin pjesë edhe përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ, përfshirë edhe ata të njësisë bazë të programit MSH-IS, si dhe përfaqësues të studentëve. Vendimet e miratuara nga SA reflektohen në dokumentacionin zyrtar financiar të institucionit.[412] [413] [414]Përveç pasqyrave dhe raportit të auditimit, në relacionin e tyre përfshihen të dhëna specifike për tarifat e studentëve, mënyrën e përdorimit të tyre dhe ndikimin në zhvillimin e programeve të studimit. Këto të dhëna ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të programit MSH-IS dhe përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme për vijimësinë dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit.[415]<br>Në përfundim, Zyra e Financës dhe Administratori përgatisin një tabelë të detajuar që përmbledh elementët kryesorë të shpenzimeve për 3 vitet e fundit dhe një plan për vitin pasardhës. Kjo tabelë i dorëzohet edhe njësisë përgjegjëse |

[408] 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
[409] 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2 ),
[410] 50.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023;
[411] 50.4. Raport auditimi 2021_2022_2023
[412] 50.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023, 50.4.
[413] Raport auditimi 2021_2022_2023,
[414] 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
[415] 50.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023, 54.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024

| | |
|---|---|
| | për programin MSH-IS, si pjesë e mekanizmit të vlerësimit institucional të performancës financiare të programit[416]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | TBU disponon burime financiare sistematike dhe të qëndrueshme që sigurohen nga tarifat dhe pagesat e studentëve. Ndërkohë, investitori grupi Balfin ka financuar sa herë lind nevoja për situatat e krijuara për diferencat midis të ardhurave e shpenzimeve, apo nevojave për të kryer investime, që sigurojnë standardet e nevojshme për realizimin e procesit mesimor në kushte sa më normale. Burime të dyta modeste jane ato që realizohen nga Projektet që në mënyrë modeste realizon TBU me stafin e tij gjatë veprimtarisë së tij. Në përfundim, duhet nënvizuar se TBU, në vijimësi, ka siguruar një qëndrueshmëri financiare konstante, për sigurinë e realizimit të veprimtarisë akademike.[417] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[416] 50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27
[417] 50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2 dokumenti 0.2 Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB )

# V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

**Standardi V.1**
**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.**

| Kriteret | Vlerësimi |
| --- | --- |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | TBU ka të hartuar dhe zbaton politika e procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, nga hyrja në institucion deri në diplomim, në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet e brendshme rregullatore.[418] [419]Statusi i studentit përcaktohet në mënyrë të qartë nga momenti i regjistrimit dhe përfshin të drejta e detyrime të rregulluara me kontratë dhe me rregulloret institucionale. Programi i studimit **Master i Shkencave në Inxhinieri Software** në TBU është i strukturuar mbi një bazë të qartë ligjore dhe institucionale, duke u mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", VKM nr. 41/2018 për elementët e programeve të studimit, si dhe në aktet e brendshme të institucionit si Statuti, Strategjia e Zhvillimit dhe Rregullorja e Përgjithshme e Kolegjit[420]. Rregullorja e programit përcakton në mënyrë të qartë organizimin e tij, respektimin e legjislacionit në fuqi, lirinë akademike, si dhe të drejtat e detyrimet e stafit dhe studentëve. Programi i studimit **Master i Shkencave në Inxhinieri Software** organizohet si program i ciklit të dytë, me kohë të plotë, dhe përfshin **120 kredite ECTS**, të realizueshme brenda një periudhe normale **dy-vjeçare akademike**.[421] [422] Programi përfshin të gjitha elementet e kërkuara nga kuadri ligjor si: objektivat, kriteret e pranimit, planin mësimor, metodologjitë e vlerësimit, kushtet për përparim dhe diplomim. [423][424]Përmbajtja e tij pasqyrohet në rregullore të posaçme, në përputhje me strukturën akademike dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Pas përfundimit të detyrimeve akademike, diploma lëshohet së bashku me suplementin përkatës. TBU zbaton politika të qarta për pranimin, përzgjedhjen dhe regjistrimin e studentëve, si dhe për përcaktimin dhe ruajtjen e statusit të tyre, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret institucionale. Gjithashtu, ofron mundësi për ndryshimin e profilit të studimeve dhe aplikimin për bursa, duke mbuluar të gjithë ciklin akademik nga hyrja deri në dalje.[425] Të drejtat dhe detyrat e studentëve janë të përcaktuara qartë, duke përfshirë pjesëmarrjen në jetën institucionale, vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe respektimin e rregullave të brendshme, çka garanton një përvojë akademike të strukturuar dhe të mbështetur ligjërisht nga momenti i hyrjes në institucion deri në përfundimin e suksesshëm të studimeve.[426] |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për | TBU zbaton politika të qarta dhe të barabarta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit, bazuar në kritere të përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara nga legjislacioni dhe organet institucionale, duke siguruar renditje transparente dhe trajtim të njëjtë për të gjithë aplikantët. Studentëve u garantohet e drejta për të zgjedhur ose ndryshuar profilin e studimeve dhe u ofrohen mundësi mbështetëse si bursa apo reduktime tarifash mbi bazë merite apo kriteresh sociale, ndërkohë që statusi i studentit rregullohet |

418 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
419 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (shqip)
420 61. Ligj_80-2015_22.07.2015
421 2. Statuti i TBU
422 32. Rregullore për Transferimin e studimeve
423 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
424 10. Formati i tezës së provimit përfundimtar
425 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. e TBU)
426 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

| | |
|---|---|
| studentë dhe studentët e programit të studimit. | në mënyrë të njëtrajtshme, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet përkatëse gjatë gjithë periudhës së studimeve.[427] Procedurat e përshkruara në lidhje me çregjistrimin, ndjekjen e frekuentimit, administrimin e provimeve, komunikimin zyrtar dhe dokumentimin e vlerësimeve tregojnë se TBU siguron zbatim të njëtrajtshëm dhe të dokumentuar për të gjithë studentët, duke garantuar trajtim të barabartë dhe respektim të të drejtave të tyre në çdo hap të procesit akademik. Roli i Sekretarisë Mësimore është i standardizuar dhe i bazuar në transparencë, përgjegjësi dhe bashkërendim me strukturat e tjera institucionale, duke garantuar mbështetje të barabartë për çdo student nga regjistrimi deri në përfundimin e studimeve.[428] Në TBU janë të përcaktuara qartë rregullat e sjelljes dhe detyrimet e studentëve, të zbatueshme njësoj për të gjithë gjatë gjithë periudhës së studimeve. Dispozitat që rregullojnë respektin, ndershmërinë akademike dhe sjelljen qytetare zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme, pa përjashtime. Shkeljet trajtohen përmes një sistemi të gradës disiplinore të bazuar në transparencë dhe drejtësi, me mbikëqyrje nga Këshilli i Etikës. Çdo student ka të drejtë të denoncojë shkeljet dhe të trajtohet barazisht në çdo proces disiplinor apo administrativ, duke u mbështetur në dispozitat e miratuara nga organet drejtuese të institucionit.[429] Për të gjithë studentët e TBU, Zyra e Çështjeve Studentore në TBU ofron shërbime të strukturuara dhe të aksesueshme, që nga orientimi në fillim të studimeve deri te mbështetja përpunësim pas diplomimit. Përmes këshillimit, praktikave, trajnimeve dhe bashkëpunimeve me tregun e punës, sigurohet trajtim i barabartë dhe mbështetje e vazhdueshme për çdo student.[430] |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | TBU ka të përcaktuara dhe publikon çdo vit akademik kritere të qarta dhe të veçanta për pranimin në programet e studimit, të ndara në kritere të përgjithshme sipas legjislacionit dhe kritere të posaçme sipas programit përkatës ose vendimeve të Senatit Akademik. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet mbi bazën e renditjes dhe kuotave të miratuara, ndërsa procesi i regjistrimit dhe fitimi i statusit të studentit zhvillohet në përputhje me afatet ligjore. Gjithashtu, studentëve u ofrohet mundësia për përzgjedhjen ose ndryshimin e profilit të studimit dhe përfitimin e bursave apo reduktimeve tarifore sipas kritereve të miratuara me dokument të veçantë, duke garantuar transparencë dhe qasje të barabartë për të gjithë kandidatët.[431] Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software në TBU përcakton qartë kriteret e pranimit, të cilat përfshijnë posedimin e një diplome Bachelor (shqiptare ose të huaj), pagesën e tarifës së regjistrimit dhe, për çdo vit akademik, kritere të veçanta të miratuara nga Rektori mbi propozim të njësive përgjegjëse. Këto kritere publikohen përpara fillimit të regjistrimeve dhe janë të vlefshme për të gjithë kandidatët, përfshirë ata që aplikojnë për një program të dytë apo me transferim. Gjithashtu, janë të përcaktuara qartë edhe afatet zyrtare dhe maksimale të përfundimit të programit, duke garantuar transparencë dhe barazi në procesin e pranimit.[432] Përmes pjesëmarrjes në aktivitete orientuese si panaire dhe ditë informimi, TBU prezanton çdo vit akademik ofertën e vet akademike, kriteret e pranimit, kuotat, mundësitë për bursa dhe informacion të detajuar për programet e studimit. Këto aktivitete shërbejnë si një mjet transparent për publikimin e kritereve të veçanta të pranimit dhe promovimin e studentëve si produkt përfaqësues i institucionit.[433][434] |

[427] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"

[428] 8. Rrregullore per sekretarine mesimore

[429] 18. Kodi i Etikes

[430] 14. Rregullore e Zyres se Ceshtjeve Studentore

[431] 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkëputur nga Rreg. E TBU)

[432] 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software (shqip)

[433] 49. Politika e Marketingut të TBU për Programet e Studimit

[434] 14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen, regjistrimin dhe ndryshimin e profilit në TBU janë të qarta dhe bazohen në legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme. Aplikimet bëhen brenda afateve të caktuara, ndërsa përzgjedhja bëhet në bazë të renditjes së kandidatëve që plotësojnë kriteret, me një numër të kufizuar studentësh për çdo program. Studentët fitojnë statusin me regjistrimin dhe e humbasin atë në rast diplomimi, transferimi, çregjistrimi ose përjashtimi. Të gjitha procedurat janë transparente, të thjeshta për t'u kuptuar dhe të aksesueshme për publikun.[435] Procedurat për pranimin, transferimin dhe njohjen e studimeve të mëparshme në TBU janë të përcaktuara qartë në një rregullore të mbështetur në Ligjin 80/2015 dhe aktet përkatëse nënligjore, duke garantuar përputhje me Kartën e Bolonjës.[436] Rregullorja përcakton hapat e qartë për aplikimin, dokumentacionin e nevojshëm, vlerësimin nga Komisioni për Transferimet dhe Njohjen e Krediteve, si dhe kriteret për ekuivalentimin e lëndëve, krediteve dhe notave.[437] Procesi është i strukturuar dhe transparent, duke u bazuar në kritere akademike objektive dhe afate të përcaktuara, ndërsa të gjitha informacionet janë të aksesueshme për studentët përmes Zyrës së Pranimeve dhe Zyrës së Regjistrimit të Studentëve. Kjo siguron që kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, vlerësimit dhe diplomimit të jenë lehtësisht të kuptueshme dhe të hapura për publikun.[438] |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren, TBU garanton informimin e vazhdueshëm dhe transparent të publikut dhe të interesuarve për programet e studimit, tarifat dhe kriteret e pranimit përmes një sërë formatesh komunikimi, përfshirë faqen zyrtare të internetit, rrjetet sociale, portalet informative, televizionin, radion, reklamimin outdoor dhe pjesëmarrjen aktive në panaire[439] dhe aktivitete orientimi për karrierën. Këto kanale të ndryshme sigurojnë një mbulim të gjerë informimi, duke mundësuar që informacioni i nevojshëm të jetë i aksesueshëm për të gjithë kandidatët potencialë përpara fillimit të çdo viti akademik.[440] TBU garanton transparencë dhe informim të plotë për kandidatët dhe publikun në lidhje me kriteret e pranimit në programet e studimit, përmes publikimit të qartë të kritereve të përgjithshme dhe të posaçme të pranimit, siç parashikohen në "Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU". Ky dokument shërben si baza kryesore ligjore dhe procedurale, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", për të siguruar që çdo kandidat të informohet qartë dhe në kohë përpara fillimit të vitit akademik mbi të gjitha kushtet e nevojshme për aplikim dhe regjistrim në programe studimi.[441][442] |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe | TBU ndjek një politikë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për pranimin e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara, duke garantuar akses të barabartë në arsim dhe mbështetje për integrimin e tyre. Kritere të veçanta hartohen dhe publikohen çdo vit në faqen zyrtare të TBU dhe në dokumentet përkatëse rregullatore. Kuotat dhe kriteret specifike dërgohen zyrtarisht në MAS, në përputhje me rregulloret në fuqi. Përveç procedurave të pranimit, TBU siguron edhe mbështetje akademike dhe sociale për këta studentë, duke krijuar kushte të përshtatshme për ndjekjen e studimeve. I gjithë |

---

435 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"

436 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. e TBU)

437 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (shqip)

438 32. Rregullore per Transferimin e studimeve

439 14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25

440 49. Politika e Marketingut të TBU për Programet e Studimit

441 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. e TBU)

442 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (shqip)

| | |
|---|---|
| shtresave të margjinalizuara. | procesi zhvillohet në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke reflektuar angazhimin e institucionit për barazi dhe gjithëpërfshirje në arsimin e lartë.[443] |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | TBU garanton qasje të barabartë për kandidatët nga shtete të tjera, duke u mundësuar atyre pranimin në të dy ciklet e studimeve sipas kritereve të përgjithshme ligjore dhe kritereve të veçanta të miratuara nga institucionet drejtuese.[444] [445]Këto kritere publikohen përpara çdo viti akademik dhe vlejnë njësoj për studentë vendas dhe të huaj, përfshirë rastet e transferimit të studimeve dhe njohjes së krediteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e TBU-së.[446] [447] [448] |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | TBU zbaton politika të qarta për mbështetjen financiare të studentëve nga shtresa në nevojë, duke ofruar skema bursash dhe lehtësira të veçanta për të garantuar akses të barabartë në arsim.[449] [450]Këto politika synojnë jo vetëm ndihmën sociale[451], por edhe rritjen e cilësisë së pranimit në programe që kanë rëndësi strategjike për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.<br>Bursat dhe format e ndihmës financiare përcaktohen çdo vit dhe publikohen në faqen zyrtare të TBU-së.[452] Ato ofrohen bazuar në kritere akademike dhe sociale, në përputhje me rregulloret institucionale dhe udhëzimet e MASR. Përveç bursave të ofruara nga universiteti, TBU bashkëpunon me institucione publike dhe private për të krijuar mundësi financimi shtesë për studentët me rezultate të larta dhe ata në nevojë.[453] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Tirana Business University garanton transparencë dhe qartësi të plotë lidhur me përparimin akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin.[454] Informacioni mbi strukturën e vitit akademik, ngarkesën mësimore, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit, si dhe kushtet për të kaluar vitin, përcaktohen në rregullore dhe syllabus-et përkatëse. Vlerësimi i studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfshin komponentë të ndryshëm si provime, detyra kursi, pjesëmarrje aktive dhe projekte.[455] Procedurat për riprovime dhe përsëritje viti janë gjithashtu të qarta dhe të aksesueshme. Studentët informohen |

443 60.6. Skema e bursave sociale në TBU
444 60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25
445 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025
446 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
447 69.1. Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25
448 69. Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025
449 60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25
450 60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23
451 60.6. Skema e bursave sociale në TBU
452 60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025
453 60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25
454 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
455 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software (shqip)

| | |
|---|---|
| | rregullisht përmes sekretarisë mësimore dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm (LMS)[456] [457] [458], i cili u ofron akses të vazhdueshëm dhe në distancë në informacionin e nevojshëm për ecurinë e tyre akademike. Kjo siguron përmbushjen e standardeve të transparencës dhe mbështetjes akademike gjatë gjithë ciklit të studimeve.[459] [460] |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Tirana Business University ka hartuar dhe zbaton një rregullore të posaçme që rregullon në mënyrë të qartë kriteret dhe procedurat për transferimin e studimeve dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe parimet e Kartës së Bolonjës. Rregullorja përcakton hap pas hapi procesin e aplikimit për studentët që kërkojnë të transferohen në TBU nga institucione të tjera të arsimit të lartë, brenda ose jashtë vendit, si dhe për studentët që kërkojnë njohje kreditesh për lëndë të ndjekura më parë.[461] Janë përcaktuar qartë dokumentet që kërkohen, afatet e shqyrtimit, dhe roli i Komisionit të Transferimeve dhe Njohjes së Krediteve, i cili merr vendimin përfundimtar mbi ekuivalentimin e lëndëve, vlerësimin e krediteve dhe vitin në të cilin studenti do të regjistrohet. [462]TBU informon studentët në çdo hap të këtij procesi përmes Zyrës së Pranimeve dhe Zyrës së Çështjeve Studentore[463], duke garantuar transparencë, barazi në trajtim dhe respektim të standardeve akademike. Gjithashtu, studentët njoftohen për detyrimet akademike që duhet të plotësojnë për të përfunduar studimet dhe për procedurat financiare përkatëse. Kjo qasje siguron që çdo student të ketë informacion të plotë dhe të saktë mbi mundësinë dhe mënyrën e njohjes së kualifikimeve të mëparshme[464], si pjesë e integrimit të tyre në programin përkatës të studimit në TBU.[465] |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në TBU, procesi i vlerësimit të studentëve bazohet në rregulla të qarta dhe të strukturuara, të cilat u komunikohen studentëve në fillim të çdo lënde, përmes programeve të lëndëve dhe sesioneve informuese të zhvilluara nga pedagogët. Format e vlerësimit përfshijnë provime me shkrim, detyra kursi, projekte dhe forma të tjera të kombinuara, të përcaktuara në programin e lëndës. Vlerësimet regjistrohen në mënyrë zyrtare në fletë provimi dhe procesverbale, dhe studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatin përmes sistemit të informatizuar dhe të kërkojnë rishikim në rast mospajtimi. Afatet, procedurat dhe transparenca në komunikimin e rezultateve garantojnë që çdo student të jetë i informuar dhe i trajtuar në mënyrë të barabartë gjatë gjithë procesit të vlerësimit.[466] |

456 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS
457 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
458 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
459 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
460 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
461 32. Rregullore për Transferimin e studimeve
462 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkeputur nga Rregullore. e TBU)
463 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore
464 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
465 9. Rregullore e programit te studimit MSh _Inxhinieri Software (shqip)
466 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software (shqip)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | TBU informon qartë studentët mbi të gjitha kriteret dhe procedurat që lidhen me punimin e diplomës dhe procesin e diplomimit.[467] [468]Në përfundim të studimeve, studentët kanë të drejtë të diplomohen përmes një provimi përfundimtar ose përgatitjes dhe mbrojtjes së një punimi diplome, sipas llojit të programit. Për studentët e programeve Master të Shkencave, diploma fitohet vetëm përmes punimit dhe mbrojtjes së tezës. Përgatitja e diplomës bëhet në përputhje me udhëzimet përkatëse, me miratim të temës dhe udhëheqësit në fazat përfundimtare të studimeve.[469] Mbrojtja zhvillohet në sesione të përcaktuara nga Rektori, ndërsa diploma e lëshuar shoqërohet me suplementin përkatës, në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.[470] Për të diplomuarit organizohet gjithashtu një ceremoni zyrtare.[471] |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Tirana Business University (TBU) zbaton një strategji të gjithanshme informimi dhe promovimi për të siguruar që të gjithë studentët e ardhshëm dhe të interesuarit informohen në mënyrë të plotë dhe periodike për programet e studimit që ofron. [472]Përpara fillimit të çdo viti akademik, TBU ndërmerr një sërë aktivitetesh si konkurse kombëtare për gjimnazistët, trajnime tematike, pjesëmarrje në panaire dhe ditë informuese në qytete të ndryshme të Shqipërisë. [473]Gjithashtu, institucioni zhvillon takime të hapura dhe promovon programet përmes kanaleve të marketingut dixhital dhe tradicional, duke përfshirë mediat sociale, portale online, televizion, radio dhe materiale të ekspozuara në mjedise urbane. Në të gjitha këto forma, theksi vihet jo vetëm te oferta akademike, por edhe te përfshirja e studentëve aktualë në këto aktivitete si mënyrë për të përçuar modelin e suksesit të TBU. Këto veprime garantojnë informim të vazhdueshëm dhe të strukturuar për çdo të interesuar.[474] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Studentët që ndjekin programin Master në Inxhinieri Software në TBU informohen në mënyrë të plotë dhe të detajuar për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve përmes dokumenteve zyrtare si rregullorja e programit, plani mësimor dhe kurrikula. Programi është i organizuar në 2 vite akademike dhe përfshin 120 kredite ECTS, të ndara sipas kategorive të përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.[475] Në dokumentacionin e |

467 17.1. Forma e re e propozuar e diplomes dhe suplementit_per programin e studimit MSh Inxhinieri Software
468 11. Udhezim per pergatitjen e temes se diplomes
469 12.2.Kalendari Akademik 2024-2025
470 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
471 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
472 49. Politika e Marketingut te TBU per Programet e Studimit
473 14.2. Ftese per panair
474 14.5. Ditet informuese ne TBU
475 9. Rregullore e programit të studimit MSh _Inxhinieri Software" (shqip)

| | |
|---|---|
| | publikuar dhe të vënë në dispozicion për studentët, përfshihen gjithashtu kriteret e pranimit, procedurat për përzgjedhjen e profilit të studimit, afatet për regjistrim dhe informacion mbi statusin e studentit. TBU garanton transparencë duke publikuar çdo kriter pranimi apo transferimi, përfshirë dhe mundësinë për përjashtime apo njohje të krediteve, si dhe duke respektuar kuadrin ligjor për arsimin e lartë. Gjithashtu, çdo informacion për zhvillimin e procesit mësimor, përmbajtjen e lëndëve dhe organizimin e vitit akademik publikohet për studentët dhe është i lehtësisht i aksesueshëm.[476] |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Rregullorja e TBU për pranimin dhe transferimin e studentëve përmban dispozita të detajuara që sigurojnë aksesin e plotë të studentëve në informacionin mbi lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit. [477] [478]Ajo përcakton qartë procesin e njohjes së krediteve, përfshirë përmbajtjen e lëndëve të studiuara më parë, programet mësimore të tyre dhe kriteret e ekuivalentimit sipas ECTS.<br>Komisioni i Transferimeve dhe Njohjes së Krediteve vlerëson përmbajtjen e lëndëve në aspektin e orëve, tematikës dhe rezultateve të të nxënit, duke garantuar që çdo vendim për njohje bazohet në transparencë dhe përafrim të qartë akademik. Dokumentet e kërkuara për aplikim, përfshirë programet e lëndëve, listat e notave dhe vërtetimet zyrtare, u mundësojnë studentëve një pasqyrë të plotë për strukturën dhe përmbajtjen e programeve në të cilat dëshirojnë të transferohen.[479] Gjithashtu, vendimi i ekuivalentimit dokumentohet dhe arkivohet në dosjen personale të studentit, duke siguruar gjurmueshmëri të qartë mbi përmbajtjen e çdo moduli të njohur.[480] [481] |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Zyra e Çështjeve Studentore pranë TBU ka një rol kyç në orientimin e studentëve drejt tregut të punës dhe mbështetjen për zhvillimin e karrierës së tyre.[482] Ajo funksionon si një njësi e integruar në strukturën institucionale dhe ka për qëllim të ndihmojë studentët në zhvillimin e potencialit të tyre profesional përmes këshillimit, praktikave profesionale, mundësive për trajnime, bursa, pjesëmarrje në panaire punësimi, dhe lidhjeve me punëdhënës të mundshëm. Përmes bashkëpunimeve me sektorin privat e publik, dhe veçanërisht me grupin Balfin, Zyra mbështet studentët në gjetjen e mundësive të punësimit ose internship-eve. Organizohen gjithashtu takime të hapura me profesionistë të fushave të ndryshme, workshope dhe aktivitete të vazhdueshme që i ekspozojnë studentët ndaj realitetit të tregut të punës dhe i ndihmojnë të ndërtojnë një rrjet profesional kontakti.[483] Ndërkohë, praktika mësimore është e detyrueshme në programet e studimit dhe organizohet në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës. Studentët ndjekin praktika në institucione publike ose private, duke reflektuar dhe dokumentuar përvojën e tyre në një raport zyrtar që vlerësohet nga komision |

[476] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"

[477] 21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)

[478] 22. Formati i Syllabusit (shqipanglisht) VKM 412018

[479] 32. Rregullore per Transferimin e studimeve

[480] 16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese të MSh Inxhinieri Software

[481] 16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)

[482] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

[483] 14.2. Ftese per panair

| | |
|---|---|
| | i dedikuar.[484] [485] [486] [487]Gjithashtu, përmes rrjetit Alumni, TBU promovon bashkëpunimin ndërmjet të diplomuarve dhe studentëve, duke ofruar mundësi shtesë për informim dhe punësim.[488] Këto struktura e aktivitete përmbushin standardin që kërkon informim të detajuar dhe mbështetje institucionale për hyrjen e studentëve në tregun e punës.[489] |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Programet e studimit në TBU janë të organizuara në bazë të strukturës akademike vjetore me semestra të mirëpërcaktuar. Për çdo program, rregulloret përmbajnë informacione të detajuara për qëllimin e programit, strukturën, numrin e krediteve (ECTS), kategoritë e lëndëve, si dhe metodologjinë e zhvillimit të procesit mësimor dhe kontrollit të dijes. Syllabuset e çdo lënde janë të standardizuara, përgatiten nga pedagogët dhe miratohen nga departamentet përkatëse. Ato përfshijnë informacion mbi tematiken, orët mësimore, metodat e vlerësimit dhe pjesëmarrjen në seminare/praktika.[490] Në nivel organizativ, orari mësimor për çdo vit akademik shpallet nga Rektori, bazuar në strukturën e miratuar nga Senati. Orari përfshin ndarjen e ditëve të mësimit, ngarkesën javore në auditor, ditët e pushimit zyrtar dhe konsultimet me pedagogët. Për studentët me aftësi të kufizuara ose angazhime të veçanta, parashikohet edhe forma e individualizuar e mësimdhënies. Një komponent kyç në informimin e studentëve është sistemi LMS, i cili përdoret për ngarkimin e materialeve mësimore, shpalljen e rezultateve të provimeve, kalendarin e aktiviteteve akademike dhe njoftimet e rëndësishme.[491] Ky sistem përforcon qasjen në distancë të studentëve në informacion dhe i mbështet ata në menaxhimin personal të mësimit dhe detyrimeve akademike. [492]Nëpërmjet LMS, studentët kanë gjithashtu akses në syllabuset përkatëse të çdo lënde, që përshkruajnë qartë metodat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit dhe literaturën bazë.[493] [494]Në përfundim, informacioni në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor, format e mësimdhënies, oraret, pjesëmarrjen në leksione/seminare, dhe mënyrat e vlerësimit u ofrohet studentëve në mënyrë të detajuar përmes rregulloreve, syllabuseve, orarit zyrtar dhe sesioneve të informimit, duke përmbushur plotësisht kriterin e standardit për informimin mbi organizimin dhe funksionimin e procesit mësimor.[495] |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Tirana Business University (TBU) siguron përmbushjen e plotë të kriterit që lidhet me aksesin në informacionin për programin e studimit përmes një sistemi të integruar të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky sistem përfshin përdorimin aktiv të platformës elektronike të të mësuarit (LMS), e cila funksionon si një mjet qendror për shpërndarjen e informacionit akademik dhe administrativ për studentët. Përmes LMS, çdo student ka akses të sigurt dhe të personalizuar në programin e studimit, syllabuset e lëndëve, oraret e leksioneve |

484 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI
485 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
486 36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse
487 36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25
488 19. Studimi i tregut te punes
489 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23)
490 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
491 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS
492 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit
493 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
494 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
495 43.2. Mjediset e FakultetitNjësive Bazë (Aneks Tabela 16)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe seminareve, kalendarin akademik, njoftimet zyrtare, rezultatet e provimeve, si dhe materialet mësimore të përditësuara të ngarkuara nga pedagogët. Gjithashtu, sistemi përdoret për menaxhimin e detyrave, feedback-ut nga pedagogët dhe komunikimin dypalësh me stafin akademik dhe administrativ.[496] Aksesueshmëria në distancë është plotësisht e garantuar, duke mundësuar që studentët të informohen dhe të ndjekin progresin akademik në kohë reale, pavarësisht vendndodhjes së tyre fizike. Kjo strukturë siguron transparencë, efikasitet dhe mbështetje të vazhdueshme për të gjithë procesin mësimor.[497 498] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Tirana Business University (TBU) disponon dhe mban statistika të detajuara dhe vjetore për numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në programin MSh në Inxhinieri Software dhe programe të tjera.[499 500]Këto të dhëna mblidhen përmes sistemeve të brendshme të informacionit dhe sekretarive mësimore, të cilat administrojnë dhe përditësojnë regjistrat akademikë në përputhje me Rregulloren e Zyrës së Çështjeve Studentore dhe Rregulloren e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. TBU siguron verifikimin dhe kontrollin periodik të këtyre statistikave në bashkëpunim me njësitë përgjegjëse. Përveç kësaj, raportet analitike mbi hyrjen dhe daljen e studentëve dhe treguesit e diplomimit përgatiten rregullisht nga departamenti përgjegjës, siç reflektohet në Raportin vjetor të DIS dhe në Analizën e departamentit mbi arritjen e objektivave të programit. Kjo praktikë e mirë e mbajtjes dhe përditësimit të statistikave garanton transparencë, siguri dhe mundësi verifikimi nga organet e brendshme dhe jashtme[501 502], duke mbështetur më tej zhvillimin strategjik dhe cilësinë e programeve të studimit në TBU.[503 504 505 506] |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga | Tirana Business University (TBU) disponon statistika vjetore të detajuara që përfshijnë numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit nga fillimi deri në diplomim, si dhe të dhëna mbi tërheqjet, largimet para përfundimit të |

496 44.1. Udhëzues për Përdorimin e teknologjisë të informacionit

497 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS

498 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS

499 Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse (Tabela 8)

500 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21)

501 43. Raporti i MAS per inspektimin e kapaciteteve (2022-2023)

502 43.1. Raporti i MAS per inspektimin e kapaciteteve (2024)

503 54.1. Raporti Vjetor institucional 2021-2022

504 54.2. Raporti Vjetor institicional 2022-2023

505 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024

506 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024

| | |
|---|---|
| programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | programit dhe mospërfundimet e suksesshme të vitit akademik.[507] [508] [509] [510] Këto të dhëna menaxhohen në sistemet brenda institucionit dhe përditësohen rregullisht nga sekretaritë mësimore dhe departamentet përgjegjëse.[511] TBU dokumenton dhe analizon këto statistika për të ndjekur rrjedhën e studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke mundësuar marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të programeve të studimit.[512] [513] [514] [515] |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Në TBU, Zyra e Çështjeve Studentore është një strukturë e mirëorganizuar që funksionon në mbështetje të studentëve gjatë gjithë ciklit të tyre akademik, duke u fokusuar në orientimin profesional, ndërlidhjen me tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës.[516] Kjo zyrë mbledh dhe menaxhon të dhëna të detajuara për studentët, përfshirë informacion mbi regjistrimet, praktikat profesionale, aktivitetet këshilluese, mundësitë e punësimit dhe kontaktet me alumnit. Të gjitha këto të dhëna ruhen dhe përpunohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit të institucionit, i cili siguron ruajtjen e konfidencialitetit, aksesin vetëm nga personat e autorizuar dhe verifikueshmërinë e informacionit. Zyra gjithashtu përdor këto të dhëna për të analizuar ecurinë e studentëve dhe për të propozuar përmirësime të vazhdueshme në kurrikula, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Në funksion të monitorimit dhe menaxhimit të të dhënave të studentëve, sekretaria mësimore mban regjistra zyrtarë të pjesëmarrjes dhe ndjekjes së mësimit nga studentët, të cilët ruhen dhe administrohen sipas një rregulloreje të veçantë dhe janë pjesë e arkivit zyrtar të TBU-së.[517] Këto regjistra përmbajnë informacione të verifikueshme mbi zhvillimin e procesit mësimor dhe pjesëmarrjen e studentëve. Sekretaria dhe Kryesekretari janë përgjegjës për administrimin, verifikimin dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me pranimin, transferimin, regjistrimin dhe diplomimin e studentëve.[518] [519] [520] |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me | Rregullorja e TBU dhe ajo e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit janë hartuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi. Ato përcaktojnë qartë bazën ligjore, strukturën organizative, organet drejtuese dhe funksionet përkatëse në nivel universiteti dhe fakulteti.[521] [522] Fakulteti përbëhet nga departamente dhe drejtohet nga dekani, i cili ushtron kompetenca të plota menaxheriale e akademike, në bashkëpunim me dekanatin dhe administratën. Rregulloret përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet mes palëve, parimet e lirisë dhe cilësisë akademike, si dhe rregullat për funksionimin e procesit mësimor, |

507 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21)
508 69. Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025
509 69.1. Procedura per rialokimin e kuotave te pranimit 24-25
510 31. Procedura e Pranimit te Studenteve ne TBU (Shkeputur nga Rregullore. e TBU)
511 43.1. Raporti i MAS per inspektimin e kapaciteteve (2024)
512 54.1. Raporti Vjetor institucional 2021-2022
513 54.2. Raporti Vjetor institicional 2022-2023
514 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
515 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
516 14. Rregullore e Zyres se Ceshtjeve Studentore
517 8. Rregullore per Sekretarine Mesimore
518 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
519 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
520 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
521 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
522 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

| | |
|---|---|
| studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | kërkimin shkencor dhe shërbimet ndaj studentëve, duke garantuar një funksionim të qëndrueshëm dhe të rregullt institucional.[523] |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e programit të studimit "Master Shkencor në Inxhinieri Software", njësia bazë realizon në mënyrë të rregullt hartimin e raporteve analitike dhe periodike mbi profilin dhe performancën e studentëve në hyrje dhe në dalje nga programi.[524] [525]Këto raporte përmbajnë të dhëna statistikore dhe analiza mbi cilësinë akademike të studentëve në fazën e regjistrimit, progresin e tyre gjatë studimeve, rezultatet e arritura në përfundim të programit, si dhe informacion mbi shkallën e punësimit të tyre pas diplomimit. Analizat e kryera ndihmojnë njësinë të vlerësojë në mënyrë objektive përputhshmërinë ndërmjet objektivave të programit dhe rezultateve të arritura, si dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në suksesin apo vështirësitë e studentëve. [526] [527] [528]Në funksion të këtyre të dhënave, ndërmerren masa konkrete për përmirësimin e cilësisë së programit, si rishikimi i përmbajtjes lëndore, përmirësimi i metodave të mësimdhënies dhe forcimi i bashkëpunimit me aktorët e tregut të punës. Këto mekanizma garantojnë që programi të ruajë relevancën e tij akademike dhe profesionale, duke kontribuar njëkohësisht në rritjen e shkallës së punësimit të të diplomuarve dhe në përmbushjen e pritshmërive të studentëve dhe të industrisë.[529] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Në Tirana Business University (TBU), studentët gëzojnë statusin e tyre nga momenti i regjistrimit dhe e ruajnë atë deri në diplomim apo çregjistrim, duke kaluar më pas në statusin alumni. [530] [531]Ata kanë të drejta dhe detyrime të përcaktuara qartë në ligj dhe në aktet rregullatore të institucionit, përfshirë të drejtën për të ndjekur mësimet, për të përdorur infrastrukturën, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për të shprehur vlerësime për cilësinë e mësimdhënies.[532] [533] Studentët përfaqësohen në organet e institucionit përmes Këshillit Studentor dhe Senatit Studentor, të cilët zgjidhen përmes procesesh |

523 8. Rregullore per Sekretarine Mesimore
524 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
525 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21)
526 54.1. Raporti Vjetor institucional 2021-2022
527 54.2. Raporti Vjetor institicional 2022-2023
528 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
529 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
530 2.Statuti TBU
531 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
532 59. Rregullore e Këshillit Studentor
533 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | demokratike. Këto struktura mbrojnë interesat e studentëve, japin mendime dhe propozime për përmirësimin e jetës akademike dhe shërbimeve, si dhe nxisin pjesëmarrjen në veprimtari kulturore, shkencore e sociale. Përfshirja e studentëve në vendimmarrje është e garantuar me legjislacionin dhe rregulloret e brendshme të institucionit.[534] [535] |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | TBU ka krijuar një mekanizëm funksional dhe të dokumentuar për përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit akademik, përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo njësi është përgjegjëse për zhvillimin e pyetësorëve që fokusohen në cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturës, metodologjisë së punës së stafit akademik dhe marrëdhënieve me studentët. Procesi i anketimit është zhvilluar me pjesëmarrjen aktive të studentëve të programeve Bachelor dhe Master, të cilët janë informuar për rëndësinë dhe mënyrën e realizimit të tij në auditorë, në prani të përfaqësuesve të stafit dhe drejtuesve të njësive përkatëse.[536] Të dhënat e mbledhura janë analizuar dhe përfshihen në raport, me qëllim identifikimin e problematikave dhe përmirësimin e vazhdueshëm institucional.[537]<br>Tirana Business University College (TBU), përmes zhvillimit të strukturave dhe mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, ka garantuar përfshirjen aktive dhe të matshme të studentëve në procesin akademik. Fakulteti i Teknologjisë dhe Informacionit (FTI), që operon nga viti 2023, ka ndërmarrë hapa konkretë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të ofruar.<br>Një nga mjetet kryesore për këtë qëllim ka qenë realizimi i fokus-grupeve studentore, të cilat janë zhvilluar me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të studentëve të programeve të ndryshme. Përmes diskutimeve të strukturuara, janë adresuar aspekte që lidhen me zgjedhjen e programeve, cilësinë e mësimdhënies, angazhimin e stafit, shërbimet akademike dhe administrative, si dhe perspektivat e punësimit. [538]Vlerësimet dhe sugjerimet e studentëve janë marrë në konsideratë dhe janë përdorur për përmirësimin e proceseve të brendshme akademike.<br>Gjithashtu, monitorimi i mësimdhënies dhe vlerësimi i performancës së pedagogëve përfshin komponentë që lidhen me komunikimin me studentët dhe respektimin e standardeve të procesit mësimor. Këto vlerësime shërbejnë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë, por edhe për vendimmarrje të mëtejshme institucionale lidhur me zhvillimin profesional të stafit.[539] |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e | Tirana Business University, nëpërmjet strukturave akademike dhe Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), garanton përfshirjen aktive dhe të vazhdueshme të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. [540] [541]Kjo përfshirje realizohet mbi baza të rregullta |

534 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
535 59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25
536 35.9.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
537 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
538 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
539 35.6.Raporti vjetor KC FTI 2023-2024
540 35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
541 35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve

| | |
|---|---|
| tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | dhe në mënyrë të strukturuar, përmes një sërë mekanizmash të miratuar nga institucionit.[542]<br>Në kuadër të këtyre proceseve:<br>• Studentët kontribuojnë me sugjerime dhe vlerësime përmes pyetësorëve periodikë, të cilët fokusohen jo vetëm në cilësinë e mësimdhënies, por edhe në përmbajtjen, strukturën dhe përputhshmërinë e programeve me pritshmëritë e tyre dhe kërkesat e tregut të punës.<br>• Grupet e fokusit janë përdorur në raste të veçanta për të marrë mendime më të thelluara dhe specifike nga studentët mbi komponentët përbërës të programit të studimit.<br>• Mbledhjet e departamenteve zhvillohen në prani të përfaqësuesve të studentëve, të cilët marrin pjesë me të drejtë diskutimi, duke sjellë perspektivën e tyre në proceset vendimmarrëse që lidhen me përmbajtjen, strukturën dhe nevojën për përmirësim të moduleve apo të të gjithë programit.<br>Sugjerimet dhe kontributi i studentëve dokumentohen dhe trajtohen me seriozitet nga departamentet përkatëse, dhe çdo ndryshim i propozuar në program i referohet edhe analizës së këtyre inputeve studentore. Në këtë mënyrë, TBU siguron jo vetëm përfshirjen formale, por edhe reflektimin real të zërit të studentëve në zhvillimin akademik, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të ofruar.[543] [544] [545] |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Tirana Business University garanton zbatimin e parimeve të barazisë, transparencës dhe ndershmërisë në të gjitha fazat e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve të studentëve. Institucioni ka në funksion një kuadër të qartë rregullator, të përfshirë në Rregulloren e Studimeve dhe dokumente të tjera përkatëse, që u njeh studentëve të drejtën për të dhënë mendimin dhe për të reaguar në mënyrë të drejtëpërdrejtë lidhur me mënyrën e vlerësimit të tyre.[546] [547]<br>Studentëve u mundësohet:<br>• Të shprehin mendimin dhe të ankimojnë rezultatet e vlerësimeve përmes procedurave të parashikuara zyrtarisht, të cilat përfshijnë paraqitjen e një kërkese me shkrim për rishikimin e provimit ose të rezultatit të lëndës.<br>• Të kërkojnë transparencë në procesin e vlerësimit, duke u informuar mbi kriteret e vlerësimit që përdoren nga pedagogët dhe duke pasur akses për të parë provimet e tyre të korrigjuara, kur kërkohet.<br>• Të përfshihen në pyetësorët institucionalë, ku ata vlerësojnë edhe aspektin e ndershmërisë dhe objektivitetit të procesit të vlerësimit.<br>Institucioni, nëpërmjet njësive akademike dhe NJSBC-së, merr në shqyrtim çdo ankesë të paraqitur nga studentët dhe garanton një proces të paanshëm rishikimi, |

[542] 35.9.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[543] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[544] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[545] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[546] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU
[547] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | i cili përfshin konsultimin me pedagogun përgjegjës dhe, kur është e nevojshme, me strukturat përkatëse drejtuese të fakultetit apo të institucionit.[548] [549] [550] Për më tepër, çdo reflektim apo përmirësim që buron nga rastet e ankimimit dokumentohet dhe trajtohet me seriozitet, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të praktikave të vlerësimit dhe forcimin e besimit të studentëve në ndershmërinë e procesit mësimor.[551] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | TBU ka vendosur dhe zbatuar procedura të qarta, të dokumentuara dhe të përputhshme me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të brendshme për të garantuar shërbimin e plotë dhe cilësor ndaj studentëve. Në këtë kuadër, funksionojnë disa njësi të posaçme që janë lehtësisht të aksesueshme dhe të organizuara për të përmbushur nevojat e studentëve në fushën e informimit, orientimit dhe mbështetjes.[552] [553]<br>Zyra e Çështjeve Studentore është njësia kryesore që merret me administrimin e çështjeve akademike dhe shërbimeve të ndryshme për studentët, duke përfshirë regjistrimin, dokumentacionin, procesin e transferimeve dhe menaxhimin e ankimimeve dhe problematikave që mund të hasin studentët gjatë studimeve.[554]<br>Për më tepër, Zyra e Këshillimit Akademik siguron asistencë të vazhdueshme për studentët lidhur me përparimin në studime, zgjedhjen e lëndëve dhe orientimin akademik, duke ndihmuar në planifikimin dhe monitorimin e rrugës së tyre studimore.<br>Në kuadër të orientimit për karrierën dhe përgatitjen për tregun e punës, funksionon Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila ofron këshillim profesional, organizon aktivitete dhe seminare për zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu, si dhe asiston studentët në organizimin e praktikave profesionale dhe lidhjen me partnerët institucionalë dhe bizneset.<br>Gjithashtu, këto njësi bashkëpunojnë ngushtë me Departamentin e Inxhinierisë Software dhe strukturat akademike për të siguruar informacion të përditësuar mbi ndryshimet në kurrikulë, kalendarin akademik, procedurat e vlerësimit dhe diplomimit, si dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të shpejtë dhe transparente nevojave dhe shqetësimeve të studentëve.<br>Përmes këtij sistemi të organizuar dhe funksional, institucioni garanton që çdo student të ketë qasje të lehtë, të drejtë dhe të plotë në informacionin dhe shërbimet që lidhen me procesin mësimor dhe të tjera aspekte të jetës |

548 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
549 35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
550 35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve
551 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU
552 2.Statuti TBU
553 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
554 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

| | |
|---|---|
| | akademike, duke respektuar plotësisht normat ligjore dhe rregulloret institucionale.[555] |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | TBU ka ngritur dhe bërë funksional një sistem të posaçëm dhe të strukturuar për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit akademik dhe asistimin e studentëve në të gjitha çështjet që lidhen me procesin mësimor dhe programin e studimit. Ky sistem operohet nëpërmjet njësive të dedikuara, si Zyra e Çështjeve Studentore dhe Zyra e Këshillimit Akademik, të cilat punojnë në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik dhe strukturat menaxhuese të institucionit.[556] Në kuadër të këtij sistemi, Këshilltarët Akademikë luajnë një rol kyç në orientimin e studentëve, duke ofruar këshilla të personalizuara për zgjedhjen e lëndëve, planifikimin e orarit dhe monitorimin e përparimit në studime. Për këtë qëllim, është përgatitur dhe zbatuar një dokument i veçantë, Plani i Këshilltarit Akademik, i cili përcakton qartë rolet, përgjegjësitë dhe procedurat që ndjek këshilltari gjatë bashkëpunimit me studentët. Ky plan siguron që çdo student të marrë mbështetje të vazhdueshme dhe të koordinuar gjatë gjithë periudhës së studimeve.[557] [558] [559]<br>Përveç kësaj, sistemi përfshin edhe instrumente për ndjekjen e përparimit akademik, ku regjistrohen dhe monitorohen rezultatet e studentëve, duke mundësuar ndërhyrje të hershme në rast të vështirësive ose vonesave në procesin studimor. Kjo ndihmon në rritjen e efikasitetit të studimeve dhe uljen e nivelit të braktisjes.[560]<br>Gjithashtu, studentët përfitojnë asistencë të plotë lidhur me të gjitha aspektet administrative dhe akademike që lidhen me programin e studimit, duke përfshirë informimin mbi ndryshimet në kurrikulë, kriteret e vlerësimit, procedurat e provimeve, diplomimit dhe mundësitë për zhvillim akademik e profesional.<br>Ky sistem i organizuar dhe funksional garanton një përvojë të integruar dhe mbështetëse për studentët, duke siguruar përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe standardet më të mira të menaxhimit të arsimit të lartë.[561] |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | TBU ka ngritur dhe e ka bërë plotësisht funksionale Zyrën e Këshillimit të Karrierës, e cila ofron shërbime të specializuara për studentët në drejtim të orientimit profesional, përgatitjes për tregun e punës dhe ndërlidhjes së procesit akademik me zhvillimin e karrierës.[562] Kjo zyrë është një njësi e dedikuar që bashkëpunon ngushtë me fakultetet, stafin akademik dhe partnerët institucionalë për të siguruar që studentët të marrin mbështetje të vazhdueshme dhe të personalizuar gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe më tej. [563] Shërbimet e këshillimit të karrierës ofrohen në mënyrë të rregullt, si me anë të takimeve individuale ashtu edhe përmes aktiviteteve të strukturuara si workshop-e, trajnime, ditë informuese dhe panaire pune. Studentët informohen dhe këshillohen lidhur me mundësitë për praktikë profesionale në institucionet publike dhe private, si dhe për hapat që duhet të ndjekin për të integruar njohuritë akademike në përvoja konkrete të tregut të punës. Zyra ofron gjithashtu |

[555] 31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)
[556] 14.7 Rrregullore e Këshillimit Akademik
[557] 14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI
[558] 12.1.Kalendari Akademik 2023-2024
[559] 12.2.Kalendari Akademik 2024-2025
[560] 32. Rrregullore per sekretarine mesimore
[561] 35.7. Shembuli_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
[562] 3.1. Strategjia e Zhvillimit TBU 2024-2029
[563] 14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

| | |
|---|---|
| | udhëzime mbi përgatitjen e CV-së, letrës së motivimit, zhvillimin e intervistave për punë dhe ndërtimin e një plani afatgjatë të karrierës. Në bashkëpunim me strukturat e brendshme dhe jashtme, Zyra e Karrierës nxit lidhjen e studentëve me biznese, organizata dhe institucione partnere, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e praktikave profesionale si pjesë përbërëse e programeve të studimit.[564] [565]Gjithashtu, studentët orientohen për mundësitë e mëtejshme të studimeve apo punësimit, brenda dhe jashtë vendit. Ky mekanizëm i organizuar dhe funksional siguron një qasje të integruar midis formimit akademik dhe zhvillimit profesional të studentëve, duke përmbushur standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për këshillimin e karrierës dhe duke kontribuar në rritjen e punësueshmërisë së tyre pas përfundimit të studimeve.[566] |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | TBU nëpërmjet Zyrës së Karrierës, ka ngritur një mekanizëm të strukturuar për ndjekjen e studentëve pas diplomimit, duke siguruar mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre.[567] Kjo zyrë luan një rol kyç në sigurimin e informacionit të besueshëm dhe të azhurnuar, i cili përdoret si bazë për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit dhe përshtatshmërisë së tyre me nevojat e tregut të punës. Procesi i ndjekjes së të diplomuarve realizohet përmes instrumenteve të ndryshme, si pyetësorë të strukturuar, intervista periodike, platforma elektronike të dedikuara dhe bashkëpunim me rrjetet e alumnive.[568] [569] [570]Të dhënat e mbledhura përfshijnë informacion mbi kohëzgjatjen e tranzicionit drejt punësimit pas diplomimit, fushat ku punësohen ish-studentët, lidhjen midis profilit të studimit dhe vendit të punës, si dhe nivelin e kënaqësisë së tyre me përgatitjen e marrë gjatë studimeve. Këto të dhëna përpunohen dhe analizohen nga Zyra e Karrierës, e cila harton raporte vjetore dhe i vë në dispozicion strukturave drejtuese të institucionit, me qëllim informimin, planifikimin strategjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ofertës akademike. [571] Po ashtu, ky informacion u ofrohet edhe studentëve aktualë dhe potencialë, për t'i ndihmuar ata në procesin e orientimit profesional dhe marrjen e vendimeve të informuara për rrugën e tyre të karrierës. Përmes këtij funksioni të mirëorganizuar, institucioni siguron jo vetëm një lidhje të qëndrueshme me të diplomuarit, por edhe një pasqyrë të qartë mbi impaktin e programeve të studimit në përgatitjen e burimeve njerëzore për tregun e punës, duke plotësuar në mënyrë të plotë kriterin e kërkuar.[572] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

[564] 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI

[565] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)

[566] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS

[567] Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23)

[568] 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25

[569] 35.1.1. Rregullore NJSBC

[570] 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025

[571] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24

[572] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

# VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi VI.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Tirana Business University është një institucion i arsimit të lartë privat që është riorganizuar në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", duke përcaktuar qartë statusin, emrin, strukturën dhe funksionimin e tij si "Kolegj Universitar".[573]<br>Institucioni ka ngritur struktura të brendshme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike[574], si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NSBC), e cila:[575]<br>• Vlerëson në mënyrë periodike cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;<br>• Zbaton pyetësorë studentorë për çdo lëndë në fund të semestrit për të vlerësuar procesin mësimor;<br>• Realizon studime për ndjekjen e punësimit të studentëve dhe efektivitetin e programeve të studimit. |

[573] 2.Statuti TBU
[574] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale
[575] 35.1.1. Rregullore NJSBC

| | |
|---|---|
| | Përveç kësaj, funksionojnë Komisione të përhershme, përfshirë Komisionin e Cilësisë dhe atë të Marrëdhënieve me Studentët, që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së programeve dhe përshtatjen e mësimdhënies sipas nevojave të studentëve.<br>Këshilli i Etikës mbikëqyr respektimin e parimeve morale dhe etike në procesin mësimor dhe kërkimor. TBU bashkëpunon me autoritetet për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe ndjek proceset e akreditimit kombëtar e ndërkombëtar, në përputhje me kërkesat ligjore dhe Kodin e Cilësisë të arsimit të lartë. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | Në TBU janë ngritur dhe funksionojnë struktura të dedikuara për sigurimin e cilësisë dhe monitorimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) dhe Komisioni i Cilësisë, në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e departamenteve, zbatojnë mekanizma sistematikë për vlerësimin periodik të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.[576][577][578]<br>Procesi i monitorimit dhe vlerësimit përfshin:[579] [580]<br>• Pyetësorë studentorë të strukturuar, që zhvillohen në fund të çdo semestri për të mbledhur të dhëna mbi cilësinë e mësimdhënies, përdorimin e metodave bashkëkohore dhe përfshirjen e teknologjisë në procesin mësimor.[581]<br>• Vlerësime të drejtpërdrejta nga drejtuesit e departamenteve, të cilët monitorojnë zhvillimin e lëndëve, përgatitjen pedagogjike, angazhimin në auditore dhe inovacionin në qasjen mësimore të stafit. Këto vlerësime realizohen në mënyrë të dokumentuar dhe diskutohen në mbledhje të brendshme periodike.[582]<br>• Analizë e performancës akademike dhe kërkimore, në përputhje me standardet shtetërore dhe objektivat institucionale.[583] [584]<br>• Identifikim i nevojave për trajnime apo mbështetje të mëtejshme për zhvillimin profesional të stafit, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.<br>Të gjitha të dhënat e mbledhura nga NSBC, komisionet dhe drejtuesit e departamenteve i paraqiten Senatit Akademik dhe organeve të tjera përkatëse, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve të informuara për zhvillimin dhe menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore në institucion.<br>Ky proces gjithëpërfshirës vlerësimi siguron monitorim të vazhdueshëm dhe mbështet nxitjen e praktikave inovative në mësimdhënie, në përputhje me misionin dhe strategjinë institucionale të TBU.[585] [586] |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në | TBU garanton përfshirjen aktive dhe sistematike të studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe të mënyrës së |

[576] 35.1. 1. Rregullore NJSBC
[577] 35.1.2. Politika per Sigurimin e Cilesise
[578] 35.1.3.Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise
[579] 35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve
[580] 35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
[581] 35.9.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[582] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[583] 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
[584] 41.Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[585] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[586] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024

| | |
|---|---|
| vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | vlerësimit të dijeve, duke u bazuar në një sërë mekanizmash institucionalë të formalizuar.[587] [588]<br>Studentët përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në:<br>• Procesin e vlerësimit periodik të mësimdhënies, përmes pyetësorëve studentorë të strukturuar, të cilët zhvillohen në fund të çdo semestri për të gjitha lëndët. Pyetësorët adresojnë aspekte të rëndësishme si qartësia e ligjërimit, përdorimi i metodave të ndryshme didaktike, ndihmesa e pedagogut, mënyra e vlerësimit dhe ngarkesa akademike. Analizat e rezultateve përpunohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në të cilën studentët janë përfaqësuar si anëtarë, duke kontribuar në diskutimet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë.[589]<br>• Strukturat përfaqësuese si Këshilli Studentor, që luan një rol aktiv në identifikimin dhe adresimin e problematikave të lidhura me përvojën akademike dhe metodologjinë e mësimdhënies. Këshilli Studentor përçon opinione dhe propozime nga studentët në instancat përkatëse, si Senati Akademik apo drejtuesit institucionalë.[590]<br>• Mbledhjet e departamenteve, ku studentët marrin pjesë si përfaqësues dhe kanë mundësinë të japin kontributin e tyre mbi çështje që lidhen me përmbajtjen e kurrikulave, formën e zhvillimit të mësimit dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive.<br>• Komisionet e përhershme institucionale, si Komisioni i Cilësisë dhe Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët, në përbërjen e të cilëve janë të përfshirë edhe studentë, sipas përqindjes së përcaktuar nga Ligji për Arsimin e Lartë. Përmes këtyre komisioneve, studentët kontribuojnë në vlerësimin e performancës akademike dhe në përmirësimin e përvojës studentore.<br>• Trajtimin e ankimimeve dhe shqetësimeve, që rregullohet me akte të brendshme të institucionit. Studentët kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre në lidhje me mënyrën e mësimdhënies apo të vlerësimit pranë departamentit, dekanatit apo Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët. Këto ankesa shqyrtohen në mënyrë të strukturuar dhe të dokumentuar.<br>Nëpërmjet këtyre formave të përfshirjes, TBU siguron që vlerësimi i mësimdhënies dhe metodave të vlerësimit të dijeve të mos jetë vetëm një proces formal, por një pjesë integrale e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe angazhimit institucional me studentët si partnerë aktivë në procesin e edukimit.[591] |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | TBU në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Cilësisë, ka krijuar dhe funksionalizuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila ka për detyrë të vlerësojë dhe të monitorojë periodikisht procesin e mësimdhënies dhe shërbimet akademike.[592] Në kuadër të këtij procesi, për çdo semestër, NJSBC organizon pyetësorë studentorë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha programet e studimit. Të dhënat e |

587 35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet

588 35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve

589 35.1.1. Rregullore NJSBC

590 59. Rregullore e Këshillit Studentor

591 35.9.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët

592 35.1.1. Rregullore NJSBC

| | |
|---|---|
| | mbledhura analizohen dhe përpunohen në një raport vlerësimi, që përfshin indikatorë të matshëm mbi performancën e stafit akademik, infrastrukturën mësimore dhe përmbushjen e pritshmërive të studentëve.<br>Rezultatet e këtij raporti i komunikohen organeve drejtuese të TBU dhe bëhen të aksesueshme për stafin. [593] [594]Ky mekanizëm jo vetëm që plotëson një kërkesë ligjore, por kontribuon realisht në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe përfshirjen aktive të studentëve në këtë proces. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | TBU nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe strukturave të tjera përkatëse, ka ngritur një sistem funksional dhe të vazhdueshëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi cilësinë e mësimdhënies. [595] [596]Pyetësorët e studentëve dhe vlerësimet e brendshme nga drejtuesit e departamenteve përbëjnë mekanizmat kryesorë që ndihmojnë në identifikimin e praktikave efektive të mësimdhënies dhe të elementëve që kanë nevojë për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve analizohen në takimet e rregullta të departamenteve dhe senatit akademik, ku evidentohen shembuj konkretë të performancës së lartë nga ana e stafit akademik. Këta shembuj promovohen si praktika të mira dhe ndahen me personelin përmes aktiviteteve të përbashkëta, trajnimeve të brendshme, diskutimeve akademike dhe mentoring-ut ndërkolegjial. Ky cikël i vazhdueshëm i vlerësimit, analizës, reagimit dhe promovimit të praktikave të mira është i institucionalizuar në TBU dhe shërben si një instrument i fuqishëm për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të stafit. Në këtë mënyrë, institucioni arrin të adresojë në kohë problematikat, të ndërtojë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të nxisë përsosmërinë akademike në të gjitha nivelet.[597] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Tirana Business University (TBU) ka ngritur dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta dhe të qëndrueshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. [598] [599]Në përputhje me Statutin dhe rregulloret e veta, TBU ka krijuar mekanizma të specializuar për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe administrative. Struktura të dedikuara brenda TBU, si komisionet për cilësinë dhe njësitë përkatëse në fakultete dhe departamente, garantojnë |

[593] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[594] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[595] 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
[596] 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25
[597] 35.1.1. Rregullore NJSBC
[598] 61.Ligj_80-2015_22.07.2015
[599] 3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23

| | |
|---|---|
| | zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave të SBC. [600] [601] Këto politika janë të koordinuara dhe harmonizuar me kërkesat ligjore kombëtare, duke siguruar një mjedis akademik transparent, përgjegjës dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve arsimore që TBU ofron.[602] [603] |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | TBU ka ngritur dhe zbatuar politika, struktura dhe procedura të qarta dhe të qëndrueshme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi. Në përputhje me Statutin dhe rregulloret e veta[604] [605] [606], TBU ka krijuar mekanizma të specializuar për menaxhimin dhe monitorimin e cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe administrative. Struktura të dedikuara brenda TBU, si komisionet për cilësinë dhe njësitë përkatëse në fakultete dhe departamente, garantojnë zbatimin efektiv të politikave dhe procedurave të SBC[607]. Këto politika janë të koordinuara dhe harmonizuar me kërkesat ligjore kombëtare, duke siguruar një mjedis akademik transparent, përgjegjës dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve arsimore që TBU ofron.[608] [609] |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | TBU përdor një sërë instrumentesh dhe treguesish të standardizuar për të siguruar cilësinë në të gjitha aspektet e veprimtarisë akademike dhe administrative. Institucioni mbështetet në tregues sasiorë dhe cilësorë që lidhen me performancën e stafit akademik, rezultatet e të nxënit të studentëve, efikasitetin e mësimdhënies, përmbushjen e objektivave të programeve të studimit dhe kënaqësinë e studentëve. TBU zhvillon në mënyrë periodike sondazhe, analiza dhe raporte të brendshme vlerësimi, të cilat shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.[610] [611] [612]<br>Për më tepër, TBU është i angazhuar në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë, duke marrë pjesë në vlerësime të jashtme të akreditimit nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si dhe duke analizuar gjetjet dhe rekomandimet përkatëse me qëllim përmirësimin institucional dhe të programeve të studimit.[613] [614] [615] Gjithashtu, TBU realizon vlerësime krahasuese dhe analitike në raport me institucionet homologe, duke nxitur konkurrueshmërinë dhe përshtatjen me praktikat më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Këto procese e vendosin cilësinë në qendër të veprimtarisë |

[600] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[601] 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
[602] 3.2.1. Strategjia e Kerkimit Shkencor 18-23
[603] 37.1. Politika për Zhvillimin Profesional të Stafit Akademik
[604] 2.Statuti TBU
[605] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale
[606] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[607] 35.1.1. Rregullore NJSBC
[608] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[609] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[610] 54.1. Raporti Vjetor institucional 2021-2022
[611] 54.2. Raporti Vjetor institicional 2022-2023
[612] 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
[613] 52. Shkresa për akreditimin e programeve MShIS në ASCAL
[614] 43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023)
[615] 43.1. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024)

| | |
|---|---|
| | akademike të universitetit dhe ndihmojnë në përmbushjen e misionit të tij edukativ.[616 617] |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | Tirana Business University ka të përcaktuara qartë në aktet e veta rregullatore mekanizmat dhe treguesit e matshëm për të vlerësuar cilësinë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor. [618 619]Këta tregues përfshijnë, ndër të tjera, normat e kalueshmërisë, vlerësimet e studentëve për lëndët dhe pedagogët, rezultatet në provime, publikimet shkencore të stafit akademik, pjesëmarrjen në konferenca dhe projektet kërkimore. Analiza periodike e këtyre treguesve realizohet në nivel departamenti dhe fakulteti, dhe shërben si bazë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit.[620 621 622]<br>TBU i përdor këto të dhëna për të identifikuar arritjet, problematikat dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje, duke mundësuar një reagim të shpejtë dhe efektiv në drejtim të sigurimit të cilësisë. Për më tepër, institucioni zbaton politika promovuese për stafin akademik dhe studentët që arrijnë rezultate të larta, përmes vlerësimeve morale dhe profesionale, përfshirjes në projekte të brendshme apo ndërkombëtare, si dhe mundësive për avancim në karrierë. Këto mekanizma nxitin cilësinë, konkurueshmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm për përmirësim në të gjitha nivelet e programit të studimit.[623 624] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, | TBU zbaton një proces të rregullt, të formalizuar dhe të dokumentuar për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programeve të studimit të ciklit të dytë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe udhëzimet përkatëse të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Ky proces siguron që programet të jenë në përputhje me zhvillimet akademike dhe shkencore, të adresojnë nevojat e tregut të punës dhe të ruajnë standarde të larta akademike dhe profesionale.[625 626]<br>Procesi i rishikimit dhe miratimit fillon në nivel departamenti, ku zhvillohen analiza periodike mbi përmbajtjen, rezultatet dhe ecurinë e programeve të studimit. Vlerësimi mbështetet në të dhëna të brendshme, si analiza e |

616 66.VKM Nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"
617 64. Urdhër MAS Nr. 326,dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve
618 Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21)
619 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23)
620 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
621 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
622 37.1.1. Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin_studentët
623 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
624 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
625 2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike
626 2.1.3. Vendim SA Nr. 51dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195 ,196 MAS

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| dhe planin e masave për përmirësim.<br>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | përformancës së studentëve, vlerësimi i mësimdhënies, sugjerime të dala nga vlerësimet e brendshme të cilësisë, si dhe feedback nga studentët, stafi akademik dhe aktorët e jashtëm, përfshirë përfaqësues të tregut të punës. Propozimet për përmirësim apo ndryshim hartohen nga grupet përkatëse akademike dhe paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit.[627] [628] [629]<br>Pas shqyrtimit dhe diskutimit në Këshillin e Fakultetit, propozimet kalojnë për miratim në Senatin Akademik, i cili garanton integritetin akademik dhe përputhjen me strategjinë institucionale të zhvillimit. Këto hapa përbëjnë një cikël të qartë vendimmarrjeje dhe reflektimi, që e bën të mundur rishikimin e vazhdueshëm të programeve për të siguruar cilësinë dhe relevancën e tyre në kohë.[630]<br>Gjithashtu, çdo program i ciklit të dytë i nënshtrohet mbikëqyrjes së vazhdueshme, përmes mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe përmes raportimeve të rregullta dhe analizave institucionale. [631] Këto përfshijnë monitorimin e indikatorëve të performancës, si dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave të të nxënit dhe standardeve të programit. Programet rishikohen jo vetëm në aspektin përmbajtësor, por edhe në strukturën, metodologjinë mësimore dhe format e vlerësimit. Përmes këtij procesi të qartë, gjithëpërfshirës dhe të mirëstrukturuar, TBU siguron që të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë të jenë objekt i një mbikëqyrjeje akademike të qëndrueshme dhe të mirëkoordinuar. [632] |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Raportet e vlerësimit përmbajnë në mënyrë të detajuar rezultatet e pritshme dhe ato të arritura nga programet akademike, duke ofruar një analizë të plotë dhe të strukturuar të performancës së tyre. Në këto raporte shpjegohet motivimi pas praktikave më të mira dhe arritjeve të evidentuara në mësim dhe kërkim nga stafi akademik dhe studentët, duke nxjerrë në pah faktorët kryesorë që kanë kontribuar në suksesin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.[633] [634] [635]Përveç vlerësimit të rezultateve pozitive, raportet identifikojnë qartë mangësitë ekzistuese dhe përshkruajnë masat konkrete dhe efektive që janë ndërmarrë për të adresuar këto dobësi, duke siguruar një qasje sistematike dhe të qëndrueshme për ngritjen e cilësisë. [636]Masat përfshijnë riorganizimin e përmbajtjes dhe metodologjive mësimore, përmirësimin e infrastrukturës dhe burimeve, si dhe rritjen e mbështetjes për studentët dhe personelin akademik nëpërmjet trajnimeve dhe iniciativave motivuese. Gjithashtu, raportet promovojnë krijimin e një mjedisi stimulues ku arritjet akademike dhe kërkimore nxisin përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve, duke kontribuar kështu në forcimin e kulturës së cilësisë dhe standardeve të larta arsimore dhe shkencore.[637] |

[627] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)
[628] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[629] 7. Rregullore e Departamentit të Inxhinierisë Software (FTI)
[630] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[631] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[632] 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
[633] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[634] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[635] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[636] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[637] 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | [638] Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që përmirësimet të jenë të qëndrueshme dhe të pasqyrojnë nevojat reale të programit dhe komunitetit akademik. [639 640] |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, TBU përdor një qasje të shumëanshme dhe të strukturuar përmes metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit. Një ndër mekanizmat kryesorë është mbledhja sistematike e feedback-ut nga studentët përmes pyetësorëve të detajuar për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, të cilët analizohen për të identifikuar pikat e forta dhe fushat për përmirësim në performancën akademike të stafit.[641] Krahas kësaj, vlerësohet didaktika e përdorur nga pedagogët dhe përmbajtja e kurrikulës në raport me objektivat e programit dhe nevojat e tregut të punës. Vlerësimi i të nxënit realizohet nëpërmjet analizës së detyrave, provimeve dhe projekteve të studentëve, duke mundësuar edhe krahasime paralele ndërmjet grupeve ose moduleve të ndryshme për të garantuar barazi në vlerësim dhe koherencë metodologjike.[642 643 644]<br>Gjithashtu, zhvillohen vëzhgime në auditor për të monitoruar mënyrën e realizimit të orëve të mësimit dhe për të vlerësuar interaktivitetin, zbatimin e metodave moderne didaktike, si dhe për të siguruar që orët praktike dhe ushtrimet të përmbushin objektivat mësimore.[645] Institucioni aplikon gjithashtu testime të brendshme dhe të standardizuara për të matur progresin e studentëve dhe për të ndjekur rezultatet akademike në mënyrë të vazhdueshme. Në rastet kur programi i studimit përgatit profesionistë për fusha të rregulluara, analizohen rezultatet në provimet kombëtare apo të licencimit, si një tregues objektiv i përgatitjes dhe përmbushjes së standardeve të jashtme të cilësisë.[646]<br>Të gjitha të dhënat e mbledhura nga këto instrumente përpunohen dhe analizohen nga strukturat e brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat hartojnë raporte periodike vlerësimi. Këto raporte përfshijnë rezultatet e arritura, evidentimin e praktikave të suksesshme, si dhe masa konkrete për adresimin e mangësive të identifikuara, duke u shoqëruar me rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor.[647 648 649 650 651] Kjo qasje gjithëpërfshirëse dëshmon përkushtimin e TBU ndaj standardeve të larta akademike dhe ndërtimit të një kulture të qëndrueshme cilësie.[652] |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e | Për të vlerësuar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programit të studimit, TBU zbaton metoda dhe instrumente të tërthorta që sigurojnë një pasqyrë të |

[638] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[639] 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
[640] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[641] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[642] 22. Formati i Syllabusit (shqipanglisht) – VKM 412018
[643] 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[644] 11. Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës
[645] 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
[646] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[647] 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
[648] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[649] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[650] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[651] 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
[652] Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Aneks Tabela 21)

| | |
|---|---|
| instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | gjithanshme mbi ecurinë dhe ndikimin e programit. [653] [654] [655] Këto përfshijnë realizimin periodik të sondazheve dhe intervistave me studentët aktualë, të diplomuarit (alumni), si dhe me personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ. Informacioni i mbledhur nga këto burime shërben për të identifikuar perceptimin mbi cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e kurrikulës dhe mbështetjen institucionale.<br>Gjithashtu, institucioni bashkëpunon ngushtë me punëdhënës [656] [657]dhe partnerë institucionalë të angazhuar në realizimin e praktikave profesionale apo të projekteve të përbashkëta, duke marrë prej tyre feedback për nivelin e përgatitjes dhe kompetencave që studentët e diplomuar tregojnë në mjediset reale të punës. [658] [659]Kjo qasje mundëson vlerësimin e drejtpërdrejtë të aplikueshmërisë së dijes dhe aftësive të përftuara përmes programit. Të gjitha këto të dhëna analizohen nga strukturat përgjegjëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe përfshihen në raportet përkatëse të vlerësimit, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe përafrimin e tij me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet akademike bashkëkohore.[660] [661] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Në përputhje me misionin dhe objektivat e tij strategjike TBU ka ngritur një sistem të konsoliduar të sigurimit të brendshëm të cilësisë që garanton përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të interesuar, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm, në mënyrë të strukturuar dhe të dokumentuar.<br>Politikat dhe procedurat institucionale të cilësisë janë të detajuara në një sërë rregulloresh përkatëse. Këto dokumente përcaktojnë qartë funksionimin e strukturave vendimmarrëse dhe këshillimore, si dhe rolin e aktorëve të ndryshëm në procesin e SBC.[662]<br>Përfshirja e aktorëve të brendshëm realizohet nëpërmjet strukturave si Komisioni i Cilësisë në Fakultet, Departamenti, Koordinatori i programit, Këshilli Studentor, si dhe përmes aktiviteteve si Fokus Grupet dhe pyetësorët vlerësues për studentët dhe stafin akademik. Këto struktura dhe mekanizma sigurojnë marrjen e feedback-ut dhe angazhimin konkret në analizën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit. |

[653] 35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve
[654] 35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet
[655] 35.9.Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët
[656] 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
[657] 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi( Aneks Tabela 5)
[658] 19. Studimi i tregut të punës
[659] 14.5. Ditët informuese në TBU
[660] Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Aneks Tabela 23)
[661] 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
[662] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

| | |
|---|---|
| | Nga ana tjetër, përfshirja e aktorëve të jashtëm garantohet përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me tregun e punës, institucione partnere dhe ekspertë të fushës, të cilët kontribuojnë në hartimin dhe rishikimin e kurrikulës, në aktivitete të përbashkëta, si dhe në procesin e praktikave profesionale. Për këtë qëllim, TBU ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe biznese të rëndësishme, dhe ka ngritur struktura si Bordi i Tregut të Punës, i cili jep sugjerime për zhvillimin e mëtejshëm të programit. [663] [664]Gjithashtu, dokumente si Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU dhe Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies, institucionalizojnë përfshirjen dhe kontributin e aktorëve në të gjitha etapat e jetës së programit të studimit – nga planifikimi dhe zbatimi deri te vlerësimi dhe rishikimi periodik.[665] [666]<br>Përfshirja e studentëve është e garantuar përmes rregullores së Këshillit Studentor dhe pjesëmarrjes së tyre në komisione dhe fokus grupe, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të ndikojë në vendimmarrje.<br>Në përfundim, institucioni demonstron një angazhim të qartë dhe të dokumentuar për përfshirjen e të gjithë aktorëve relevantë, duke e bërë këtë proces pjesë të natyrshme të kulturës institucionale të cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të programit të studimit MSh "Inxhinieri Software".[667] [668] |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Sigurimi i cilësisë në programin e studimit MSh në Inxhinieri Software është një proces i strukturuar, ku çdo njësi dhe aktori përfshirë ka përgjegjësi të qarta dhe rol aktiv në zbatimin e tij. Institucioni ka ndërtuar një kulturë të brendshme bashkëpunimi dhe përgjegjshmërie, ku stafi akademik dhe administrativ, studentët, si dhe përfaqësues të jashtëm kontribuojnë në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin cilësor të programit. Detyrat dhe përgjegjësitë nuk mbeten vetëm në nivel formal, por zbatohen në praktikë përmes mekanizmave të koordinimit, vlerësimit dhe reflektimit të përbashkët. Ky angazhim i përbashkët siguron që çdo vendimmarrje që ndikon në cilësinë e programit të bazohet në analiza të mirëfillta dhe të reflektojë interesin e të gjitha palëve të përfshira, duke nxitur kështu zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e vazhduar të tij. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) luan një rol thelbësor në këtë proces. Ajo ka funksionin mbikëqyrës dhe koordinues për zbatimin e standardeve të cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor dhe objektivat institucionale. NJSBC monitoron dhe vlerëson vazhdimisht veprimtaritë mësimore, kërkimore dhe administrative, duke analizuar të dhënat, rekomandimet dhe ecurinë e realizimit të detyrave që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e programit. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamenteve, NJSBC siguron që çdo aktor të jetë i informuar, i përfshirë dhe i mbështetur në përmbushjen e rolit të tij. [669] [670]Për më tepër, NJSBC inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe palëve të jashtme në procesin e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë, duke përfshirë instrumente të tilla si vlerësimet e rregullta të kënaqshmërisë, konsultimet me alumnit dhe bashkëpunimin me sektorin e industrisë. Ky bashkëveprim i organizuar në mënyrë sistematike krijon |

[663] 33. Projektet e fituara nga TBU-Projekte ku eshte perfshire FTI
[664] 33.. Projektet e fituara tek AKKSHI
[665] 15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU
[666] 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
[667] 9. Rregullore e programit të studimit MSh Inxhinieri Software (shqip)
[668] 6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit
[669] 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
[670] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | një mekanizëm efikas për reflektimin dhe ndërhyrjen në kohë mbi nevojat për përmirësim, duke garantuar që standardet e cilësisë jo vetëm të plotësohen, por edhe të tejkalohen në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të programit.[671] [672] |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Sigurimi i cilësisë së programit të studimit MSh në Inxhinieri Software është e garantuar përmes një strukture të qartë organizative dhe një kulture bashkëpunimi ndër-njësish. Njësia bazë dhe ajo kryesore, përgjegjëse për programin, janë të angazhuara në mënyrë të vazhdueshme në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e programit, duke koordinuar proceset e sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me të gjithë aktorët relevantë. [673] [674] [675]Stafi akademik kontribuon nëpërmjet hartimit të syllabuseve, përshtatjes së përmbajtjeve me zhvillimet shkencore dhe kërkesat e tregut të punës, si dhe përmes vlerësimit të vazhdueshëm të rezultateve të të nxënit. Personeli ndihmësakademik dhe administrativ siguron funksionimin teknik, logjistik dhe mbështetës të procesit mësimor dhe vlerësues. Studentët marrin pjesë në mënyrë aktive përmes vlerësimeve periodike të cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve, përfaqësimit në struktura këshillimore dhe kontributeve në diskutimet për përmirësimin e programit. Kjo përfshirje shumëpalëshe nuk është vetëm formale, por përfaqëson një angazhim konkret dhe të strukturuar në funksion të rritjes së cilësisë.[676] [677]Proceset e reflektimit, komunikimit dhe vendimmarrjes përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme në sajë të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të këtyre aktorëve, duke siguruar që zhvillimi i programit të bazohet në nevoja reale, praktika të mira dhe standarde akademike të qëndrueshme.[678] [679] |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | TBU garanton që përfshirja e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit të programit të studimit të realizohet në përputhje të plotë me parimet e integritetit akademik dhe barazisë. Pjesëmarrja e stafit akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentëve organizohet në mënyrë të strukturuar, ku të gjithë kanë të drejtën dhe mundësinë të shprehin lirshëm opinionet, vlerësimet dhe sugjerimet e tyre, pa u ndjerë të paragjykuar apo të përjashtuar.[680] [681] [682]Kultura institucionale është ndërtuar mbi vlerat e respektit të ndërsjellë dhe profesionalizmit, duke shmangur çdo formë diskriminimi apo trajtimi të pabarabartë. Proceset vlerësuese zhvillohen në mënyrë transparente dhe të paanshme, duke u mbështetur në kritere objektive dhe duke garantuar që çdo zë të dëgjohet e çdo kontribut të merret parasysh në mënyrë të barabartë.[683] [684] [685] [686]Kështu, TBU jo vetëm që përmbush detyrimet e tij për sigurimin e |

[671] 13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit
[672] 8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore
[673] 53.1. Plani vjetor i DIS 2023-2024
[674] 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
[675] 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25
[676] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[677] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[678] 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
[679] 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
[680] 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
[681] 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale
[682] 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU
[683] 18. Kodi i Etikës
[684] 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
[685] 35.1.1. Rregullore NJSBC
[686] 59. Rregullore e Këshillit Studentor

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| | cilësisë, por gjithashtu ndërton një ambient të shëndetshëm akademik, ku pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse dhe besimi në proceset e brendshme të vlerësimit forcohet vazhdimisht.[687] |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | TBU siguron përfshirjen aktive të bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet mekanizmave të strukturuar dhe të institucionalizuar. Një nga format kryesore të këtij angazhimi është organizimi i takimeve periodike me Bordin e Tregut të Punës, i cili përbëhet nga përfaqësues të bizneseve, institucioneve partnere, organizatave profesionale dhe ekspertë të fushës përkatëse.[688] [689] [690]<br>Këto takime shërbejnë si platforma bashkëpunimi për të analizuar zhvillimet në tregun e punës, për të diskutuar përputhshmërinë e programit me nevojat reale të sektorëve profesionalë, si dhe për të marrë sugjerime konkrete për përmirësimin e përmbajtjes, metodave të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit. Përveç takimeve me Bordin, institucioni organizon gjithashtu diskutime tematike, tryeza të rrumbullakëta dhe aktivitete vlerësimi me pjesëmarrjen e ekspertëve të jashtëm, të cilët kontribuojnë me vlerësime të pavarura dhe objektive mbi aspektet cilësore të programit.[691] [692] [693] [694] [695] Kjo përfshirje siguron që procesi i vlerësimit të jetë gjithëpërfshirës, i balancuar dhe në përputhje me standardet më të mira të arsimit të lartë, duke ndihmuar në përshtatjen dinamike të programit me kërkesat e kohës dhe në rritjen e cilësisë akademike e profesionale.[696] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Programi i studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Software demonstron angazhim të vazhdueshëm për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe transparent të sigurimit të brendshëm të cilësisë. TBU siguron që politikat, strategjitë dhe struktura organizative për sigurimin e cilësisë të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për studentët dhe të gjithë aktorët e |

687 55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies
688 14.1. Vendim dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI
689 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP - 28.05.2024
690 14.1.1. Axhenda e takimit me BTP 2023-2024
691 14.2. Ftese per panair
692 36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh IS
693 36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)
694 33. Projektet e fituara nga TBU-Projekte ku eshte perfshire FTI
695 33.. Projektet e fituara tek AKKSHI
696 36.4. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

| | |
|---|---|
| | interesuar. [697] [698] [699] Që nga informimi i studentëve mbi mënyrën e funksionimit të programit dhe cilësinë e procesit mësimor, deri te përfshirja e tyre në proceset vlerësuese dhe përmirësuese, të gjitha veprimtaritë zhvillohen në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Organizimi i sistemit të cilësisë bazohet në parime të transparencës, pjesëmarrjes dhe përgjegjshmërisë. Studentët dhe stafi kanë mundësi të informohen dhe të kontribuojnë në proceset vendimmarrëse që lidhen me përmirësimin e cilësisë, përmes takimeve të rregullta, vlerësimeve periodike dhe komunikimeve të vazhdueshme institucionale. [700] [701] Gjithashtu, informacioni në lidhje me standardet e cilësisë, praktikat e mësimdhënies, objektivat e programit dhe rezultatet e vlerësimeve të brendshme është i bërë publik në forma të ndryshme, duke siguruar një kulturë të qartë transparence dhe përmirësimi të vazhdueshëm. Në këtë mënyrë, programi Master në Inxhinieri Software reflekton një sistem funksional dhe të konsoliduar sigurimi cilësie, ku politikat dhe veprimtaritë jo vetëm që zbatohen në praktikë, por edhe komunikohen qartë dhe në kohë me të gjithë të interesuarit.[702] [703] |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | Publikimi i rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit realizohet në përputhje me parimet themelore të transparencës, etikës akademike dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke u siguruar që informacioni të jetë i qasshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë aktorët relevantë. Raportet e përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) përmbajnë analiza të detajuara mbi cilësinë akademike dhe zhvillimin e programeve, si dhe informacione sensitive që kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe respektim të plotë të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale. [704] [705] Për shkak të natyrës së ndjeshme të disa të dhënave, shpërndarja e raporteve bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe të segmentuar. Drejtuesit kanë qasje në raportin e plotë për të mundësuar një vlerësim të përgjithshëm dhe vendimmarrje strategjike. Ndërkaq, në nivel departamentesh dhe strukturash të tjera përkatëse diskutohen vetëm pjesët e raporteve që lidhen drejtpërdrejt me fushën e tyre të përgjegjësisë, duke siguruar fokus dhe efikasitet në përmirësimin e cilësisë. [706] Në rastet kur raportet përmbajnë të dhëna veçanërisht të ndjeshme, trajtimi i tyre kryhet në mënyrë konfidenciale në takime individuale mes strukturave drejtuese dhe personave të prekur, duke respektuar profesionalizmin dhe etikën në çdo fazë të procesit.[707] Kjo qasje garanton një balancë të drejtë mes transparencës dhe mbrojtjes së privatësisë, duke siguruar një mjedis akademik ku informacioni përdoret në mënyrë konstruktive për avancimin e cilësisë së programeve të studimit.[708] |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë | Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit trajtohen në mënyrë të detajuar dhe shoqërohen me plane konkrete masash për përmirësimin e të gjitha dobësive dhe mangësive të identifikuara. Të dhënat e mbledhura nga |

697 2.Statuti TBU
698 5. Rregullore e Kolegjit Universitar "TBU"
699 20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale
700 35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025
701 35.4. Plani pune i KC FTI 24-25
702 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
703 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
704 35.10. Raporti i Fokus Grupeve
705 35.5. Raporti Vjetor i NJSBC 23-24
706 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
707 35.6.Raporti vjetor KSC FTI 2023-2024
708 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024

E-mail: info@ascal.al
Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
Web site: www.ascal.al


TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

| | |
|---|---|
| përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | vetëvlerësimet periodike përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për analizën e gjendjes aktuale dhe identifikimin e sfidave që ndikojnë në cilësinë akademike.[709] Procesi i mbledhjes së këtyre të dhënave zhvillohet përmes pyetësorëve të strukturuar dhe të përpunuar me mjete dixhitale, që mundësojnë një analizë të shpejtë dhe të saktë.[710]<br>Rezultatet i bëhen të ditura drejtuesve të institucionit dhe stafit akademik në mënyrë të personalizuar, për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe të fokusuar në zhvillimin individual. Pas analizës së rezultateve, hartohen dhe implementohen masa të ndryshme që synojnë përmirësimin e performancës, si organizimi i trajnimeve dhe seminareve për zhvillimin e aftësive mësimore dhe kërkimore, inkurajimi i pjesëmarrjes në aktivitete shkëmbimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe krijimi i mundësive për zhvillim profesional përmes programeve si Erasmus+. Ky proces i strukturuar dhe i vazhdueshëm ndihmon në ngritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe në zhvillimin e stafit akademik, duke siguruar që çdo dobësi të adresohen me masa të efektshme dhe duke promovuar një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm brenda institucionit.[711][712] |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit, TBU ka ngritur një mekanizëm funksional dhe të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ky mekanizëm përfshin mbledhjen periodike të të dhënave nga studentët, stafi akademik dhe strukturat përgjegjëse, si dhe analizimin e tyre përmes metodave të standardizuara. [713]Veprimtaritë e vlerësimit nuk kufizohen vetëm në identifikimin e problematikave, por përqendrohen në matjen e efektivitetit të ndërhyrjeve të realizuara pas çdo cikli vetëvlerësimi.[714] Raportet analitike të përgatitura nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë shqyrtohen në mënyrë të rregullt nga drejtuesit institucionalë dhe nga strukturat akademike përkatëse, të cilët analizojnë ndikimin e masave të ndërmarra dhe përcaktojnë orientimet për përmirësimet në vijim. [715]Ky proces ndihmon në ndërtimin e një cikli të vazhdueshëm feedback-u dhe përmirësimi, ku çdo veprim shoqërohet me reflektim dhe matje të rezultateve. Falë kësaj qasjeje sistematike, TBU arrin të vlerësojë jo vetëm zbatimin e planeve të masave, por edhe ndikimin real të tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përvojës studentore dhe rezultateve akademike. Kjo praktikë e konsoliduar forcon kulturën e përgjegjshmërisë institucionale dhe garanton që programet e studimit të zhvillohen në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë.[716][717] |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin | TBU demonstron angazhim të qëndrueshëm për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit përmes organizimit të veprimtarive të rregullta informuese dhe ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen aktive të stafit dhe studentëve. [718]Këto veprimtari përfshijnë takime periodike, sesione trajnimi dhe forume diskutimi që adresojnë temat më të rëndësishme të cilësisë në arsimin e |

[709] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[710] 35.11. TBU - Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori – kolegu
[711] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[712] 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[713] 41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik
[714] 39. Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve
[715] 40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS
[716] 53.2. Raporti vjetor i DIS 2023-2024
[717] 54.3. Raporti Vjetor institucional 2023-2024
[718] 59.1. Perfshirja e studenteve ne qeverisjen e TBU

| | |
|---|---|
| afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | lartë, duke i orientuar pjesëmarrësit drejt standardeve bashkëkohore të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik. Aktivitetet organizohen në nivel institucional dhe departamental, duke siguruar përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve dhe krijimin e një kulture bashkëpunimi për cilësinë.[719] [720]Studentët informohen rregullisht mbi të drejtat, detyrimet dhe mënyrat e përfshirjes së tyre në proceset e vlerësimit të programeve, ndërsa stafi akademik angazhohet në diskutime për të analizuar rezultatet e vlerësimeve dhe për të propozuar përmirësime konkrete. [721] [722] [723]Një komponent i rëndësishëm i këtij procesi është përfshirja e studentëve në struktura vendimmarrëse, duke përfshirë Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), Komisionin e Cilësisë (KSC), Senatin Akademik dhe Këshillin Studentor. [724] [725]Kjo përfshirje garanton që zëri i studentëve të dëgjohet dhe të merret në konsideratë në çdo hap të hartimit dhe zbatimit të politikave për cilësinë. Studentët kontribuojnë me perspektivat dhe përvojat e tyre të drejtpërdrejta, duke ndihmuar në identifikimin e problematikave dhe në propozimin e masave për përmirësim.[726] [727]<br>Kjo qasje gjithëpërfshirëse e bën procesin e sigurimit të cilësisë më transparent, më funksional dhe më të qëndrueshëm, duke e kthyer atë në një proces bashkëpunues ndërmjet të gjithë aktorëve institucionalë dhe duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin afatgjatë të cilësisë në të gjitha aspektet e jetës akademike.[728] [729] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

[719] 14.5. Ditët informuese në TBU
[720] 14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP - 28.05.2024
[721] 44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS
[722] 44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS
[723] 44.4. Trajnime mbi sistemin LMS
[724] 35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25
[725] 35.1.1. Rregullore NJSBC
[726] 59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25
[727] 59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25
[728] 14.3. Raport-master FTI Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI
[729] 14.4. Raport-master FTI2 Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Software"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Kurrikulë bashkëkohore dhe multidisiplinare – Përfshin lende të avancuara si në machine learning, cloud computing, data mining, dhe menaxhim sistemi, duke reflektuar prirjet globale dhe kërkesat e tregut të punës.
2. Staf akademik i kualifikuar – Programi mbështetet nga pedagogë me tituj "Prof.Dr.", "Profesor i Asociuar" dhe "Dr.", me eksperiencë akademike dhe kërkimore brenda dhe jashtë vendit.
3. Bashkëpunime me industrinë – Ka marrëveshje aktive me mbi 50 kompani dhe institucione TIK, duke ofruar praktikë të strukturuar dhe kontakte reale pune për studentët.
4. Pajisje dhe infrastrukturë moderne – Programi zhvillohet në mjedise bashkëkohore laboratorike dhe përmes platformave digjitale për mësim dhe testim (LMS, softuer edukativ).
5. Trajnime dhe zhvillim profesional – Organizohen leksione të hapura, ditë karriere, dhe trajnime të fokusuara në teknologjitë më të fundit, me pjesëmarrje të ekspertëve të industrisë.

**Pika të dobta**

1. Faza e hershme e konsolidimit të kërkimit shkencor – Edhe pse ka ambicie të qarta në fushën e kërkimit, përfshirja reale e studentëve dhe stafit në projekte të financuara është ende e kufizuar.
2. Numër i kufizuar mobilitetesh ndërkombëtare – Për shkak të kohës së shkurtër që programi është në funksion (filluar në 2023), nuk janë realizuar ende mobilitete studentore apo staf akademik.
3. Mungesë diplomimesh – Në momentin e vlerësimit, programi ende nuk ka studentë të diplomuar, çka ndikon në mungesën e të dhënave të plota për ndjekjen pas diplomimit.
4. Ndikim i kufizuar në komunitetin akademik ndërkombëtar – Edhe pse është planifikuar, mungojnë aktualisht publikime ose pjesëmarrje të dokumentuara të studentëve/stafit në konferenca ndërkombëtare shkencore.

**Rekomandime**

1. Nxitja e kërkimit të aplikuar dhe ndërdisiplinor – Institucioni duhet të mbështesë me fonde dhe trajnime të dedikuara përfshirjen e stafit dhe studentëve në grante kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në projektime bashkëpunuese me industrinë.
2. Formalizimi i mobiliteteve akademike – Duhet të përshpejtohet nënshkrimi i marrëveshjeve Erasmus+ dhe partneriteteve të tjera për të mundësuar shkëmbime studentore dhe të stafit.
3. Zhvillimi i një strategjie alumni dhe ndjekje të karrierës – Pasi të diplomohen brezat e parë, të krijohet një strukturë për gjurmimin e punësimit, me qëllim matjen e impaktit real të programit në treg.

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE TBU

4. Ndërkombëtarizimi i prodhimit akademik – Të inkurajohet dhe mbështetet stafi për botime dhe prezantime shkencore, si dhe për përfshirje të studentëve master në projekte të përbashkëta ndërkombëtare.
5. Zgjerimi i moduleve me komponentë etikë dhe ligjorë – Rekomandohet përforcimi i moduleve që mbulojnë etiken digjitale, të drejtën e teknologjisë dhe privatësinë, në përputhje me evoluimin global të standardeve të sigurisë dhe shoqërisë digjitale.

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Software Engineering"**

**Strengths and affirmations**

1. Modern and interdisciplinary curriculum – It includes advanced modules in AI, cybersecurity, cloud computing, data mining, and system management, reflecting global trends and labor market demands.
2. Qualified academic staff – The program is supported by lecturers holding academic titles ("Professor", "Associate Professor" and "PhD") with international research and teaching experience.
3. Strong collaboration with industry – Active agreements with over 50 companies and institutions in the ICT sector provide structured internships and real-world work experience for students.
4. Modern infrastructure and teaching platforms – The program is delivered through updated laboratories and learning management systems (LMS), ensuring digital access and professional development.
5. Professional training and student support – The program includes open lectures, career days, and certified trainings delivered by industry professionals.

**Weaknesses**

1. Early stage of scientific research consolidation – Although clear research priorities are defined, student and staff involvement in funded research projects remains limited at this stage.
2. Lack of international mobility data – Due to its recent establishment (started in 2023), the program has not yet implemented international mobility activities for students or staff.
3. No graduates yet – As the first cohort has not yet completed the program, employment tracking and graduate performance data are currently unavailable.
4. Limited presence in the international academic community – There is currently little documented participation of students and staff in international academic conferences or publications.

**Recommendation**

1. Encourage applied and interdisciplinary research – TBU should support research through internal funding, training, and inclusion in national/international research grants, with a focus on industry-related innovation.
2. Formalize academic mobility – The institution should accelerate the establishment of Erasmus+ and other bilateral agreements to facilitate student and staff exchanges.
3. Develop an alumni and career tracking system – Upon graduation of the first cohort, a structured system should be implemented to monitor graduate employment outcomes and career progression.
4. Promote international academic engagement – Academic staff should be encouraged and supported to publish and participate in international conferences, and involve master's students in joint research initiatives.

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

5. Expand ethical and legal components in the curriculum – Modules on digital ethics, tech law, and data privacy should be further developed in line with global cybersecurity and digital governance standards.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË** | | | | X |
| **III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT** | | | | X |
| **IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT** | | | | X |
| **V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE** | | | | X |
| **VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT** | | | | X |
| **VLERËSIMI TËRËSOR** | | | | X |

**Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit**

0 Raporti i Vleresimit te Brendshem per MShIS (shqip)

01. Raporti i Vleresimit te Brendshem per MShIS (anglisht)

02. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB MShIS

1 Mendimi i Dekanit FTI

2 Statuti i TBU

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

2.1.1. Vendim Senati 9 dt. 28.09. 2022 per hapjen e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

2.1.2. Vendim Senati 9-1 dt.16.11.22 Per hapjen e programeve Inxh.Informatike; Inxh.Kompjuterike dhe Inxhienieri Softwerike

2.1.3. Vendim SA Nr. 51dt.11.09.23 mbi ristrukturimin ne zbatim te urdherave 195 ,196 MAS..

2.2. Struktura Organizative TBU

3.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 24-29

3.1.1. Strategjia e Zhvillimit te TBU 18-23

3.2. Strategjia e Kerkimit Shkencor 24-29

3.2.1 Strategjia e Kerkimit Shkencor 18-23

4. Plani Strategjik për zhvillimin e programin e studimit MSh-IS

5. Rregullore e Kolegjit Universitar TBU

6. Rregullore e Fakultetit te Teknologjise se Informacionit

7 Rregullore e Departamentit te Inxhinierise Software

7.1. Formulari i planifikimit të ngarkesës të stafit akademik në auditor nga departamenti

8. Rregullore për Sekretarinë Mësimore

9. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (shqip)

9.1. Rregullore e programit të studimit MSh Ïnxhinieri Software" (anglisht)

10. Formati i tezës së provimit përfundimtar (NA)

11 Udhëzim për përgatitjen e temës së diplomës

12.1. Kalendari akademik 2023-2024

12.2. Kalendari akademik 2024-2025

13. Rregullore për punësimin, largimin nga puna dhe vlerësimin e personelit

13.1. Shembull njoftim për vend vakant për staf akademik në website

13.2. Politika e BNJ ne TBU

13.3. Format Dosje staf akademik (administrohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, sipas PAK/PAE):

13.4. Praktika e rekrutimit te stafit

14. Rregullore e Zyrës së Çështjeve Studentore

14.1. Vendim Dekanati për Bordin e Tregut të Punës FTI

14.1.1 Axhenda e Takimit me BTP 2023-2024

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

14.1.2. FTI - PROTOKOLL - Mbledhje BTP

14.2. Panairi i punës 2024 (ftese)

14.3. Aktivitete të realizuara nga ZÇS për studentët Master FTI

14.4. Aktivitete bashkëpunime me biznesin për studentët Master FTI

14.5. Ditët informuese në TBU

14.6. Urdhër Rektori për planin e gjimnaz tour 24-25

14.7. Rrregullore e Këshillimit Akademik

14.7.1 Plan Pune Këshilltari Akademik FBD-FTI

15. Politika e Zhvillimit të Kurrikulave në TBU

16.1. Kurrikula e programit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)

16.2. Kurrikula e programit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)

16.3. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip)

16.4. Plani mësimor i programit të studimit MSh "Inxhinieri Software" (anglisht)

16.5. Plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese – MSh "Inxhinieri Software"

17.1. Forma e re e propozuar e diplomës dhe suplementit_për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software"

18. Kodi i Etikës

19. Studimi për tregun e punës

20. Rregullore për Funksionimin e Organeve Kolegjiale

21. Syllabuset e lëndëve të ofruara për programin e studimit MSh "Inxhinieri Software" (shqip & anglisht)

22. Formati i Syllabusit (shqip/anglisht) – VKM 41/2018

23. CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit

24. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit) (NA)

25. CV e stafit ndihmës akademik (NA)

26. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela no.1 & 2)

27. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit MShIS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 6,12,7& 8)

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

28. Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit MSh – IS për 2 vite 23-25 (Aneks Tabela 4)

29. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga njësia përgjegjëse (Aneks Tabela 3)

30. Cilësia në hyrje dhe dalje për programin (Aneks Tabela 21)

31. Procedura e Pranimit të Studentëve në TBU (Shkëputur nga Rregullore. eTBU)

32. Rregullore per Transferimin e studimeve

33. Projektet e fituara nga TBU/ Projekte ku jane perfshire pedagoget e DIS/Projekte te fituara tek AKKSHI

34. Të dhëna për punësimin real të studentëve 22-24 (Aneks Tabela 23)

35.1.1. Rregullore e NJSBC

35.1.2. Politika per Sigurimin e Cilesise

35.1.3. Rregullore e Komisionit te Sigurimit te Cilesise

35.2. Procedura e zgjedhjes së NJSBC 24-25

35.3. Plan pune i NJSBC 2024-2025

35.4. Plani pune i KSC FTI 24-25

35.5. Raporti vjetor i NJSBC 23-24

35.6. Raporti vjetor i KC FTI 23-24

35.7. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e pyetesorit nga studentet

35.8. Shembull_Njoftime dhe komunikime për zhvillimin e fokus grupeve

35.9. Formati i pyetësorit për vlerësimin e lëndës & pedagogut nga studentët

35.10. Raporti i Fokus Grupeve

35.11. Formulari i vleresimit te pedagogut nga eprori-kolegu

35.12. Praktike e vlerësimit total të performances të pedagogut

36. Rregullore e praktikës mësimore & dokumentat përkatëse

36.1. Lista e Institucioneve dhe organizatave me të cilat TBU ka marrëveshje bashkëpunimi (Aneks Tabela 5)

36.2. Memorandum TIP_TBU_Subjekt

36.3. Marrëveshje të bashkëpunimit me institucionet & bizneset në lidhje me programet e studimit MSh -IS

36.4 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

36.5. Vendimet për përcaktimin e Pedagogut-pedagogëvve Udhëheqës për Praktikat Mësimore për vitin 24-25 FTI

37.1 Politika për zhvillimin professional të stafit

37.1.1 Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin dhe studentët

38. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit MShIS

39 Formati i relacionit për monitorimin e syllabuseve

40. Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit MShIS

41. Formular i Realizimit te Ngarkeses Mesimore se Personelit Akademik

42. Rregullore e Qendrës për Kërkime e Studime Ekonomike dhe Juridike - QKSEJ

42.1. Indikatorët e vlerësimit të performancës kërkimore-shkencore për personelin akademik

42.1.2. Formular i raportimit te punes kerkimore shkencore

42.2. Politika e granteve

42.3. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit të studimit MShIS (Aneks Tabela 19)

42.4. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësisë, në tre vitet e fundit (Aneks Tabela 22)

43. Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2022-2023)

43.1 Raporti i MAS për inspektimin e kapaciteteve (2024)

43.2. Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Aneks Tabela 16)

44. Strategjia e Zhvillimit te IT

44.1. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë të informacionit

44.2. Guidë për pedagogun për përdorimin e LMS

44.3. Guidë për studentët për përdorimin e LMS

44.4 Trajnime mbi sistemin LMS

45. Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Aneks Tabela 20)

46.1. Rregullore për shkëmbimin e stafit

46.2. Rregullore per shkembimet studentore

46.3. Raporti ne lidhje me mobilitetet e stafit dhe studenteve

47. Rregullore e bibliotekës

47.1. Inventari i teksteve ne Bibilotekë për fushën e programit të studimit MShIS

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

47.2. Procedura e miratimit të Dokumentit Mbi Procedurën e Blerjes së Literaturës në TBU

48. Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj (Aneks Tabela 17)

49. Politika e Marketingut të TBU për programet e studimit

50.1. Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1)

50.2. Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2)

50.3. Pasqyrat Financiare 2021_2022_2023

50.4. Raport auditimi 2021_2022_2023

50.5. Procedura e miratimit të buxhetit 2023 dhe planit buxhetor 24-27

51. Ndryshimet e kurrikulës MshIS(Aneks Tabela 11) (NA)

52. Shkresa për akreditimin e programeve MShIS në ASCAL

53.1. Plani vjetor i DIS 23-24

53.2. Raporti vjetor i DIS 23-24

54.1. Raporti vjetor institucional 2021-2022

54.2. Raporti vjetor institucional 2022-2023

54.3. Raporti vjetor institucional 2023-2024

55. Politika për të Mësuarit, Mësimnxënien dhe Cilësinë e Mësimdhënies

56. Rregullore e Arkivës

57. Mareveshja e MAS_TBU_dt.9.07.2024 _Përcaktimi i Personeli Akademik

58.1. Brochure Scientific Conference TBU

58.2. Program of TBU Conference

59. Rregullore e Keshillit Studentor

59.1. Perfshirja e studenteve ne qeversijen e TBU

59.2. Procesverbal i Mbledhjes së Senatit Studentor 24-25

59.3. Raporti për përzgjedhjen e Senatit Studentor 24-25

60.1. Vendim për tarifat dhe bursat e studentëve për vitin 24-25

60.2. Tarifat dhe bursat VA 2024-2025

60.3. Të dhëna për shpërndarjen e bursave ndër vite

60.4. Kontratë dhurimi Mane Foundation dt.9.11.23

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE

60.5. Kontratë dhurimi Mane Foundation_TBU studenti Klejvi Pero 24-25

60.6. Skema e bursave sociale në TBU

61. Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH"

62. TBU_Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 794, dt. 06. 10. 2010 Licensimi i TBU

63. Urdhër MAS Nr. 75, datë 16.02.2011

64. Urdhër MAS Nr. 326,dt. 15.08.2013 Akreditimi Institucional dhe i Programeve

65. VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", e ndryshuar

66. VKM Nr. 531, datë 11.069.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë"

67.1 VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 Kodifikimi programeve qbz

67.2 Ministria e Arsimit "Për afatet e kodifikimit të programeve të Studimit ofruar nga institucionet e Arsimit të Lartë" nr,prot. 295, dt.16.01.2023

67.3. Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022-Kodifikimi-i-programeve-te-studimit-IAL-pdf

67.4. Korrespondenca me MAS mbi kodifikimin e programev te studimit

67.5. Shkresa e MAS Nr. 7381/22, dt. 30.12.2024 për "Konfimimin e kodeve te programeve të studimit në Kolegjin Universitar Tirana Business University.

68. Urdhër Rektori – ngritja e GVB për akreditimin e programit të studimit MShIS

69. Tabela e kuotave sipas troje, transferime_2024-2025

69.1 Procedura per rialokimin e kuotave të pranimit 24-25

70. Urdher Nr.195 date 20.4.2023 Mbi hapjen e FTI ne TBU

71 Urdher MAS nr. 457, dt.14.08.2023 per hapjen e MSH Inxhinieri Softwere

TBU TIRANA BUSINESS UNIVERSITY COLLEGE